Komuna e Prishtinës

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

REVIDIMIN I PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË URBANE “B”
TË LAGJES “PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE"

Maj, 2019

Vleresimi Strategjik Mjedisor për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” është hartuar nga Ndërmarrja N.SH. ,, Geo - Miningu” Prishtinë:

Hartuesi i Raportit : Kompania N.SH. ,,Geo-Miningu” Prishtinë

Pronar: Dr. Sc. Islam Fejza

Personat e licencuar për hartimin e Raportit:

1. Prof.Dr. Islam Fejza
2. Dr.Sc. Nexhmi Krasniqi
3. Msc. Lumnjije Gashi –Shabani

Përmbajtja

1.Hyrje 7

1.1 Të Dhëna Historike 13

1.2 Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor 16

1.3 Objektivat e VSM 16

1.4 Raporti Përfundimtar 17

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE 19

Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit 19

Legjislacioni Mjedisor 22

3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË VSM-së 28

Metodologjia 28

Literatura dhe Burime të Shkruara Informimi për VSM 29

Struktura e Raportit të VSM-së 30

4. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL(informatat e rëndësishme për VSM-në) 32

Nevoja për Plan zhvillimor komunal 32

Karakteristikat funksionale të vendbanimeve 32

KUSHTET TJERA MJEDISORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS 34

Natyra dhe biodiversiteti 36

Bimësia dhe vegjetacioni 36

Bota shtazore – fauna 36

Peizazhi 36

Ajri 37

Hidrologjia 38

5.0 Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis 38

Ndikimet në ajër 39

Ndikimet në tokë 39

Ndikimet në ujë 40

Ndikimet në Peizazh 40

Ndikimet në botën bimore dhe shtazore 40

Ndikimet në popullatë 41

Ndikimet nga Zhurma 41

Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore 41

Zhvillimi ekonomik 42

Objekte turistike dhe kulturore 43

Infrastruktura 43
6.0 PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHEM PËR REVIDIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM NË TËRËSINË URBANE “B” TË LAGJES “PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE" 44
6.1 Pozita gjeografike e lokacionit 44
6.2 Përshkrimi i objekteve dhe infrastrukturës për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje 50
6.2.1 Pozita e ndërtesave në parcela dhe në kuadër të parcelave fqinje 51
6.2.3 NGROHJA QENDRORE - RRJETI PRIMAR 60
6.2.4 RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE RRJETI TELEKOMINIKUES 61
6.2.5 INSTALIMET MAKINERIKE 68
6.2.6 ENERGJIA E NEVOJSHME PËR NGROHJE 69
7.0 Ndërmarrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis 70
Masat për mbrojtjen e ajrit 70
Masat për mbrojtjen e tokës 71
Masat për mbrojtjen e ujit 72
Masat për mbrojtjen e botës bimore 73
Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale 74
Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zjarri 74
Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore 75
Ndërmarrja e masave për mbrojtje civile të njerëzve dhe të pasurisë 75
Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zhurma 76
Nërmarrja e masat për trajtimin e mbeturinave 82
8.0 PLANI I MENAXHIMIT TE MJEDISIT 83
8.1 Vlerësimi i efekteve në mënyrë përmbledhëse 85
8.1.1 Metodologjia e vlerësimit 85
8.2 Plani i manaxhimit socio- ekonomik 89
8.3 PLANI I MENAXHIMIT TË TRAFIKUT 92
9. 0. PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT 94
10.0 Masat rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit (jetëgjatësisë) të Projektit 98
11.0 Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor 99
Kriteret strategjike 101
Objektiva Strategjike 102
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 105

Lista e tabelave

Table 1 Karakteristikat klimatike të Prishtinës 37
Table 2 Kujitë e lejuar të zhurmave gjatë ndërtimit 77
Table 3 Nivelet e zhurmës të përafruara pranë qendrave të banimit 80
Table 4 Nivelet e zhurmës të përafruara larg qendres së banimit 80
Table 5 Praktika e menaxhimit të mbetjeve në tërësi 83
Table 6 Idikatorët e programit të monitorimit të mjedisit 96

Lista e figurave

Figure 1 Diagrami i temperaturave vjetore 38
Figure 2 Harta e infrastruktures rrugore 44
Figure 3 Plani zhvillimor Komunal 45
Figure 4 Parcelat kadastrale që përfshihen në Plan 46
Figure 5 Harta e pronësisë 47
Figure 6 Infrastruktura rrugore e Lagjes Prishtina e Re - Zona Lindje 48
Figure 7 Plani i nivelimit 49
Figure 8 Harta e sipërfaqes së planifikuar - modeli dhe gabaritet 55
Figure 9 Harta e qasjes në rrjetin e kanalizimit 57
Figure 10 Harta e qasjes në rrjetin e ujërave të zeza 58
Figure 11 Rrjeti i kanalizimit atmosferik 59
Aneks - Plani i Menaxhimit Mjedisor

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
HEC	Hidrocentralet
HZK	Harta Zonale Komunale
IHMK	Instituti Hidrometorologjik i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
MAPL	Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
PMT	Plani i Menaxhimit të Trafikut
PRrH	Plani Rregullues i Hollësishëm
PRrU	Plani Rregullues Urban
PTK	Posta dhe Telekomi i Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1.Hyrje

Me qëllim të sigurimit të shkallës së lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut është obligim të bëhet Vlerësimi Strategjik Mjedisor(VSM) i cili është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik e në rastin tonë ky Vlerësimin Strategjik Mjedisor është bërë për Revidimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të Lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" të komunës së Prishtinës.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një obligim ligjor por edhe funksional në të cilin do të analizohen ndikimet në mjedis në fushën e shfrytëzimit të tokës, energjetikës, industrisë, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit dhe fushave tjera.

Në këtë raport do të identifikohen dhe analizohen ndikimet pozitive dhe negative të mundshme gjatë zbatimit të projektit për Revidimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të Lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" të komunës së Prishtinës, si dhe do të propozohen masat të cilat duhet ndërmarrë për zvogëlimin e ndikimet negative të mundshme që ndodhin gjatë zbatimit të planit zhvillimor komunal, me qëllim të përmirësimit të jetesë dhe shëndetit të qytetarëve, si dhe të mbrojmë florën dhe faunën, ekosistemet, cilësinë e ajrit, ujit dhe mjedisit në komunën e Prishtinës.

Termet e përdorura në këtë dokument kanë këto kuptime:

"Sistemi i integruar për mbrojtjen e mjedisit" është sistem i mbrojtjes së mjedisit kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

"Mjedisi" është rrethina natyrore: ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgimia kulturore si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu.

"Ndotja e mjedisit" është ndikimi i drejtpërdrejt ose i tërthortë i materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut.

"Dëmtim i mjedisit" është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore.

"Degradim i mjedisit" është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut.

"Rrezik" është potenciali i ndonjë aktiviteti, qoftë i drejtpërdrejt ose i tërthortë, që mund të shkaktojë ndotje për mjedisin, jetën, shëndetin e njeriut dhe te mirat materiale.

"Aksident mjedisor" është ndodhia e papritur dhe e pakontrolluar përkatësisht disa ndodhi të cilat krijohen me lirimin, derdhjen ose hedhjen e materieve të rrezikshme,

prodhimin, qarkullimin, përdorimin, transportimin, përpunimin, magazinimin apo ruajtjen afatgjate në mënyrë jo adekuate.

“Pëlqim mjedisor” është autorizim me shkrim i nxjerrë nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin, ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes se lejes për ndërtim.

“Leja e integruar mjedisore” është autorizimi me shkrim që lëshohet nga autoriteti kompetentë në pajtim me ligjin që kërkohet për marrjen e lejes për operim.

“Autorizim mjedisor” është dokument zyrtarë i lëshuar me shkrim nga Ministria, me të cilin i lejohet bartësit zhvillimi i aktivitetit apo zbatimi i projektit vetëm një herë, në pajtim me kushtet e përcaktuara në të.

“Leje mjedisore” është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria me këtë ligj, e kërkuar me qëllim që të merret leja e punës.

“Leje mjedisore komunale” është dokument me shkrim që e lëshon Komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit.

“Indikator/tregues” Një informatë, në përgjithësi sasiore, e cila përdoret për të matur dhe përcjellë gjendjen aktuale dhe progresin e një sistemi kompleks. Në kuadër të VSM-së, indikatorët shpesh përdoren për matjen e nivelit të suksesit të një plani ose projekti dhe për arritjen e objektivave.

“Ndikimet e tërthorta” Ndikimet që mund të përnxiten nga një projekt apo veprim strategjik, për shembull zhvillimi i cili bëhet rreth udhëkryqeve të autostradës pasi të jetë ndërtuar ajo. Po ashtu, quhen ndikime të gjeneruara apo të përnxitura.

“Masat për zbutje” Masat që i shmangin, zvogëlojnë, përmirësojnë dhe kompensojnë ndikimet e mëdha të dëmshme të ndonjë veprimi strategjik në mjedis.

“OJQ” Organizatë jo-qeveritare (p.sh. shoqatat qytetare, unioni i bujqve) të themeluara në mënyrë ligjore nga subjektet fizike ose juridike që funksionojnë të pavarur nga cilado qeveri.

“Objektivi” Synimi i veprimit strategjik ose VSM-së, që e përkufizon atë që mundohet të arrijë, drejtimi i dëshiruar i ndryshimit ose përmirësimit të trendëve aktual.

“Plani” Procedura e formalizuar, që i përcakton objektivat e bashkërenduar dhe të matur në kohë për zbatimin e një politike.

“PM10” Grimcat e imëta që kalojnë nëpër grykën me madhësi të paracaktuar siç përkufizohet në metodën referente për mostrat dhe matjen e PM10, EN 12341, me ndalim efikas prej 50 % në diametrin aerodinamik prej 10 μm. Disa grimca paraqiten natyrshëm, që burojnë nga vullkanet, stuhitë e pluhurit, pyjet dhe zjarret e fushave me bar dhe nga burimet tjera. Veprimtaritë njerëzore, si djegia a karburanteve nga fosilet në automjete, termocentralet dhe veprimtaritë e ndryshme industriale, po ashtu prodhojnë nivele të ngritura të grimcave të imëta në ajër të cilat lidhen me dëmtimet e shëndetit si sëmundjet e zemrës, dëmtimi i funksionimit të mushkërive dhe kanceri i mushkërive.

“Shkoqitja” Procesi i vendosjes së përmbajtjes dhe nivelit të hollësive në VSM (llojet e efekteve në mjedis, alternativat që duhen shqyrtuar) dhe si duhet të kryhet

VSM-ja (afati kohor, metodologjia, struktura e raportit, etj). Ky proces duhet të kryhet herët, mundësisht në konsultim me autoritetin kompetent dhe grupet e prekura.

“Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor - VSM”, Raporti i kërkuar nga Ligji për VSM-në si pjesë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili i identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet e rëndësishme të mundshme në mjedis nga realizimi i një plani ose programi. Ky dokument duhet ta regjistrojë procesin dhe konkluzionet e procesit të VSM-së. Po ashtu, quhet edhe raport mjedisor.

“Aktor” Dikush që ndikohet nga veprimet strategjike ata që kanë interes ose edhe ndikim në to.

“Veprim strategjik” Vendimi që është "përmbi" nivelin e projektit: politika, plani ose programi.

“Direktiva për VSM-në ”Direktiva Evropiane 2001/42/EC (për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis).

“Vlerësimi i qëndrueshmërisë” VSM-ja që i shqyrton çështjet ekonomike dhe shoqërore si dhe mjedisore.

“Çrregullim mjedisor” ka të bëjë me ndotjen e mjedisit kur materiet ndotëse i tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj.

“Emision” konsiderohet shkarkimi i materieve ndotëse, i energjisë dhe zhurmës nga burimet individuale dhe difuzive në mjedis.

“Informacion mjedisor” është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër ne lidhje me gjendjen e përbërësve te mjedisit, masat, raportet, kost benenfit analizat si dhe gjendja e shëndetit të njeriut.

“Mbeturinë” është çdo substancë ose lëndë të cilën zotëruesi e hedhë, mendon ta hedhë ose është i detyruar ta hedhë.

“Mbeturinë e rrezikshme” janë mbeturinat toksike, gërryese, ngacmuese, shpërthyese, të përflakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.

“Materie të rrezikshme” janë kimikatet dhe materiet tjera të cilat kanë karakteristika të dëmshme dhe të rrezikshme.

“Ndotje” është shkarkim i materieve dhe kimikateve në formë të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë,si dhe vibrimet, rrezatimin, ngrohjen, dritën, zhurmën apo forma të tjera të energjisë në mjedis,që kanë potencial domethënës që t’i shkaktojë dëme shëndetit të njeriut, organizmave të gjallë apo ekosistemeve dhe mjedisit në tërësi.

“Ndotës” është personi juridik apo fizik i cili me veprimin apo mosveprimin e tij shkakton ndotjen e mjedisit.

“Ministria” është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

“Resurset natyrore” janë të gjithë përbërësit e natyrës që njeriu i shfrytëzon për qëllime ekonomike. Resurset natyrore mund të jenë: të papërsëritshme (lëndët minerale) dhe të përsëritshme (të mirat biologjike, uji, toka e përsëritshme).

“Vlerat e natyrës” janë pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të veçantë për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose interesit shkencor, estetik, kulturor, historik, arsimor dhe ekonomik.

“Shfrytëzimi i qëndrueshëm” nënkupton shfrytëzimin e resurseve natyrore që sigurojnë plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto resurse.

“Zhvillimi i qëndrueshëm” është harmonizimi i zhvillimit ekonomik, dhe mbrojtja e mjedisit për të plotësuar nevojat e të sotmes pa rrezikuar mundësitë që edhe brezat e ardhshëm t`i shfrytëzojnë këto kapacitete dhe t`i përmbushin nevojat e veta.

“Sanimi” është proces i ndërmarrjes së masave për ndalimin e ndotjes dhe degradimin e mëtutjeshëm të mjedisit deri në nivelin i cili është i sigurt për shfrytëzim të mëtutjeshëm të lokacionit, duke përfshirë, rregullimin e hapësirës, revitalizimin dhe rikultivimin.

“Riciklim” është përpunimi i mbeturinave në procesin parësorë apo për dedikim tjetër, duke përfshirë riciklimin biologjik pa shfrytëzim të energjisë.

“Fondi për mbrojtjen e mjedisit” do të thotë instrument ekonomik për stimulimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit. në Kosovë.

“Publiku” konsiderohet një ose më shumë persona juridik ose fizik, shoqatat e tyre, organizatat apo grupimet.

“Publiku i interesuar”publiku i prekur apo që ka të ngjarë për t'u prekur, ose i cili ka interes, në procedurat vendimmarrëse mjedisore të cilat referohen në këtë ligj. Për qëllim të këtij përkufizimi, organizatat jo-qeveritare të cilat promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe që përmbushin kërkesat e parashtruara sipas ligjit vendor do të konsiderohen si organizata që kanë interes

“Burimet e lëvizshme të ndotjes” janë mjete me motor me djegie te brendshme që lëvizin dhe shkaktojnë ndotje në mjedis.

“Statusi i mjedisit te rrezikuar” është gjendje mjedisore kur tejkalohet shkalla e ndotjes e përcaktuar në bazë të matjeve, hulumtimeve dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes, në raport me normat e lejuara.

“Instrumentet ekonomike” janë instrumente, të cilat kanë për qëllim të ndikojnë në ndryshimin e sjelljes së subjekteve ekonomike, nëpërmes llogaritjes të shpenzimeve mjedisore për shfrytëzimin e resurseve natyrore.

“Cilësia e mjedisit” konsiderohet përqendrimi i materieve ndotëse në mjedis.

“Kadastri i ndotësve” është grup i të dhënave për burimet e ndotjes, llojin sasinë, mënyrën dhe vendin e shkarkimit, rrjedhjen apo vendosjen e materieve të dëmshme në mjedis, për stabilimentet dhe pajisjet për mbrojtjen e mjedisit si dhe proceset të cilat përdoren për mbrojtjen e mjedisit, të cilat të dhëna mblidhen për periudhën e vitit kalendarik.

“Projekti”- ekzekutimi i punëve ndërtimore, të instalimeve ose skemave të tjera, largimin ose çmontimin e instalimeve ose skemave, intervenimet e tjera në rrethinën e natyrës dhe në peizazh përfshirë nxjerrjen e resurseve minerale dhe atyre që kërkojnë punë rehabilitimi.

“Aplikuesi” personi fizik ose juridik, vendor apo i huaj, i cili është bartës i kërkesës për marrjen e Pëlqimit mjedisor për realizimin e një projekti.
“Pëlqimi mjedisor” vendimi me shkrim i nxjerrë nga Ministria në pajtim me ligjin, si parakusht për fillimin e realizimit të projektit.
“Ministri” Ministri kompetent për çështjet e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis” (në tekstin e mëtejmë: VNM) - identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të projektit në mjedis, konsultimin e autoriteteve mjedisore dhe të publikut, duke marrë parasysh raportin e VNM dhe rezultatet e konsultimeve në vendimmarrje, përcaktimin e metodës për parandalimin, shmangien, zbutjen ose rehabilitimin e ndikimeve të dëmshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe dhënien e informatave mbi vendimin.
“Raporti i VNM” rezultati i një vlerësimi të ndikimit në mjedis.
“Përzgjedhja” procesi, gjatë të cilit përcaktohet nëse do të jetë i nevojshëm ose jo një VNM për projekte të caktuara.
“Vendimi i Përzgjedhjes” vendimi se a është i nevojshëm ose jo VNM për një projekt të veçantë.
“Studimi” procesi i identifikimit të informatave minimale që kërkohen për një raport të VNM-së mbi ndikimet e mundshme mjedisore të një projekti të propozuar bazuar në informatat për projektin, si dhe në lokacionin dhe rrethinën e tij.
“Njoftimi i Studimit” një deklaratë me shkrim e lëshuar nga ana e Ministrisë, e cila përmban një mendim mbi informatat lidhur me ndikimet e pritura që duhet të parashtrohen në një Raport të VNM-së.
“Përmbledhja jo-teknike”dokumenti i shkurtër, i ndarë nga dokumentet tjera, që paraqet rezultatet e rëndësishme të raportit të VNM, të shprehura në një format më të thjeshtë dhe më të kuptueshëm për debate publike.
“Ditë” ditë pune.
“Informim Lokal”publikimi i një njoftimi në një gazetë e cila qarkullon në lokalitetin në të cilin do të realizohet projekti i propozuar, në ueb faqe të komunës ku do të realizohet projekti i propozuar dhe në ueb faqen e Ministrisë.
“Planet dhe programet”planet dhe programet, duke përfshirë edhe ato të bashkë financuara nga Bashkimi Evropian ose nga institucionet tjera ndërkombëtare si edhe ndonjë modifikim të tyre, të cilat janë subjekt i përgatitjes ose miratimit (ose që të dyjave), nga ndonjë autoritet në nivel qendror, rajonal apo lokal, ose që janë përgatitur nga ndonjë autoritet për miratim përmes një procedure legjislative, rregullatore dhe administrative nga ana e Parlamentit ose Qeverisë;
“Vlerësimi Strategjik Mjedisor” (VSM) - është proces i vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis të një politike, plani ose programi, përgatitja e një raporti të VSM, mbajtjen e konsultimeve, marrjen parasysh të këtij raporti dhe të rezultateve të konsultimeve në vendimmarrje si dhe ofrimin e informacioneve lidhur me vendimin në pajtim me ligjin;
“Komisioni” trupi i propozuar nga Ministri dhe të miratuar nga Qeveria, në rastet kur vet Ministria është autoritet përgjegjës i planit ose programit;

“Trupat konsultativ” Ministrinë, ose në rastet kur Ministria është vet autoritet përgjegjës, atëherë Komisionin; dhe cilindo trup tjetër të përcaktuar me ligj i cili ka përgjegjësi specifike për mjedisin dhe për të cilin Ministria konsideron se mund të shqetësohet për planin ose programin e propozuar;

1.1 Qëllimi i Revidimit te Planit Rregullues të Hollësishëm

Qëllimi i këtij revidimi të këtij plani rregullues është që të krijojë një ambient të shëndoshë për një jetë të qetë. Në këtë zonë synohet që me planin rregullues të bëhet:

- Sigurimi i sipërfaqeve të domosdoshme për përmbushjen e nevojave të të gjithë komunitetit;
- Shfrytëzimi ekonomik dhe efikas i tokës;
- Sigurimi i infrastrukturës komunale: ujësjellësi, kanalizimi, rryma elektrike, ngrohja qendrore, gazifikimi, interneti, telefonia tokësore, sistemi i rrjetit kabllor etj.;
- Integrimi i objekteve publike dhe sociale;
- Sigurimi i sipërfaqeve me gjelbërim dhe avancimi i kushteve për banim, punë, sport dhe rekreacion;
- Stimulimi i një ambienti të shëndoshë për jetë të shëndoshë;
- Zvogëlimi i ndotësve, hedhurinave dhe inkurajimi i mjedisit ekologjik;
- Mbrojtja e zonës ekzistuese të gjelbërimit dhe shfrytëzimi aktiv i hapësirave të gjelbëruara;
- Lidhja e rrjetit ekzistues të trafikut me atë të planifikuar dhe sinkronizimi me trafikun e lagjeve përskaj, si dhe rritja e sigurisë për këmbësorë dhe automjete;
- Sigurimi i një qasje të integruar për jetë funksionale dhe të sigurt;
- Qasje gjithëpërfshirëse në të gjitha kategoritë e komunitetit, e në veçanti për persona me nevoja të veçanta, të moshuar, fëmijë dhe ata që jetojnë me ndihmë (asistencë) sociale;

Stimulimi i parimeve të urbanizmit të qëndrueshëm dhe të përdorimit të energjive alternative (solare dhe gjeotermike), të përdorimit të materialeve të riciklueshme ndërtimore, etj

1.2 Të dhëna të përgjithshme për Komunën e Prishtinës

Prishtina gjendet në pjesën lindore të Kosovës në gjërësi gjeografike 42^0 40` 00`` dhe gjatësi gjeografike $21^o$ 20` 15`` dhe shtrihet buzë rrafshnaltës së plleshme rrëzë maleve të argjendta. Ashtu si dikur Ulpiana, ka pozitë të përshtatshme gjeografike, pasi gjendet në kryqëzimet parësore kontinentale. Komuna e Prishtinës ka një sipërfaqe prej 572 km^2

Komuna e Prishtinës i ka gjithësej 48 fshatra.



Komunitetet që jetojnë në Komunën e Prishtinës janë: serbë, turkë, boshnjakë, romë, ashkali etj.

Në Komunën e Prishtinës ekzistojnë edhe 57 prona shoqërore me 143 biznese shoqërore. Kështu, numri i përgjithshëm i biznesit të regjistruar në Komunën e Prishtinës është 8.735 biznese më 75.089 punëtorë.

Prishtina është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Kosovës. Qyteti është bashkësi dhe kryeqendra e Qarkut të Prishtinës. Komuna e Prishtinës ka një popullsi prej 198.214 banorësh sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011

Rajoni	Prishtina
Sipërfaqja dhe popullsia	
Sipërfaqja	572 km^2
Lartësia	652 m (m.n.d.)
Popullsia	208.230 banorë
• urbane	208.149 banorë
• aglomerati	465.186 banorë
Dendësia	360 banorë/km^2
Të dhëna të tjera	
Vendasit	Prishtinas (m) Prishtinase (f)
Zona Kohore	ZKEQ (UTC+1)
Verore	OVEQ (UTC+2)
Kodi Postal	10000
Prefiksi	+383 38
Targa	**01**
Koordinatat	42° 40′ 0″ Veri 21° 10′ 0″ Lindje

Toponomastika ende nuk e ka shpjeguar prejardhjen e emrit Prishtinë. Ekzistojnë disa hipoteza të bazuara në etimologji, por që nuk hedhin dritë përfundimtare në këtë çështje. Ekzistojnë disa supozime që mbështeten në burimin ilir të fjalës, apo në atë latin (*pristinus* – e dikurshme).

Por, ka autorë që nisen prej asaj që emri Prishtinë do të ketë qenë emër i ndonjë personaliteti.

Të gjitha shpjegimet etimologjike janë ende hipotetike. Prishtina me këtë emër përmendet në mesjetë, mirëpo gjurmët e vendbanimeve arkeologjike rreth asaj shtrihen që nga neoliti, sikurse ato rreth lumit Graçanka, që supozohet të kenë vjetërsinë 6 mijë vjeçare. Shenja dalluese e kësaj periudhe është vendgjetja neolitike në afërsi të "Tjerrtores" së Prishtinës, Statueta e ulur – që përdoret si simbol i qytetit të Prishtinës – dhe figurat e tjera me qeramikë. Vendbanime të periudhës së hershme të hekurit janë gjetur edhe përgjatë Taukbashçes dhe shkollës normale, në gjithë kompleksin deri te bazeni i Gërmisë, ku vërtetohen edhe vendbanimet e para ilire në rrethin e Prishtinës. Në afërsi të Prishtinës ka qenë njëri nga vendbanimet më të rëndësishme në regjion, Ulpiana romake, e ngritur në themelet e një vendbanimi ilir, që më vonë pas një tërmeti katastrofë që goditi Dardaninë, u ngrit në një nga qendrat më të mëdha bizantine në mesjetën e hershme me emrin "Justiniana sekonda". Këtë e ka ngritur perandori i madh romako-bizantin, Justiniani, në shek. VI.

Prishtina si kryeqytet për shkak të kërkesave të reja për njësi banimi në territorin e komunës së Prishtinës ka ndodhur edhe një tjetërsim intensiv në përdorimin e tokës,

duke konvertuar në truall ndërtimi sipërfaqe të gjera dikur në periferi të disa vendbanimeve, dhe duke rritur intensitetin dhe koeficientin e ndërtimit.

Në pjesën më të madhe, mënyra e akomodimit të popullsisë ka qenë e paplanifikuar, dhe e përqendruar sidomos në zonat periferike të vendbanimeve dhe në zonat afër rrugëve. Kjo gjë ka vënë nën presion edhe infrastrukturën dhe shërbimet ekzistuese, të cilat nuk kanë arritur t'u përgjigjen kërkesave në rritje si pasojë e këtij zhvillimi. Orientimi i zhvillimit të Prishtinës për të siguruar shërbime efektive (dhe funksionale) dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së aspekteve mjedisore të komunës ka qenë i tillë që as nuk i është afruar niveleve të planifikuara apo të kërkuara. Sigurisht, zhvillimet ekzistuese për Prishtinës, janë të pamjaftueshme dhe jorealiste për t'iu përgjigjur nevojave hapësinore dhe kërkesave të zhvillimit të Pejës në 20 viteve të fundit.

Procesi dhe qëllimet e zhvillimit të planit nga detyra projektuese përmblidhen në fusha, duke pasur çdo fushë qëllimet e veta, si më poshtë:

INFRASTRUKTURA SOCIALE

- Sigurimi i infrastrukturës sociale adekuate dhe mirëmbajtja e saj
- Promovimi i artit, sportit dhe kulturës

ARSIMI

- Arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor.

SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

- Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale

ADMINISTRATA PUBLIKE

- Administratë efikase

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE, MJEDISI DHE FATKEQËSITË NATYRORE

- Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm.
- Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë natyrore drejt zhvillimit të qëndrueshëm
- Krijimi i një mjedisi më të pastër dhe më të sigurt për komunitet përmes zvogëlimit të ndotjes dhe rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera.

TURIZMI

- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.

NDËRMARJET E VOGLA DHE TË MESME

- Nxitja e krijimit të NVM në sektorin e prodhimit (agroindustri)

BUJQËSIA

- Modernizimi I bujqësisë dhe nxitja e përpunimit të produkteve bujqësore.

VENDBANIMET

- Zhvillimi kompakt dhe i balancuar i vendbanimeve në të mirë të shfrytëzimit racional të tokës.

BANIMI

- Krijimi i kushteve adekuate/mirëfillta për banim cilësor dhe të përballueshëm.

TRANSPORTI

- Zhvillimi I infrastrukturës dhe transportit të qëndrueshëm

INFRASTRUKTURA TEKNIKE

- Mbulueshmëria dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve teknike në tërë territorin e komunës.

MBETURINAT

- Krijimi i një mjedisi të pastër pa mbeturina

Një kërkesë ligjore për planin zhvillimor komunal është vlerësimi i ndikimeve potenciale nga zbatimi i këtij plani në mjedis. Ky Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) ka për qëllim t'i sigurojë komunës së Pejës një seri rregullash dhe kriteresh mjedisore të nevojshme për t'u zbatuar, të përmbledhura këto në një raport VSM-së që do të kalojë nga konsultimi i publikut, dhe më tej nga miratimi përfundimtar eventual nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH)

1.3 Nevoja për Vlerësim Strategjik Mjedisor

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim nga ana njerëzore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashmë i është dhënë gjithmonë e më shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në tërësi të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të "parandalimit" sipas të cilit çdo ndërhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo ndërhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore edhe mjedisore, planet apo strategjitë mund të përfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata dhe të llojit strategjik. Për këtë specifikë, ato i nënshtrohen një procedure të veçantë dhe të ndryshme nga VNM-ja, siç është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM).

Procesi i VSM-se është një detyrim ligjor për politikat, planet apo programet. VSM është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe të programeve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është procesi dhe sistemi i përfshirjes së konsideratave mjedisore brenda politikave, planeve, programeve, apo strategjive.

1.4 Objektivat e VSM

Objektivi kryesor i VSM-së është orientimi Projekteve për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij. Kjo VSM identifikon ndikimet e mundshme mjedisore, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre. VSM analizon disa skenarë. Skenari "0", pra "të mos bërit asgjë"

do të çonte me shumë gjasa në një spirale të përshpejtuar të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VSM-ja synon të orientojë planin për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme.
Për Planin e ndërtimit të Lagjies Prishtina e Re –Zona Lindje, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i planit. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari “0” nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore në Prishtinës është ekstremisht e dobët po t’i referohemi standardeve evropiane, dhe do të përkeqësohet edhe më shumë nëse vazhdon rritja e paplanifikuar.
Veçanërisht ky vlerësim strategjik mjedisor shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:
• mjedisit në tërësi – përdorimit të tokës, florës, faunës, cilësisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, pikave të nxehta potenciale të ndotjes, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, zonave të mbrojtura, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;
• mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar – monumentet e godinat arkeologjike, kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhistike, qendrat historike;
• veprimtarive ekonomike dhe shoqërore – të tilla si tregtia, industria, shëndeti dhe arsimi, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin.
• infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve – sigurimi (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme; qarkullimi dhe lëvizshmëria në rrugë dhe transport; lëvizshmëria alternative;

1.5 Raporti Përfundimtar

Raporti Përfundimtar do të jetë rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës së Prishtinës, si edhe debateve me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjate procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen nëse gjykohen të drejta dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kapitull i parë jep sfondin dhe të dhënat historike, si dhe shpjegon nevojën për një VSM, duke detajuar edhe objektivat e VSM-së.

Kapitulli i dytë mbulon paraqitjen e kuadrit ligjor dhe institucional mbi të cilin bazohet procesi i zhvillimit të raportit të VSM-së.

Kapitulli i tretë trajton procesin dhe metodologjinë e VSM si edhe jep burimet e shkruara apo takimet e kryera ku autoret janë bazuar në kuadër të përgatitjes së projekt-raportit përfundimtar të VSM-së.

Kapitulli i katërt bën një përmbledhje të qëllimit dhe komponentëve të Planit për ndërtimin e Lagjes Prishtina e Re –Zona Lindje dhe të mënyrës së integrimit të tij me planet e tjera, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore. Shpjegohet nevoja për planin, objektivat dhe shtrirja e tij, përpunimi dhe zbatimi i Planit për ndërtimin e

Lagjes Prishtina e Re –Zona Lindje -së, shkalla në të cilën ky Plan ndikon në planet e tjera.

Në kapitullin e pestë jepet një shqyrtim i gjendjes mjedisore ekzistuese përfshirë paraqitjen e problematikave kryesore në cilësinë mjedisore të ujit, ajrit, biodiversitetit dhe tokës, nivelit të zhurmave dhe shëndetit publik.

Kapitulli i gjashtë përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën “0” (mos bëj asgjë), duke e ballafaquar me alternativen e zhvillimit sipas modelit te zgjerimit të planit të qendrës, dhe me alternativën sipas Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës, konkretisht Lagjia Prishtina e Re –Zona Lindje

Në kapitullin e shtatë jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit urban. Jepen disa veprime konkrete që mund të realizohen në mbështetje të objektivave strategjike. Gjithashtu paraqiten në mënyrë të detajuar edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal, kritere të ndara në katër kategori bazë.

Kapitulli i tetë paraqet ndikimet e mundshme mjedisore nga Planit për ndërtimin e Lagjes Prishtina e Re –Zona Lindje si edhe masat zbutëse të propozuara. Vlerësohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alternativat e zhvillimeve të Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës, konkretisht Lagjia Prishtina e Re –Zona Lindje, me objektiv që të përmirësohet cilësia e jetës së banorëve që banojnë aktualisht përreth zonës ku do të zhvillohet ky paln dhe që do të akomodohen në të ardhmen. Në përgjithësi masat zbutëse do të synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Kapitulli i nëntë trajton aspektet e monitorimit afatgjate për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Raporti paraqet përfundimet me një përmbledhje të shkurtër dhe sugjeron disa prej veprimeve kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh gjatë zbatimit të Planit për ndërtimin e Lagjes Prishtina e Re –Zona Lindje dhe detajimit të punës gjatë hartimit të Planeve zhvillimore urbane dhe rregulluese.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit

Të gjitha institucionet në Kosovë përfshirë edhe Institucionet mjedisore kanë kaluar nëpërmjet një procesi të sfidave dhe reformave që nga ajo fillestare e themelimit të tyre pas luftës, konsolidimit të tyre dhe funksionalizimi dhe fuqizimit të veprimtarive gjatë këtyre viteve prej pas luftës deri sot. Si rezultat i përpjekjeve disa vjeçare të të gjithë aktoreve të interesuar brenda vendit, si dhe kontributit të komunitetit ndërkombëtar dhe në kuadër të plotësimit të infrastrukturës institucionale dhe ngritjes së efektivitetit dhe rezultateve në mbrojtjen e mjedisit .

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin e mjedisit dhe politikave mjedisore në nivel të shtetit të Kosovës.

Mandati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor është përcaktuar me rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/5 dhe 2005/15. Në kuadër të këtyre rregulloreve përgjegjësitë kanë të bëjnë me krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm në fushën e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit e Banimit. Në mënyrë që të bëhet një gjë e tillë, Ministria ka ngritur departamente, institute si dhe Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Krijimi i MMPH-së, ishte një hap i rëndësishëm pozitiv që kontribuoi në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, pasuar nga një numër hapash të tjerë të rëndësishëm si hartimin e një strukture bashkëkohore të këtij institucioni, përcaktimin e misionit dhe rritjen e stafit. Struktura e re e këtij institucioni pasqyron jo vetëm eksperiencat pozitive ndërkombëtare dhe të vendeve në tranzicion, por edhe realitetin dhe nevojat e vendit, si për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit, ashtu dhe për integrimin Evropian të tij.

Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Ajo harton dhe zbaton politikën e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nën-ligjore në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjës për çështje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marrëveshjet ndërkombëtare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin “Për Gjendjen e Mjedisit”, shqyrton dhe jep pëlqime mjedisore, lejet mjedisore, lejet ujore etj., për aktivitetet e ndryshme ekonomike, nxit informimin, ndërgjegjësimin dhe tërheqjen e publikut në diskutime të rëndësishme për mjedisin, etj.

Në bazë të ligjeve për planifikim hapësinor, përgjegjësitë kryesore të MMPH-së janë:

(a) Koordinimin e planifikimit hapësinor të Kosovës dhe propozimin e politikave zhvillimore hapësinore;
(b) hartimin e dokumenteve relevante planifikuese dhe raporteve;
(c) Rishikimin dhe monitorimin e dokumenteve planifikuese në gjithë territorin e Kosovës;
(d) Rishikimin, monitorimin dhe harmonizimin e proceseve planifikuese në nivel komunal;
(e) Sigurimin e përputhshmërisë e procedurave planifikuese të parashikuara në pjesën e III-të, Kapitullin II të këtij ligji;
(f) Ofrimin e këshillimeve dhe asistencës komunave në hartimin e planeve komunale hapësinore dhe të planeve rregulluese komunale;
(g) Organizimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave dhe shënimeve të planifikimit hapësinor për Kosovën;
(h) Inkurajimin dhe sigurimin participimit të publikut në proceset vendim-marrëse planifikuese; dhe
(i) Koordinimin me organizatat lokale dhe ndërkombëtare me qëllim të harmonizimit të planifikimit hapësinor në Kosovë me normat dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare të planifikimit.
Ministria është kompetente që me akt të Veçantë të përcaktoj rregulla të veçanta dhe të domosdoshme për zbatimin e ligjeve të planifikimit hapësinor. Me rregulla bëhen përpjekje për të ruajtur mjedisin dhe për të promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore e natyrore në përputhje me parimet dhe qëllimet e ligjeve dhe Planit Hapësinor të Kosovës. (Rregullimi i hapësirës (Neni 21)).

Në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, përgjegjësitë kryesore të MMPH-së janë:

Krijimi dhe konsolidimi i sistemit të integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Dhe me ketë ligj synohet:
Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar;
Përmirësimi i kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
Ruajtja dhe mirëmbajtja e resurseve natyrore, të përtritshme dhe të papërtritshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;
Bashkërendimi i veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
Bashkëveprimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
Nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.

Të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;
Të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe
Të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Autoritete të Tjera në Nivel Qendror me Përgjegjësi Mjedisore

Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim punon për Parlamentin dhe rishikon draftet e ligjeve të përgatitura nga MMPH-ja, aprovon marrëveshje mjedisore ndërkombëtare dhe të tjera në lidhje me çështjet mjedisore. Mandati i tij përcaktohet nga Parlamenti dhe anëtaret e tij janë përfaqësues nga te gjitha grupet parlamentare. Komisioni rishikon dhe përgatitë aktet ligjore që duhen miratuar nga Parlamenti. Ka të drejtën të mbikëqyre aktivitetet e MMPH-së sipas rastit kur ka interesim të veçantë të publikut.

Niveli Komunal

Komunat janë kompetente të themelojnë njësitë për planifikim hapësinor (neni 5.4 ligji planifikimit)
Përgatisin Plane zhvillimore komunale, urbane, rregulluese.
Komunat:

- Zbatojnë aplikim të plotë të parimeve të planifikimit dhe mbrojtjes së mjedisit
- Bashkëpunojnë me Ministrinë për përgatitjen e planit, për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të tyre sipas këtij ligji,
- Zbatojnë ligjet dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre,
- Përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;
- Përgatisin planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës, e aprovon Kuvendi komunal.

Organizatat Jo-Qeveritare

Organizatat mjedisore në Kosovë por edhe nëpër komunat e Kosovës janë krijuar kryesisht pas luftës, kur u vendosen edhe bazat e demokracisë dhe u krijuan kushtet e favorshme për formimin dhe zgjerimin e organizatave jo qeveritare (OJQ).
Tashme në Kosovë ka një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve mjedisore, por vetëm një pjese e tyre janë aktive.
Organizatat mjedisore të Kosovës por edhe ndërkombëtare që operojnë në Kosovë kanë ndërmarrë aktivitete sensibilizues dhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit ndër të cilat mund të përmendim në fushat si:
• Mbrojtja e biodiversitetit, vlerësim i habitateve, depozitimi i mbetjeve te ngurta, studim i problemeve të lidhura me ndotjen rurale dhe urbane, etj.

• Përfshirjen e komunitetit në vendim marrje, diskutime në tryeza të rrumbullakëta, nënshkrimin e vendimeve, etj.
• Edukim mjedisor i komunitetit nëpërmjet punëtorive dhe trajnimeve, programeve në media, publikim të materialeve të ndryshme, aktivitete të lidhura me shkollat dhe studentet, etj.
Për realizimin e objektivave të tyre, ato kanë synuar kryesisht në sensibilizimin e opinionit publik. Protestat publike janë shfaqur kryesisht në formën e peticioneve të firmosura të drejtuara strukturave të qeverisjes qendrore dhe lokale.

Legjislacioni Mjedisor
Kushtetuta e aprovuar në vitin 2008, u ngarkon institucioneve përgjegjëse detyrën e ruajtjes së një mjedisi të shëndetshëm, ekologjikisht të qëndrueshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përgjegjësia për Mjedisin Jetësor janë trajtuar dhe përcaktuar me sa vijon:

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve. Të gjitha këto janë të determinuara me nenin 52 të Kushtetutës

Zhvillimi i një sistemi ligjor modern për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë nisi me një herë pas luftës me rregullore të UNMIK-ut dhe më vonë me ligjet e Kosovës. Janë bërë shumë përpjekje për përmirësimin e sistemit ligjor mjedisor dhe janë përgatitur dhe miratuar mjaft akte të reja ligjore dhe nënligjore kryesisht duke përafruar direktivat përkatëse për mjedisin të Bashkimit Evropian. Sistemi i sotëm ligjor është duke kaluar një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Qeveria i përkushton kujdes të veçantë harmonizimit të ligjeve me ato të Bashkimit Evropian (BE).

Për kohën e vet këto ligje dhanë ndihmësen e nevojshme dhe vunë themelet e shume proceseve e veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit qe sot zhvillohen normalisht.

Kërkesat mjedisore të BE-së janë shumë të gjëra dhe kanë nevojë për veprim jo vetëm në bazë të prioriteteve të vendit, por për një sërë sektorësh mjedisore. Legjislacioni evropian mjedisor përbëhet nga rreth 300 akte ligjore dhe do të trajtohet gjatë gjithë procesit të përafrimit.

Procesi i përafrimit kërkon ndërveprim të zgjeruar institucional si në hartimin e legjislacionit mjedisor dhe në zbatimin e tij. Megjithëse ka një proces të qarte në

zhvillimin e legjislacionit mjedisor, pika e dobët qëndron në zbatimin e kërkesave ligjore mjedisore.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (03/L-025)
Ky ligj synon:

Shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit , rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar;
Përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtritshme dhe të papërtritshme, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre;
Bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
Bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
Nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.
Të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës në Kosovë të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme;
Të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit; dhe
Të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
Parimet kryesore**,** të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Kosovë, janë të përafërta me ato te Bashkimit Evropian.

-Zhvillimi i qëndrueshëm;
-Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
-Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
-Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
-Parimi i përafrimit të integruar
-Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
-Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit
-Ndotësi paguan;
-Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesëmarrja në vendimmarrje

Lidhur me Planet Zhvillimore Komunale, Urbane dhe Planet Rregulluese Urbane duke ju referuar dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe atij të mjedisit, kërkohet që në hartimin e planeve të merret parasysh ndjeshmëria e mjedisit, kapaciteti bartës i saj, lidhja dhe harmonia e vlerave të peizazhit natyror, lidhja ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgimia kulturore, si dhe tërësia e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese në mjedis dhe atyre të planifikuara, ku behet fjale ekskluzivisht për VSM, theksohet ndër të tjera se këtij vlerësimi i

nënshtrohen projektet e planifikimit të territorit, si dhe planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor;

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, është përgjithësisht përafrim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Të cilat direktiva kërkojnë

“Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
“Për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis”;
“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
“Për mbrojtjen e biodiversitetit”;
“Për trajtimin e ujërave të ndotur”;
“Për substancat dhe preparatet kimike”;
“Për administrimin e zhurmave në mjedis”;
“Për zonat e mbrojtura”;
“Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
“Për taksën e karbonit e të ambalazhit plastik”;

Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuar, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre.

Drejtim tjetër të rëndësishëm në plotësimin e kuadrit ligjor, kanë përbërë hartimi dhe miratimi i një sërë rregulloresh dhe udhëzimesh të karakterit organizativë apo teknik dhe që synojnë mirë funksionimin e institucioneve përkatëse dhe bashkërendimin institucional të veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit. Hartimi dhe miratimi i këtyre akteve, zgjeron dhe forcon bazën ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Në kontekstin e këtij Raporti Vlerësimi do të veçonim edhe aktet ligjore të mëposhtme:

Ligji për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis
(LIGJI Nr. 03/L-214)

Ky ligj ka për qëllim: Parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Ky ligj gjithashtu përcakton rregullimin e procedurave për identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis dhe për procedurat shoqëruese administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor dhe siguron që të gjitha informatat relevante lidhur me mjedisin janë ofruar dhe janë marrë parasysh. (Neni 1)

Dhe si Fushëveprim i këtij ligji janë Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis -VNM, identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrë të duhur i rrethanave të secilit rast individual, efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndonjë projekti në:

- Njeriun, botën bimore dhe shtazore;
- Tokë, ujë, ajër, klimë dhe peizazh;
- Të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;
- Ndikimet e ndërsjella të elementeve të cekura më lartë. (Neni 3)

Ligji i VNM është një nga aktet ligjore më të rëndësishëm për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitet humane. Ky ligj kërkon bërjen e një vlerësimi të përgjithshëm, të integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

(Ligji Nr. 03/L-230)

Qëllimi i këtij ligji është që: Me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky ligj gjithashtu përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis,të planeve dhe programeve të caktuara, (në tekstin e mëtutjeshëm VSM) përmes

integrimit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.(Neni 1)

Fushëveprimi

- VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.
- Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.
- Për planet dhe programet nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat parashihet edhe shfrytëzimi i sipërfaqeve të vogla në nivel lokal ose në rastet e

modifikimeve të vogla të planeve ose programeve, të cilat nuk kërkojnë procedurë të rregullt për miratim si dhe për planet ose programet të cilat nuk janë të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, vendimin për VSM e merr autoriteti përgjegjës i planit ose programit, nëse sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj, vërteton se ekziston mundësia e ndikimit të theksuar në mjedis.

- VSM nuk bëhet për planet dhe programet të cilat i dedikohen mbrojtjes së vendit, evitimit të pasojave nga katastrofat natyrore dhe për planet financiare dhe buxhetore.(Neni 3)

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji për planifikim hapësinor për qellim ka promovimin e zhvillimit dhe planifikimit racional hapësinor, arritjes se drejtpeshimit në mes të zhvillimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve të hapura dhe mbrojtjes së mjedisit, dhe sjelljes së regjimit të planifikimit hapësinor të Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Me një fjalë qëllimi i këtij ligji është të sigurojnë zhvillim hapësinor të planifikuar, balancuar, të qëndrueshëm, qeverisje të mirë si dhe shfrytëzim dhe mbrojtje të hapësirës, si vlerë e përgjithshme nacionale.

Ligji për vetëqeverisjen lokale

Ky ligj (Ligji Nr. 03/L-040) themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse.

E drejta për :

a) zhvillimin lokal ekonomik;
b) planifikimin urban dhe rural;
c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
janë kompetencat vetanake, të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar
standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të ligjit për vetëqeverisjen lokale

Në fakt hartimi i VSM-së për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” duhet marrë në konsideratë edhe ligjet tjera që kanë ndikim ose rregullojnë fushat e ndryshme siç janë:

- Ligjin për mbrojtjen e natyrës (ligji nr. 03/l-233)
- Ligji për ndërtim (nr. 04/L-110)
- Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (ligji nr. 03/l-160)
- Për mbrojtjen nga zhurma (ligji nr. 02/l-102)

- Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (ligji nr. 04/-l-027)
- Për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare (ligji nr. 03/l-104)
- Ligji për ujërat e Kosovës (04/L- 147)
- Ligji për mbeturina(2011/04-L-060)
- Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Pesticidet 2003/20
- Ligji Nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugë nr. 2003/11
- Ligji për tokat bujqësore (2005/02-L26)
- Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura(2008/03-L039)

Konventat Ndërkombëtare Mjedisore

Në kontekstin e këtij raporti, disa nga konventat mjedisore të cilat duhet marrë parasysh gjatë hartimit të VMS janë renditur më poshtë.

- Konventa e Bernës; “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”
- Konventa e Bazelit; “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.
- Konventa e Vjenës; “Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit” dhe Protokolli i Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.
- Konventa e Aarhus-it; “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marre pjesë ne vendim-marrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
- Konventa e Espoo-s “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar”.
- Konventa Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike,
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin,
- Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër të mjedisit natyror të Evropës,
- Konventa për mbrojtjen e specieve shtegtuese të kafshëve të egra,
- Konventa për ndotjen atmosferike ne distanca të mëdha,
- Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar,
- Konventa për rivlerësimin e ndikimit ne mjedis ne kontekstin ndërkufitar,
- Konventa e Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare
- Konventa e mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre,
- Konventa e Stokholmit; “Mbi ndotësit organike të qëndrueshëm”,

Kosova ka ratifikuar disa konventa e protokolle dhe gjatë hartimit të legjislacionit i ka marrë për bazë edhe obligimet ndërkombëtare mjedisore të cilat krahas forcimit

institucional dhe përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor ndikojnë në përmirësimin e menaxhimit të mjedisit.

3. PROCESI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË VSM-së

Metodologjia

Kryerja e VSM për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor.

Qëllimi i raportit të VSM-së për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme nga zhvillimi për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" të propozuar.
Metodologjia për hartimin e raportit të VSM është në përputhje me ligjin për VSM Nr. 03/L-230, i cili është transpozim i direktivës se BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis".
Mbështetur në sa më sipër, raporti i VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:
a) një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
b) përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
c) përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani ;
d) përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka mundësi të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
e) përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
f) përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
g) përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
h) Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
i) një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.

j) përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve në Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” për numrin e madh dhe diversitetin e gjerë të problematikes që trajton, kërkon konsultimin e një game të konsiderueshme dokumentacioni. Bëhet fjalë për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë të ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përveç materialeve që dispononte vete, Grupi hartues i VSM-së ka siguruar të dhëna edhe nga komuna e Prishtinës, institucionet të tjera publike dhe kërkimet në internet. Më poshtë po i rendisim disa nga dokumentet kryesore që u përdoren në trajtimin e aspekteve të ndryshme mjedisore për komunën e Prishtinës dhe më gjerë.

Literatura dhe Burime të Shkruara Informimi për VSM

Materiali që përbën detyrën për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, i hartuar nga grupi punues, trajton në mënyrë serioze problemet mjedisore.

Ky dokument ndër të tjera përmban informacion lidhur me shtrirjen gjeografike, gjeologjinë, hidrologjinë, hidrografinë, mbetjet e natyrave të ndryshme, cilësinë e ajrit, ndotjen e burimeve ujore, ekonominë, infrastrukturën, transportin, urbanistiken, informacion mbi sektorët socio-ekonomik. Në përgjithësi materiali është i kompletuar, në veçanti në trajtimin e problemeve mjedisore me të cilat përballet projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”. Ai përmban të dhëna analitike mbi mjedisin fizik, mbetjet, cilësinë e ajrit dhe të ujërave sipërfaqësore, etj.

Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani i Kosovës për Veprim në mjedis kanë përcaktuar vizionin për mjedisin i cili përkufizohet si: zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur pasuritë natyrore nga ndotja dhe dëmtimi dhe promovimi i vlerave mjedisore.

Për realizimin e këtyre perspektivave, investimet për mbrojtjen e mjedisit me qellim që standardet e Bashkimit Europian të mund të arrihen brenda viteve të ardhshëm do të fokusohen në fushat e mëposhtme:

- Trajtimi i ujërave të ndotura;
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i vend-depozitimeve sipas standardeve të BE;
- Rehabilitimi i tokave të ndotura dhe burimeve të ndotjes;
- Përmirësime teknologjike në objektet industriale

Drejtimet e mësipërme për rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit, janë probleme prioritare për komunën e Prishtinës.

Mbi bazën e programit të Qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, ajo përcakton edhe qëllimet të cilat në mënyre të përmbledhur janë:

• Përmbushja e standardeve të kërkuara (BE, Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH) për cilësinë e ajrit, ujit, tokës (furnizim dhe trajtim), zhurmat, mbetjet urbane, zonat e mbrojtura etj, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës;

• Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
• Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
• Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
• Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
• Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore, dhe;
• Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve.
Pothuajse të gjitha këto probleme mjedisore për të cilat Plani ka përcaktuar synimet, janë probleme me të cilat ndeshet edhe komuna e Prishtinës. Zbutja dhe zgjidhja e tyre përben një kontribut madhor në realizmin e këtij Plani.
Për një vlerësim sa më real të situatës mjedisore në komunën e Prishtinës dhe luhatjen e saj në vite, krahas të dhënave për problematiken mjedisore të Komunës të nxjerra nga Detyra e Projektimit (Plani Zhvillimor Komunal), informacione më të gjëra dhe sistematike të ndotjes së ajrit, ujit në lumenjtë e komunës së Prishtinës, zhurmave, menaxhimit te mbetjeve, etj, u gjeten në Raportet e Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumente tjera të nivelit qendrorë, përgatitur institucionet e ndryshme të Republikës së Kosovës.

Struktura e Raportit të VSM-së

Në këtë Raport të VSM-së paraqitet një përmbledhje e qëllimit dhe komponentëve të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” dhe të mënyrës së integrimit të tij me planet e tjera të qytetit, duke vënë theksin tek aspektet mjedisore.
Mbështetur në publikimet mbi gjendjen e mjedisit në komunën e Prishtinës do të analizohen treguesit e cilësisë së mjedisit, fizik dhe biologjik (gjeologjia, hidrologjia, përdorimi i tokës, biodiversiteti, cilësia e ajrit, e ujërave sipërfaqësore, ndotja e tokës, pikat e nxehta mjedisore, niveli i zhurmave, menaxhimi i mbetjeve në përgjithësi dhe atyre urbane në veçanti, sipërfaqet e gjelbra, turizmi, etj. Mbi bazën e kësaj analize do të vlerësohet situata mjedisore aktuale dhe do të identifikohen zonat me problematike të Lagjes si në aspektin e ndotjes ashtu dhe vlerave rekreative.
Raporti do të përmban analizën mjedisore të alternativave, e cila ballafaqon alternativën “zero” (mos bej asgjë). Këtu evidentohen përparësitë e zhvillimit të planifikuar në drejtim të krijimit të një Lagje me më shumë infrastrukturë dhe me më pakë zhurmë e pluhur, me më shumë hapësira të gjelbra dhe me të pastër, e një

Lagje që rritet dhe zhvillohet me një cilësi jete më të mirë që orientohet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Do të jepen parimet kryesore mjedisore dhe shqyrtohen objektivat strategjike të zhvillimit të Lagjes.

Vendosja e objektivave për mbrojtjen e mjedisit është kërkesë e VSM Nr. 03/L-230 dhe Direktivës se 2001/42/EC te BE. Objektivat që synohet të arrihen, përcaktohen mbi bazën e situatës mjedisore të komunës së Prishtinës, problemeve mjedisore të identifikuara dhe kërkesave që synon të realizojë projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”.

Mbi bazën e informacionit mbi situatën aktuale mjedisore, ndikimet eventuale të të realizimit të projektit për ndërtimin e Lagjes “B” Prishtina e Re – Zona Lindje në shëndetin e njeriut dhe elementet e mjedisit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin komunal, në të propozohen masa për zbutjen e çdo ndikimi negativ në cilësinë e mjedisit nga zbatimi i Planit të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”.

Do të vlerësohen ndikimet si pozitive dhe negative nga alternativat e zhvillimeve të Planit zhvillimor Komunal të Prishtinës, konkretisht nga zbatimi i Planit të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, me objektiv që të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve që banojnë aktualisht në afërsi dhe që do të akomodohen në të ardhmen në Lagjen e re. Mbi bazën e vlerësimit analitik të cilësisë së elementeve të mjedisit si ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mbetjeve të ngurta, zhurmave, sipërfaqeve të gjelbra, në zonat e ndryshme të komunës, do të bëhen propozime për masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike, sipas karakteristikave dhe mundësive që lejohen për ndërhyrje për tu konsideruar nga ekipi i hartimit të VSM. Në përgjithësi masat zbutëse dhe kufizuese/ndaluese do të synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi nga zbatimi i Planit të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”. të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Gjithashtu, do të trajton aspektet e monitorimit afatgjate për verifikimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Do të monitorohen treguesit e objektivave të mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Qëllimi i monitorimit të Planit zhvillimor për ndertimin e Lagjies Prishtina e Re –Zona Lindje, është identifikimi në kohë i efekteve të padëshiruara që mund të shfaqen në fazat e hershme të zbatimit të PZhK-së, për të mundësuar masat e nevojshme për

parandalim apo zbutjen të këtyre efekteve. Për këtë qëllim është hartuar një program monitorimi i cili do të ndjekë të gjitha zhvillimet në kuadrin e zbatimit të Planit.

Raporti përfundon me një përmbledhje të shkurtër dhe disa sugjerime për veprime kryesore mjedisore që duhen ndërmarrë dhe pasur parasysh nga zbatimi i Planit të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje"..

4. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL(informatat e rëndësishme për VSM-në)

Nevoja për Plan zhvillimor komunal

Komuna e Prishtinës ka përjetuar një proces më të hovshëm të urbanizimit. Pas luftës në Kosovë rajoni por edhe komuna e Prishtinës ka përjetuar migrimin të një pjese të popullatës nga zonat rurale dhe ato të thella malore drejt zonave periurbane dhe të vendbanimeve të mëdha të komunës.

Në vitet e para të pas luftës mungesa e PZhK-së është justifikuar me

(I) Mungesën e kornizës ligjore,
(II) Mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare
(III) Paqartësinë profesionale për natyrën e politikës për tu përballur me këtë fenomen, dhe
(IV) Pa-aftësinë për ta kthyer çështjen e Planifikimit Zhvillimor Komunal dhe Urban në një prioritet për qeverinë komunale. Ndërsa viteve të fundit, dukshëm, çështja e planifikimit dhe zhvillimit komunal dhe urban ndërtoi interesa që u konsoliduan në sektorin e ndërtimit me ndikim të dukshëm në ekonomi, por që nuk ishin vazhdimisht në balancë me interesin publik. Kjo situatë justifikoi gjithmonë ndërhyrje të pjesshme në indin ndërtimor të vendbanimeve pa u kujdesur për një vizon të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm komunal në të gjithë vendbanimet e Prishtinës.

Kjo gjë ka rezultuar me një përdorim të paefektshëm të tokës, që është i kushtueshëm për shërbimet dhe kërkojnë mobilitet të lartë. Në një pjesë të Prishtinës, ngjeshja kaotike e vendbanimeve ushtron presion në shërbimet ekzistuese, shkakton kërcënim për trashëgiminë dhe zvogëlon zonat e gjelbra dhe të qarkullimit. Në tërësi, në vendbanimet ka ndodhur një degradim serioz mjedisor.

Në këtë mënyrë, Komuna e Prishtinës vendosi të përgatisë dhe miratojë një planin zhvillimor komunal që do t'i përgjigjej më mirë situatës aktuale të përdorimit të tokës dhe do të akomodonte nevojat e komunës për planifikim dhe zhvillim.

Karakteristikat funksionale të vendbanimeve
Bashkësitë lokale

Zhvillimi urban i qytetit të Prishtinës, është përcaktuar gjatë 50 vjetëve të fundit me plane të ndryshme urbanistike. Plani Strategjik i Prishtinës, në relacion me atë të vitit

1986, i ka zgjeruar kufijtë për zhvillimin urban, duke treguar në vlerën e hapësirës së pandërtuar dhe nevojën për konsolidimin e qytetit.

Nga viti 1981, nuk ka pasur regjistrim të popullsisë në Kosovë. Pas luftës së fundit, Prishtina është stërngarkuar me popullatë. Manipulohet me shifra , por duke u mbështetur në analiza dhe numrin e votuesve, numri rezident i qytetarëve në qytetin e Prishtinës, mund të jetë përafërsisht 400 mijë, ndërsa me fshatrat deri 470 mijë.Gjatë ditës në kryeqytet mendohet se lëvizin deri në 500 mijë qytetarë.Gjatë të gjitha periudhave historike, Ballkani Qendror dhe ai Lindor ishte dhe vazhdoi të mbetet hapësira më dinamike e lëvizjeve etnike dhe shoqërore e ngjarjeve historike e politike. Për këtë arsye, ndodhi edhe ndryshimi në strukturën etnike e fetare.

Sipas Plani Zhvillimor Urban të Prishtinës 2012–2022 në Prishtinë janë këto bashkësi lokale:

1. **Qendra:** Përfshinë një sipërfaqe prej rreth 69 Ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit. Në përbërje të saj funksionojnë shumica e institucioneve administrative, arsimore dhe sportive. (Kampusi Universitar).
2. **Lakrishte:** Përfshinë një sipërfaqe prej rreth 57 ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit. Në përbërje të saj gjinden shumica e institucioneve qeveritare të përqendruara në ndërtesën e ish – Rilindjes, në këtë bashkësi lokale bën pjesë edhe Lagjja Pejton.
3. **Dardania:** Përfshinë një sipërfaqe rreth 533 ha, gjendet në zonën qendrore dhe periferike të qytetit. Në këtë bashkësi lokale përveç Lagjes Dardania, bëjnë pjesë edhe lagjja Kalabria, Zona ekonomike (rruga për Fushë Kosovë) dhe kompleksi i FSK-së).
4. **Ulpiana:** Përfshinë një sipërfaqe prej 22 ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit.
5. **Ulpiana 1:** Përfshinë një sipërfaqe prej 401ha, gjendet në zonën periferik të qytetit. Në kuadër të sajë gjendet edhe një pjesë e Lagjes Mati, si dhe kompleksi i QKUK-së, gjithashtu përfshinë edhe një pjesë të planit rregullues "Prishtina e re".
6. **Kodra e Diellit:** Përfshinë një sipërfaqe prej 83 Ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit. Në kuadër të saj gjendet edhe një pjesë e Lagjes Aktashi, kampusi i konvikteve të studenteve dhe kompleksi i Banesave të Bardha.
7. **Lagjja e Muhaxherëve:** Përfshinë një sipërfaqe prej 35 ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit. Në kuadër të saj gjendet edhe Parku i qytetit dhe një pjesë e Lagjes Dodona.
8. **1 Lagjja e Muhaxherëve:** Përfshinë një siperfaqe prej 41 ha, gjendet ne zonën qendrore të qytetit. Në kuadër të saj është pjesa tipike e Muhaxhireve si dhe varri i ish. Presidentit I. Rugova dhe varrezat e deshmorëve.

9. **2 Lagjja e Muhaxherëve (Matiçan):** Përfshin një sipërfaqe prej rreth 281 ha, gjendet në zonën periferike të qytetit. Në kuadër të saj gjendet një pjesë e zonës kadastrale Mati.
10. **Taukbashqe (Sofali):** Përfshinë një sipërfaqe prej 160 ha, gjendet ne zonën periferike të qytetit. Në kuadër të saj, është një pjesë e zonës kadastrale Sofalia dhe Parku i Taslixhes.
11. **Taukbashqe:** Përfshinë një sipërfaqe prej 112 ha, gjendet në zonë periferike të qytetit.
12. **1 Taukbashqe:** Përfshinë një sipërfaqe prej 116 ha, dhe gjendet në zonën periferike të qytetit.
13. **Blloku B:** Përfshinë një sipërfaqe prej 38 ha, gjendet në zonën qendrore dhe periferike të qytetit.
14. **Kodra e Trimave:** Përfshinë një sipërfaqe prej 41 ha, gjendet në zonën qendrore.
15. **Kodra e Trimave:** Përfshin një sipërfaqe prej 150 ha, gjendet në zonën periferike të qytetit.
16. **1: Kodra e Trimave:** Përfshinë një sipërfaqe prej 350 ha, gjendet në zonën periferike të qytetit, në këtë b. lokale gjenden edhe varrezat e qytetit.
17. **2 - Kodra e Trimave:** Përfshinë një sipërfaqe prej 353 ha, gjendet në zonën periferike të qytetit.
18. **Tophane:** Përfshinë një sipërfaqe prej 16.6 ha gjendet në zonën qendrore të qytetit.
19. **Tophane 2:** Përfshinë një sipërfaqe prej 12.1 ha, gjendet në zonën qendrore të qytetit.
20. **Arbëria (Dragodani):** Përfshinë një sipërfaqe prej rreth 475 ha, gjendet në zonën periferike dhe qendrore të qytetit. Nëpër këtë bashkësi lokale kalon rruga, e cila shkon për Mitrovicë.

Qyteti: Prishtina dhe fshatrat:

Ballaban; Barileva; Besia; Bërnica e Epërme; Bërnica e Poshtme; Çagllavica; Dabisheci; Dragoci; Drenoci; Gllogovica; Grashtica; Hajkobilla; Keçekolla; Koliçi; Kolovica; Kukaaj; Lebana; Llukari; Makoci; Mareci; Matiçani; Mramori; Bardhoshi; Nisheci; Shkabaj; Prapashtica; Prugoci; Radisheci; Rimanishta; Sinidolli; Siqeva; Slivova; Sofalia; Sharbani; Shashkoci; Tenezhdolli; Truda; Vranidolli;Zllashi; Zllatari

KUSHTET TJERA MJEDISORE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Ndërtimi gjeologjik i komunës së Prishtinës

Nga aspekti gjeotektonik Prishtina dhe rajoni i gjere përreth i takojnë zonës se Vardarit gjegjësisht nën zonës Eksterne të saj. Masat shkëmbore te cilat e ndërtojnë rajonin e gjerë përreth Prishtinës i takojnë moshës se Paleozoikut, Mezozoikut,

Terciarit dhe Kuaternarit. Karakterizohen me rrudhosje dhe lëvizje tektonike te theksuara me depërtime te shpeshta te masave te mëdha vullkanike dhe ndërfutjeve diaperike të serpentiniteve përgjatë çarjeve te theksuara tektonike. Rajoni i Prishtinës gjendet ne kufij ne mes te kompleksеve shkëmbore te formacioneve te vjetra (të para neogjenit) dhe formacioneve te reja te cilat i përkasin basenit te Kosovës (neogjenit). Përbërja gjeologjike dhe mbërthimi tektonik i terrenit janë si rezultat i proceseve te cilat kanë ndodhur ne periudha te gjata kohore siç janë: transgresionet dhe regresionet e shpeshta, presionet tektonike dhe proceset e metamorfizmit.

KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE

Rajoni i Prishtinës sipas tipeve morfologjike te relievit ndahet ne:

- Terrenet e rrafshëta (unazat perëndimore) dhe
- Terrenet kodrinore- malore(unazat lindore)

Terrenet e rrafshëta shtrihen përgjatë rrjedhjeve te djathta te lumit Sitnicë(përmes luginave te lumit Graqanicës, Prishtevkes, Matiqanit, Velushes dhe Batllaves). Lartësitë mbidetare përgjatë këtyre luginave të lumenjve të cekur më lartë sillen prej 570-580 m.

Karakteri morfologjik përgjatë luginave lumore të cekura më lartë lejon qe niveli i ujerave nëntokësore në këto terrene te jetë i lartë.

Terrenet kodrinore-malore karakterizohen me një ngritje të butë të relievit nga perëndimi drejt lindjes dhe se në një distancë prej 7-8 km lartësia mbidetare rritet nga 550 deri ne 700-730 m.

Rrjedhjet lumore në drejtimin perëndimor-jugperëndimor gradualisht kalojnë në luginat e hapura me rënie te buta duke u bashkuar në pellgun e Sitnicës.

Karakteristikat e theksuar te relievit ngushtë janë të lidhura me ndërtimin gjeologjik të terrenit. Terrenet të cilat janë te formuara nga depozitimet aluviale te Kuaternarit paraqesin pjesët e rrafshëta gjersa sedimentet e Neogjenit te cilat i nënshtrohen denudimit intensiv përfaqësojnë terrenet kodrinore me rënie të butë, kurse rrjedhjet lumore në formacionet e vjetra formojnë lugina të pjerrëta. Ky karakter morfologjik i terrenit tregon për një ngritje intensive relative te pjesës lindore te Prishtinës ne etapën bashkëkohore gjeologjike. Këto karakteristika morfologjike ndikojnë ne stabilitetin e pjerrësirave sidomos ne terrenet ku formacionet e reja te Neogjenit kanë një trashësi të konsiderueshme mbi flishet jo-ujëlëshues të shtresave te Kretakut.

KARAKTERISTIKAT GJEOLOGJIKE TË ZONËS

Lokacioni ku do zbatohet Plani zhvillimore për ndertimin e Lagjes Urbane “B” Prishtina e Re – zona lindje kryesisht përbëhet nga depozitimet e Kuaternarit të cilat në masë të madhe i mbulojnë formacionet e përshkruara më sipër

Depozitimet deluviale paraqiten rrëzë shpatijeve me rënie të butë dhe të fortë. Kryesisht i takojmë në veri të fshatit Hajvali dhe përgjatë luginës së lumit të Matiqanit dhe rrëzë shpateve të lumit të Graqanicës.

Depozitimet aluviale gjenetikisht janë të lidhura përgjatë zgjërimeve të rrjedhave lumore me depozitimin e materialit kokërrzimët, argjilave organogjene, argjilave pluhurore dhe rërave kokërrimëta.

Në pjesët e sipërme të rrjedhave lumore janë të depozituara aluvionet me fraksione më të mëdha të rërave dhe zhavorreve të përcjellura me komponentet argjilore-llumore në vendet me transport të ngadalshëm.

TË DHËNAT SEIZMIKE

Qyteti i Prishtinës me rrethina gjendet në zonën e rajonit sizmik aktiv. Të dhënat nga termetet e gjerëtanishme që kanë ndodhur në këtë rajon janë mjaftë të varfura. Mirëpo bazuar nga termetet e gjerëtanishme, rajoni i Prishtinës me rrethinë është klasifikuar në zonën me intensitet prej VIII^0 sipas shkallës së Merkalit

Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor që është potencial të futet nën mbrojtje .

Bimësia dhe vegjetacioni

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore.

Mirëpo, në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethinë të zonës ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kulturat bujqësore, kurse në lokacionin më të gjerë bimësi drusore, kaça, murriz, mana, manaferra, etj.

Bota shtazore – fauna

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendoret, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, ndersa me larg, derri i egër.

Prej brejtësve jetojnë- minjtë, prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm, breshkat e tokës, zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorrat, gjeraqinat,etj.

Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin “Prishtina e Re – mjedisi. Me këtë rast gjithësesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Projekti i lartë shënuar nuk ka ndonjë ndikim negativ në prishjen e peizazhit në lokacionin e analizuar, sepse ky lokacion do të shëndrohet në një vendbanim me të gjitha karakteristikat e vendbanimit normal i cili në kontinuitet vizuel inkuadrohet me vazhdimesi me rrethinën.

Ajri

Edhe pse në rrethinë të këtij lokacioni - në rrafshin e Kosovës shkalla e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës është evidente për arsye të veprimtarisë prodhuese të Termocentraleve A dhe B kurse vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin aktual nuk ka.
Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe funksionimi i aktiviteteve në lagjën "Prishtina e Re- Zona Lindje" nuk ka ndonji ndotje të konsiderueshme të ajrit në këtë mikro terren.

Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga veprimtaritë industriale dhe shkarkimi i ujërave të amvisnisë si dhe nga plehrimi i tokave punuese.
Ndërsa sa i përket ndotjes se ujit nga aktiviteti në lagjën "Prishtina e Re- Zona Lindje" , mund të konstatojmë se objekti në fjalë nuk do të kenë ndikim të theksuar të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokesore, për arsye se sipas planit të gjitha ujërat e zeza do të trajtohen paraprakisht.

Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Në Prishtinë mbizotëron klima kontinentale me një temperaturë vjetore mesatare prej 10,4 °C dhe me reshje vjetore mesatare prej 600 mm. Në korrik arrinë tempreatura vjetore mesatare prej 30 °C, në janar prej -0,6 °C.

Table 1 Karakteristikat klimatike të Prishtinës

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrikk	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
Temp. Maks. (°C)	2,4	5,5	10,5	15,7	20,7	23,9	26,4	26,7	23,1	17,1	10,2	4,2	Ø	**15,5**
Temp. Mini. (°C)	-4,9	-2,8	0,2	4,2	8,5	11,4	12,5	12,3	9,4	5,0	0,9	-3,1	Ø	**4,5**
Temperatur (°C)	-3	-3	2	7	14	18	20	20	15	11	5	-2	Ø	**8,7**
Reshje (mm)	54,99	48	56	62	81,01	78	60	53	58,99	55,99	74,01	69,01	Σ	**751**
Ditë me diell (h/d)	9,01	10,02	11,05	13,02	14,03	15,01	14,05	13,05	12,03	11,06	9,04	9,01	Ø	**11,7**



Figure 1 Diagrami i temperaturave vjetore

Hidrologjia

Në aspektin hidrologjik ujërat sipërfaqësorë të komunës së Prishtinës karakterizohen me disa lumenj si; lumi Prishtevka, Vellusha, Matiqani, Bernica, lumi Llap i cili shërben si mbledhës i të gjithë lumenjve dhe përrockave të fushë gropës së komunës së Llapit dhe Prishtinës apo rrjedhjeve në formë të përroskave që janë aktiv sipas sezoneve apo të reshurave atmosferike. Sasia më e madhe e ujërave në këta lumenj është në muajin Shkurt dhe Mars kurse sasia më e vogël është në muajin Gusht dhe Shtatorë.

Si resurs natyror i veçantë i kësaj zone është afërsia me Liqeniin e Badovcit duke i siguruar kësaj pjese front ujor – gjë tejet e rrallë për rrethanat e Kosovës dhe unike në qytetin e Prishtinës.

5.0 Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasoj e aktiviteteve të ndërtimit dhe aktiviteteve gjatë funksionimit që do kryhen në projektin për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vije sipas një analize gjithëpërfshirëse. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre.

Ndikimet në mjedis mund të lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në tre periudha themelore dhe ate:

Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis duhet të bëhet për fazën së realizimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” , për fazën e zhvillimit të aktiviteteve në kompleksin e objekteve banesore, gjithashtu duhet paraparë ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të aktivitetit, jetëgjatësisë së projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”

Ndikimet në ajër

Gjatë fazës së realizimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” nuk kemi ndotje të theksuar të ajrit. Ndotja e ajrit ndodhë nga makinat ngarkuese dhe automjetet transportuese, që nevojitën për hapjen e traseve të rrugëve, gërmimin e bazamenteve dhe transportimin e materialit ndërtimor, ndotja nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese gjatë realizimit të fazës së ndërtimit.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve punuese në objekte banesore me infrastrukturë përcjellëse ndotje të ajrit mund të ndodhë nga gazërat të cilët lirohen nga lëndët djegëse që nevojitën për përgatitjen e ushqimit, ngrohjen e ujit dhe ngrohjen e objekteve gjatë stinës së dimrit, e cila ndotje është minimale. Ndotja e ajrit ndodh nga avujt që lirohen nga vaji dhe hapësirat e kuzhinës, që nevojitet për përgatitjen e llojeve të ushqimit, nga tymërat që lirohen nga pirja e duhanit të banuesve dhe vizitorëve, nga gazërat të cilët lirohen nga gjeneratori, nga gazërat të cilët lirohen nga automjetet e banuesve dhe vizitorëve.

Ndotje ajrit mund të ndodh nga aroma e pakëndshme që lirohet nga rrjeti i kanalizimit i cili do të vendosët nëntokë me sistem tubacionesh nga PVC dhe do të ketë akumulim gjithpërfshirës në gropën septike e cila duhet të jetë e izoluar mirë ashtu që të mos ketë rrjedhje direkte në tokë dhe të bëhet evitimi i plotë i erërave.

Ndikimet në tokë

Gjatë fazës së realizimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, ndikim negativ në tokë paraqitet nga deponimi i dheut të gërmuar nga bazamentet, si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët, nga pluhurat që lirohen nga sipërfaqet punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet transportuese që transportojnë materialin ndërtimorë.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve banuese ndotje në tokë mund të ndodhin nga mbeturinat e ndryshme organike dhe joorganike të cilat i krijojnë banuesit, nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga

automjetet e parkuara në parkingun – parkingjet e kompleksit të objekteve banesore, nga derdhja e derivateve nga gjeneratori etj.

Ndikim tjetër negativ mund të ketë nga ujëmbledhësit dhe kanalizimi nëse nuk bëhet mirë izolimi i gropës septike, seperatorëve dhe tubave të kanalizimit atëherë shfaqet rreziku përmanent për ndotjen e tokës nga ujërat e zeza, vajrat e yndyrat. Mirëpo, eliminimi i kësaj mundësie duhet të bëhet me izolim të plotë të gropës septike, seperatorëve dhe vendosje adekuate të tubacioneve përcjellës.

Ndikimet në ujë

Gjatë fazës së realizimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" dhe fazës së zhvillimit të aktiviteteve banimi dhe relaksimi, ndikimet negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura më lartë me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike, ndotja e ujërave ndodh me larjen pajimeve të punës gjatë fazës së ndërtimit.

Gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve banuese, ndotje e ujit ndodh nga derdhja e ujërave të zeza, derdhja e ujërave të përdorura në kuzhinë dhe lavatriqet për larjen e mbulesave (rrobave) të ndryshme, larja e platos së autoparkingut- autoparkingjeve, etj.

Ndikim tjetër negativ mund të ketë nga ujëmbledhësit dhe gropës septike e seperatorëve. Ndotja e ujit në këtë lokalitet shkaktohet nga vizitorët e shumtë me hedhjen e mbeturinave.

Ndikimet në Peizazh

Duke pasur parasysh pozitën e lokacionit, formën dhe pozitën e vendosjes së objekteve banesore me infrastrukturë përcjellëse në ketë lokacion, mendojmë se realizimi i projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" nuk do të ketë ndikime negative në peizazh, përkundrazi do të ndikoj pozitivisht në aspektin e të jetuarit në këtë hapësira.

Ndikimet në botën bimore dhe shtazore

Gjatë fazës së realizimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" dhe në sipërfaqen manipuluese bota bimore tërësisht do të zhduket, e cila duhet të mbillet pas përfundimit të fazës së ndërtimit të kompleksit të objekteve banesore me infrastrukturën përcjellëse.

Sipërfaqet e lira të ngastrave përreth zonës ku do zhvillohet projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" do të mbillen me barë, lule të ndryshme aromatike dhe drunj të ndryshëm dekorativ duke ju përshtatur ambientit rrethues.

Ndikimet në popullatë

Zhvillimi i projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" në këtë lokalitet ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rajoni, për atë se për realizimin e këtij projekti do të punësohen një numër i konsideruar i punëtorëve.

Me realizimin e këtij projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" krijohen mundësitë më të mëdha për zhvillimin e ekonomik dhe kulturor, pra do të ketë ndikime positive.

Ndikimet nga Zhurma

Ndikimet negative nga zhurma do të ketë vetëm gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" e cila do të jetë e nivelit të tolerueshëm.

Gjatë fazës së kryerjes të aktiviteteve punuese, ndikime negative të mëdha nga zhurma nuk do të ketë, prandaj ndërtimi dhe shfrytëzimi i kompleksit të objekteve banesore në këtë lokalitet nuk do të ketë ndikime negative në aspektin e zhurmës.

Diagrami i nivelit të zhurmës

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db-niveli për pajisje moderne	59	45	39	25

Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë.

Aksidentet mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit, lëndimet e punëtorëve gjatë kryerjes të aktiviteteve ndërtuese, nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së tubave hidraulik, nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të materialit ndërtimor etj.

Në fazën e kryerjes se aktiviteteve punuese në kompleksin e objekteve banesore, aksidentet mund të ndodhin nga mundësia e shkaktimit të zjarrit. Zjarri mund të shkaktohet nga parregullsitë në instalimet elektrike, tejngarkesat elektrike, nga mos kujdesi i banuesve gjatë përdorimit të instalimeve. Aksidentet mund të ndodhin nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse të automjeteve të parkuara, nga rrjedhja e ujërave të përdorura dhe ujërave të zeza si pasojë e pëlcitjes të tubave të kanalizimit, tejmbushjes së seperatorëve dhe gropave septike.

Zhvillimi ekonomik

Numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara në Komunën e Prishtinës, sipas llojit të pronës është 8.735 biznese me 75.089 punëtorë. Saktësisht numri i punëtorëve nuk dihet, për faktin se regjistrimi tashmë është në kompetencë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve. Për biznese merret vetëm leja, mirëpo ka shumë të atillë që nuk e kanë kryer këtë procedure të domosdoshme. Aktualisht në sektorin e gjuetisë dhe pylltarisë janë 27 biznese me 29 punëtorë, ndërsa në atë të peshkimit janë 31 punëtorë dhe dy biznese. Në sektorin e industrisë nxjerrëse ekzistojnë 16 biznese me 107 punëtorë, në industri përpunuese janë 600 biznese me 4.527 të punësuar, ndërkaq sektori i furnizimit me energji elektrike, gas dhe ujë numëron 5 biznese me 12.836 punëtorë. Në fushën e ndërtimtarisë janë 329 biznese me 3.976 të punësuar, ndërsa tregtia me shumicë dhe pakicë, i riparimit të biçikletave, motoçikletave dhe artikujve për përdorim personal e shtëpiak ka 4.203 biznese me 21.026 punëtorë. Një biznes mjaft i përhapur në kryeqytetin e Kosovës është edhe ai i hotelerisë, ku aktualisht veprojnë 781 restorante dhe hotele me 6.584 të punësuar.

Biznesi i transportit, magazinimit dhe i komunikacionit përfshinë 1.672 biznese me 18.351 të punësuar, ndërkohë me biznes të ndërmjetësimit financiar janë të punësuar 285 persona dhe kjo veprimtari ka 26 biznese. Në shërbimin e afarizmit ekzistojnë 273 biznese me 285 të punësuar. Numri i përgjithshëm i bizneseve në Prishtinë është 8.412, ndërkaq numri i përgjithshëm i të punësuarve kap shifrën në 73.429. Vetëm gjatë vitit të kaluar në Komunën e Prishtinës janë regjistruar 2.908 biznese, kanë njoftuar në media zyrtarë nga Agjencia për Regjistrim të Bizneseve në MTI. Ata kanë thënë se rreth 50 për qind të bizneseve janë regjistruar në veprimtarinë e tregtisë me shumicë dhe pakicë.

Nga rreth 3 mijë biznese të reja dhe të regjistruara gjatë vitit 2004, tregtia është biznesi më i preferuar edhe në kryeqytetin e Kosovës.

Sipas listës së MTI-së për biznese dhe klasifikimit të tyre në bazë të veprimtarive, në nivel të Kosovës tregtia me shumicë merr pjesë me 11 për qind, derisa ajo me pakicë 37 për qind, apo shprehur në shifra ka 5837 biznese të tregtisë me shumicë dhe pakicë.

Sipas kësaj liste radhiten: Me 12 për qind transporti tokësor, ajror, i udhëtarëve, pastaj shërbimet hoteliere, restorantet, hotelet, motelet, mensat ushqimore me 9 për qind, veprimtaritë publike shërbyese me 5 për qind, ndërsa prodhimi i ushqimit dhe pijeve merr pjesë me vetëm 3 për qind.

Aktualisht në Komunën e Prishtinës si pronar të vetëm janë të punësuar 29.605 punëtorë me 7.936 biznese, ndërkaq në partneritet janë 7.037 të punësuar në 339 biznese. Si kompani të përbashkëta janë 54 biznese dhe 10 kooperativa me 131 të punësuar. Në pronën private me përgjegjësi të kufizuar, në kryeqendrën e Kosovës aktualisht janë 183 veprimtari me 1.375 të punësuar, kompani publike janë 13, kurse

ekzistojnë edhe 57 prona shtetërore me 15.472 punëtorë dhe 143 biznese shoqërore me gjithsej 14.137 punëtorë

Objekte turistike dhe kulturore

Ndër objektet turistike dhe kulturore më të vizituara në Konunën e Prishtinës janë:

- Monumenti „Skënderbeu“
- Monumenti i heroit kombëtarë "Zahir Pajaziti"
- Monumenti NEWBORN
- Teatri i Kosovës
- Parku Nacional „Gërmia“
- Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës
- Biblioteka Hivzi Sylejmani
- Galeria e Arteve
- Muzeu i Kosoves
- Sahatkulla
- Xhamia e Madhe (zyrtarisht Xhamia e Sulltan Mehmetit II al-Fatih-u)
- Xhamia e Qarshisë
- Hamami i madh
- Parku etnologjik "Emin Gjiku"
- Xhamia e Jashar Pashës
- Xhamia e Llapit
- Shadërvani

Infrastruktura

Infrastruktura e transportit dhe transporti

Traseja e Autostrades R7

Neper Territorin e Prishtiens kalon nje pjese e Autostrades R7 Prishtine-Prizren-Durres. Ajo posedon dalje ne jug ne Fushe Kosove dhe ne veri fshatin Mazgit. Gjithashtu kjo autostrade lidhet me Autostraden R6 ne drejtim te kufirit me Maqedonine, ndertimi i se ciles ka filluar ne vitin 2014 dhe pritet te perfundoj ne vitin 2017, ku pritet te lidhe Prishtinen me Shkupin permes Ferizajt dhe Hanit te Elezit.

Rruge me rendesi te vecant per Prishtinen jane rruget magjistrale M9 e cila e lidhe Prishtinen me Medvegjen ne piken kufitare te Mutivodes ne Malesine e Gollakut ne veri-lindje dhe ne perendim kalon permes qytetit te Pejes, Grykese se Rugove deri ne kufirin e Malit te Zi dhe permes Qafes se Çakorit deri ne Plav ne Mal te Zi.

Largësia nga Prishtina:

- Shkupi – 86 km
- Tirana – 330 km
- Beograd – 360 km
- Podgorica – 298 km
- Ferizaj – 36 km
- Gjilan – 46 km



Figure 2 Harta e infrastruktures rrugor

6.0 PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHEM PËR REVIDIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM NË TËRËSINË URBANE "B" TË LAGJES "PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE"

6.1 Pozita gjeografike e lokacionit

Lagjja "Prishtina e Re – Zona Lindje" ndodhet në pjesën jugore-lindore të qytetit të Prishtinës, përkatësisht në pjesën Lindore të territorit të Prishtinës së Re. Zonën të cilën e përfshin Revidimi i Planit Rregullues të Hollsishëm, në pjesën veriore - perëndimore kufizohet me Prishtinen e re, zona lindje me fshatin Zllatar. Në jug-lindje me liqenin e Badovcit, ndërsa në pjesën perëndimore me Zonën Qendër të Prishtinës së Re, në pjesën jugore (pjesërisht) integron Unazën e jashtme të qytetit.



Figure 3 Plani zhvillimor Komunal

PARCELAT KADASTRALE BRENDA KUFIRIT TË HAPËSIRËS QË TRAJTOHET

Zona Kadastrale Matiçan:

1390-0,9000-9, 1392-0, 1386-0, 1421-0, 1384-0, 1385-0, 1374-0, 1398-0, 1399-0, 1397-0, 1402-0, 1404-0, 1403-0, 1393-0, 1400-0, 1395-0, 1394-0, 1401-0, 1381-0, 1380-0, 1405-0, 1396-0, 1383-0, 1382-0, 1420-0, 1367-0, 1361-0.

Zona Kadastrale Hajvali:

28-2, 22-0, 0019-0, 002-1, 001-1, 005-0, 004-1, 1239-2, 1239-1, 0516-2, 0023-0, 0026-0, 0024-0, 0025-0, 004-2, 0059-0, 0028-1, 0027-0, 0058-0, 0062-0, 0065-0, 0064-0, 0063-0, 0057-0, 0056-0, 1217-0.

Zona Kadastrale Zllatar:

466-0, 459-0, 584-0, 616-0, 467-0, 468-0, 469-0, 470-0, 583-0, 557-0, 472-0, 474-0, 475-0.



Figure 4 Parcelat kadastrale që përfshihen në Plan

Sa i përket pronësisë së këtyre parcelave janë identifikuar Parcela me pronësi Republika e Kosovës, P.Sh. Kuvendi Komunal, Private dhe parcela 19-0 ZK. Hajvali dhe 9000-9 ZK. Matiçan në sistemin Kadastral figurojnë si parcela që nuk kanë të dhëna për t'u paraqitur.

Zona kadastrale Hajvali



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë
Zona kadastrale / Katastarska zona: Hajvali

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice :
Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 5000

Zona kadastrale: Hajvali

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

Nr	Y	X
1	7516075.207	4721076.383
2	7516042.623	4721114.440
3	7516013.934	4721136.409
4	7516025.694	4721138.799
5	7516053.595	4721163.788
6	7516068.426	4721176.407
7	7516078.986	4721183.737
8	7516111.506	4721200.406
9	7516133.317	4721226.494
10	7516158.178	4721244.503
11	7516236.830	4721297.790
12	7516268.991	4721332.348
13	7516318.222	4721360.337
14	7516377.259	4721400.593
15	7516406.950	4721420.701
16	7516482.156	4721454.133
17	7516549.454	4721449.543
18	7516564.365	4721448.439
19	7516596.069	4721465.870
20	7516649.921	4721481.437
21	7516713.810	4721469.781
22	7516745.968	4721473.353
23	7516758.388	4721488.155
24	7516846.438	4721458.124
25	7516907.775	4721437.620
26	7516946.823	4721424.689
27	7516979.914	4721379.772
28	7517015.183	4721323.987
29	7517082.087	4721241.668
30	7517103.808	4721233.302
31	7517146.543	4721236.626
32	7517227.135	4721193.480
33	7517144.694	4721139.840
34	7517102.491	4721112.668
35	7517075.615	4721096.167
36	7517037.472	4721074.744
37	7517007.158	4721059.854
38	7516954.312	4721038.301
39	7516914.146	4721025.367
40	7516873.693	4721015.146
41	7516823.898	4721006.236
42	7516770.518	4721001.013
43	7516743.810	4721000.045
44	7516713.696	4721000.260
45	7516688.181	4721001.491
46	7516670.027	4721002.861
47	7516638.348	4721005.993
48	7516628.461	4721030.737
49	7516612.026	4721045.358
50	7516592.671	4721051.853
51	7516564.635	4721047.874
52	7516543.413	4721031.049
53	7516536.584	4721018.817

Rilevoi / Snimio: Bsc. Zeqir Thaqi
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ime i prezime geodeta/ kompanije)
Nr. i licencës / Br. licence: 154
V.V.
Nënshkrimi / Potpis:
Data e rilevimit / Datum snimanja: 30.05.2019

Zona kadastrale Zllatar



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë
Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : _____
Zona kadastrale / Katastarska zona: Zilatar
Shkalla e zvogëlimit / Razmera plana 1: 500

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

Nr	Y	X
1	7517443.950	4721334.548
2	7517476.642	4721582.633
3	7517483.771	4721613.353
4	7517502.751	4721693.964
5	7517548.707	4721870.760
6	7517566.783	4721879.640
7	7517579.432	4721878.374
8	7517600.935	4721868.622
9	7517618.823	4721865.371
10	7517643.287	4721869.691
11	7517657.498	4721877.193
12	7517665.153	4721881.639
13	7517689.956	4721848.146
14	7517726.373	4721778.207
15	7517743.052	4721746.468
16	7517755.781	4721734.628
17	7517763.430	4721716.659
18	7517775.360	4721701.429
19	7517812.259	4721675.159
20	7517851.178	4721665.489
21	7517885.728	4721667.918
22	7517932.289	4721690.336
23	7517943.614	4721691.520
24	7517941.642	4721683.577
25	7517940.915	4721675.336
26	7517941.304	4721668.379
27	7517943.151	4721659.572
28	7517881.408	4721619.174
29	7517757.736	4721538.708

Rilevoi / Snimio: Bac.gjeo.Zeqir Thaqi
(emri dhe mbiemri i gjeodetikompanisë bar i prezime gradnel kompanije)
Nr. i licencës / Br. licence: 154
V.V.
Nënshkrimi / Potpis: _____
Data e rilevimit / Datum snimanja: 30.05.2019



Figure 5 Harta e pronësisë

Infrastruktura ekzistuese

Rrugët që e përkufizojnë këtë zonë janë ruajtur dhe ato janë të planifikuara në Planin Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindje” dhe Planin Zhvillimor Urban, si Unaza e

Brendshme, Unaza e Jashtme e Qytetit si dhe rrugët në pjesën lindore dhe perëndimore.

Gjithashtu, planifikohen lidhjet (kyçjet) me rrjetin e trafikut të nivelit urban si dhe lidhjet me zonat urbane përreth, për të cilat janë hartuar planet apo janë në proces të hartimit.



Figure 6 Infrastruktura rrugore e Lagjes Prishtina e Re - Zona Lindje

PIKAT E LARTËSISË (KUOTAT) SE RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE (PLANI I NIVELIMIT)

Gjatë planifikimit të rrjetit të trafikut është marrë parasysh topografia ekzistuese. Rrugët janë të planifikuara komfor të gjitha standardeve për profilet gjatësore të rrugëve, në varësi të kategorisë së rrugës.



Figure 7 Plani i nivelimit

Rrjeti i planifikuar rrugor në lagjen Prishtina e Re – Zona Lindje është bazuar kryesisht në teren dhe pak a shumë në rrjetin e planifikuar paraprakisht me qëllim të lehtësimit të implementimit. Poashtu pikat e lartësisë së rrugëve, mu për këtë qëllim janë respektuar maksimalisht. Lartësitë e terenit në këtë zonë sillen rreth 650-730 m.

Kërkesat minimale për vend parkingje. Parkimi i makinave për nevojat e pronarëve (shfrytëzuesve) të objekteve të banimit kolektiv, si dhe të të gjitha tipeve të ndërtimit, sigurohet në parcelën ndërtimore në brendi të bllokut. Standardi i parkimit respektivisht i garazhimit për objektet e banimit kolektiv është minimum një parking (vend garazhi) për një njesi banesore me kusht që 80 % e makinave të jetë e vendosur në garazhe apo ne baze te ketij UA08/2017 kerkohet qe per cdo 100m2 banim 2 vendparkime. Garazhet vendosen në objekte nën gabaritin e objektit, apo në tokë, nën kuotën e trotuarit edhe jashtë gabaritit të objektit, në maksimum 80 % të sipërfaqes së parcelës ndërtimore.

6.2 Përshkrimi i objekteve dhe infrastrukturës për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje

Koncepti i njësisë urbane është i bazuar në parimet e njohura të banimit dhe jetësës në hapësirat e organizuara dhe të planifikuara me parimin e ndërtimit racional, me kushte maksimale për jetesë të shëndetshme me një raport optimal të individit ndaj sigurisë së lëvizjes, gjatë komunikimit me përmbajtjet vitale të interesimeve të afërta dhe atyre më të largëta.

Në projektin ideor të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" janë të përcaktuara forma, madhësia, pozita të cilat janë të përshkruara në mënyrë detale dhe të paraqitura në mënyrë vizatimi dhe grafike në situacionet për kompleksin e objekteve banesore, objekteve shkollore, afariste, instucione publike shëndetesore, kulturore dhe të rekreacionit, si dhe infrastrukturës rrugore, të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe rrjetit energjetik, të cilat do të përshkruhen në vijim.

Ky projekt i planit rregullues përkufizon kushtet për zhvillim të qëndrueshëm dhe ambient të shëndoshë për banim, punë, dhe rekreacion.

Meqenëse, kjo tërësi urbane paraqitet si një njësi e veçantë, atëherë është konstatuar se nuk është e domosdoshme që e gjithë njësia urbane të jetë me banim individual, gjë që nuk do të ketë ndikim në dendësinë me të gjerë të zonës, ndërsa nga aspekti social të fqinjësisë në mes të banimit individual dhe atij kolektiv,

Prishtina e Re – ***Zona Lindje***, planifikohet të shëndërrohet në një lagje të shfrytëzimit të llojllojshëm me një numër të madh të:

- sipërfaqeve gjelbëruese
- sipërfaqeve për banim
- bizneseve që gjenerojnë shumë vende pune, dhe
- aktiviteteve shoqërore dhe rekreative që zhvillohen brenda saj,

Janë planifikuar që në kuader të tërësisë së zones A të planifikohen këto ndërtime publike:

- Tri institucione parashkollore (çerdhe/kopsht), dy prej të cilave duhet të jenë në pronësi publike, që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territorial rreth 6,000 m^2, d.m.th 3,000 m^2 për një institucion parashkollorë;
- Një institucion i edukimit fillorë - shkollë e mesme e ulët, që mund të ndërtohet mbi një sipërfaqe territoriale prej 10,000 m^2 ;
- Një institucion të edukimit të lartë që mund të ndërtohet mbi një sipërfaqe territorial prej 10,000 m^2 ;
- Një institucione shëndetësor që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territoriale prej 2,500 m^2 ;
- Një qendër kulturore poli funksionale (Biblioteke, muze, kinema etj.) që mund të ndërtohen mbi një sipërfaqe territorial prej 5,000 m^2;

- Hapësirë për park, sport dhe rekreacion me sipërfaqe territoriale prej 50,000 m^2;

6.2.1 Pozita e ndërtesave në parcela dhe në kuadër të parcelave fqinje

Vendosja e objekteve është përcaktuar me plan, nërsa për blloqet në te cilat mungon vendosja - përcaktimi i konturave të objekteve do të definohet sipas zgjidhjes urbane gjatë procedures për paisje me leje ndërtimore.

Elementet tjera urbane do të përcaktohen sipas normave:

Lartësia e çdo ndërtese është e bazuar në lokacion, ekspozim të diellit, pamjes dhe proporcionit arkitektonike. Grupet me lartësi të njëjtë dhe me kulme të rrafshëta krijojnë koherencë brenda zonës.

Plani ka planifikuar këto lloje të ndërtesave të banimit;

1. Ndërtesat e banimit me një/dy njësi, në të cilën përfshihen;
   - Shtëpitë e veçanta, (së paku 4 ari)
   - Shtëpitë dyshe, (së paku 3 ari)
   - Shtëpitë në varg (së paku 2 ari)
   - Ndërtesat e banimit më shumë njësi dhe ndërtesat e banimit me shumë njësi me afarizëm
   - Ndërtesat e veçanta
   - Ndërtesat në varg

   - Ndërtesat terracore
   - Ndërtesat e banimit me shumë njësi me afarizëm

ZONAT E BANIMIT

1. **Zona e banimit individual**

   ❖ I – 1 / ZB , Ndërtim të tipit B+S+P+1

   - 5 shtëpi gabariti 4.4 m x 13.0 m = 96.2 m^2
   - 14 shtëpi gabariti 8.0 m x 10.0 m = 80.0 m^2
   - Hapësira gjelbëruese S = 3,545.41 m^2

   ❖ I – 2 / ZB, Ndërtim të tipit B+S+P+1

   - 1 shtëpi gabariti 10.2 m x 15.5 m = 158.1 m^2
   - 1 shtëpi gabariti 7.9 m x 15.1 m = 135.09 m^2
   - Hapësira gjelbëruese S = 1,443.36 m^2

❖ I – 3 / ZB, Ndërtim të tipit B+S+P+1

- 3 shtëpi gabariti 8.0 m x 20.0 m = 160 m^2
- 1 shtëpi gabariti 12.8 m x 19.5 m =249.6 m^2
- 1 shtëpi gabariti 14.4 m x 10.8 m =155.52 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 510.6 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 5,429.99 m^2

❖ I – 4 / ZB, Ndërtim të tipit B+S+P+M+1

- 7 shtëpi gabariti 7.9 m x 11.6 m = 91.64 m^2
- Hapësira gjelbruese S = 629 m^2

❖ I – 5 / ZB, Ndërtim të tipit B+S+P+M+1 dhe B+S+P+1

- 11 shtëpi gabariti 7.9 m x 11.6 m = 91.64 m^2 , tipit B+S+P+M+1
- 8 shtëpi gabariti 10.0 m x 15.0 m = 150.0 m^2 , tip B+S+P+1

❖ I – 6 / ZB, Ndërtim të tipit B+S+P+M+1 dhe B+S+P+1

- 11 shtëpi gabariti 7.9 m x 11.6 m = 91.64 m^2 , tipit B+S+P+M+1
- 8 shtëpi gabariti 10.0 m x 15.0 m = 150.0 m^2 , tip B+S+P+1

❖ I - 7 / ZB

- 3 parcela për shtëpi banimi të pa përcaktuara
- Qendër para shkollorë, (Qerdhe / Kopsht) / ZSH
  ISHPKZH : 30 %,
  tip B+P+1
  S = 3,001 m^2
- Qendër e mjekësis familiar (QMF) / ZSH
  ISHPKZH : 50 %,
  tip B+P+1
  S = 2,502 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 614.8 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 2,588.5 m^2

❖ I - 8 / ZB

- 10 parcela për shtëpi banimi të pa përcaktuara
- Hapësira gjelbëruese S = 2,087.3 m^2

==========

2. Zonë banimi i mesëm

❖ MI – 1 / ZB, Ndërtim të tipit B+S; B+S+P; B+S+P+1; B+S+P+2

- 3 banesa gabariti 19.7 m x 49.0 m = 965.3 m^2
- 1 banesë gabariti 19.7 m x 70.5 m = 1,388.89 m^2
- Qendër para shkollorë, (Qerdhe / Kopsht) / ZSH
  ISHPKZH : 30 %,
  tip B+P+1 me sipërfaqe S = 3,317 m^2

❖ MI – 2 / ZB, Ndërtim të tipit B+S; B+S+P; B+S+P+1; B+S+P+2

- 6 banesa gabariti 19.7 m x 49.0 m = 965.3 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 855.62 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 2,014.83 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 2,715.82 m^2

❖ MI – 3 / ZB, Ndërtim të tipit . B+S+P+2; B+S+P+2+H

- 6 banesa gabariti 18.0 m x 26.0 m = 480 m^2
- 1 banesa gabariti 19.7 m x 44.0 m = 792 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 1,096.92 m^2
- Hapësira gjelbëruese S = 1,370.62 m^2

❖ MI – 4 / ZB, Ndërtim të tipit . B+S+P+2; B+S+P+2+H

- 1 banesa gabariti 18.0 m x 72.0 m =1,296.0m2, ku ;
  A1 = 2,010 m^2
  A2 = 1,638 m^2
  A3 = 1.542 m^2
- 3 banesa gabariti 18.0m x 26 m =468 m^2
  A4 = 1.794 m^2
- 1 banesa gabariti 18.0 m x 60 m = 1.080 m^2
  A5 = 2.067 m^2
  A6 = 1.608 m^2
- 2 banesa gabariti 18.0 m x 60 m 468 m^2
  A7 = 1.560 m2
- 1 banesa gabariti 18.0 m x 44 m = 792 m^2
  AB = 1194 m^2

==========

3. Zonë banimi i mesëm i përzier

MI – 1 / ZSHP, Ndërtim të tipit . B+S+P+5+PH

- 2 banesa C1 dhe C2
- Hapësira gjelbruese S = 3.000.26 m^2

- Instucion I edukimit të lartë / ZSH
  B+P+2
  ISHKPZH : 60 %
  S = 10.614 m^2
- Qendra kulturore polifunksionale
  B+P+3
  S = 5.000 m^2

❖ MI – 2 / ZSHP,

- 1 banesë të tipit B+S+PL; B+S+PL+1; B+S+PL+2; B+S+PL+3; B+S+PL+4; B+S+PL+5 ; B+S+PL+5+PH ; B+PL+5
- Hapësira gjelbruese S = 4,196.54 m^2

❖ MI – 3 / ZSHP,

- 1 banesë të tipit B+S+PL; B+S+PL+5; B+S+PL+5+PH
- Hapësira gjelbruese S = 4,196.54 m^2

❖ MI – 4 / ZSHP,

- 1 banesë të tipit B+S+PL; B+S+PL+1; B+S+PL+2; B+S+PL+3; B+S+PL+4; B+S+PL+5 ; B+S+PL+5+PH
- Hapësira gjelbruese S = 6,073 m^2

❖ MI – 5 / ZSHP,

- Zonë në të cilën nuk ka të projektuar shtëpi banimi
- Sshkolla fillore e ciklit të ultë / ZSH
  ISHPKZH : 40 %,
  tip B+P+2
  S = 10.2009 m^2

❖ MI – 6 / ZSHP,

- Zonë në të cilën nuk ka të projektuar shtëpi banimi

❖ MI – 7 / ZSHP,

- Zonë në të cilën nuk ka të projektuar shtëpi banimi

❖ MI – 8 / ZSHP,

- Zonë në të cilën nuk ka të projektuar shtëpi banimi

==========

- 4 hapësira të banimit të mesëm
- 4 hapësira të banimit të mesëm I përzier
- Qerdhe /kopshte
- Shkolla fillore

- Hapësirë për rekreacion
- Hapesira gjelbruese

Figure 8 Harta e sipërfaqes së planifikuar - modeli dhe gabaritet

6.2.2 Infrastruktura teknike

Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese: Prishtina e Re shtrihet në verilindje të pjesës qendrore të Kosovës. Është në lartësinë mbidetare 650,00 deri 750,00 m.

Kushtet gjeomorfologjike: Lagjia Prishtina e Re është pranë pellgut të liqenit te Badovcit. Rrethina e këtij qyteti ka përbërje gjeologjike - tokë e zezë, e kuqe e përzier me zhavor dhe thëngjill.

Lagjet të cilat e kufizojnë Prishtine e Re janë:

- në Veri-Lindje me lagjen Mat;

- në Jug me z.kadastrale të Hajvalisë dhe z.kadastrale të Çagllavicës;

- në Veri dhe Veri – Përendim lagjen Kalabria;

- ndërsa në Jug dhe Jug - Përëndim kufizohet me lagjen Kalabria dhe z.kadastrale të Çagllavicës".

Kjo lagje ndodhet në lartësin mbi detare rreth 670-740 m.

RRJETI I UJËSJELLËSIT

Koncepti i furnizimit me ujë dhe sasitë e nevojshme

Duke u bazuar në destinimin e sipërfaqeve sipas planit që do të hartohet dhe numrit të banorëve do të llogaritet sasia e nevojshme e ujit për blloqet urbane .
Koncepti i furnizimit me ujë në të ardhmen do të orientohet në sistemin qendror të ujësjellësit d.m.th. nga KUR “Prishtina” përmes fabrikës së re për përpunimin e ujit të pijes që është paraparë të jetë në zk. Shkabaj. Nga kjo fabrikë uji do të transportohet në rezervuarin në kodër në Shkabaj që është me kapacitete V=20.000 m³ e që do të mbulonte pa problem këtë lagje.
Sistemi shpërndarës i rrjetit dhe objektet tjera në sistem
Infrastruktura e gypave është planifikuar të vendoset kryesisht nëpër trotuare ose në rrugë sipas rradhitjes së instalimeve tjera, kryesisht shpërndarja e rrjetit të ujësjellesit është rrjet i degëzuar. Diametrat e gypave janë planifikuar të jenë nga gypat primar me madhësi deri në OD 355 mm dhe OD 250mm, ndërsa rrjeti shpërndarës ose sekondar i blloqeve dhe rrjetit të hidrantëve OD160, OD 110 mm dhe OD 90.Materilai i gypave duhet të jetë HDPE-100.
Furnizimi:Lagjja “Prishtina e Re” mendohet se furinizimin me ujë të pijes do ta ketë nga rezervari në fshatin Shkabaj.

Normat e harxhimit të ujit

Nga destinimi i sipërfaqeve të propozuara nëpër blloqe shihet se ekzistojnë disa lloje të shfrytëzuesve dhe rrjedhimisht edhe norma të ndryshme të harxhimit ditor.Norma e harxhimit të ujit për një banor është 150-200 l/b/ditë, për këtë rast është përvetësuar:N=180l/b/ditë.

Koeficienti i jonjëtrajshmërisë:

K=1.5

Qmax=93.75(l/s)

Humbjet në rrjetë merren gjithsej 20% të prurjeve te përgjithshme:

H=18.75 (l/s)



Figure 9 Harta e qasjes në rrjetin e kanalizimit

RRJETI I KANALIZIMIT FEKAL

Norma e harxhimit të ujit

Bazë për llogaritjen e sasisë meritore të ujërave për largim ka qenë norma e harxhimit të ujit për njësi të shfrytëzuesit. Këtu janë shfrytëzuar normat e lejuara sipas DIN-it, EC dhe dispozitave ligjore në fuqi. Varësisht nga harxhuesi, janë përvetësuar edhe normat përkatëse. Norma e harxhimit për banor është qn=180l/d, koeficienti i jonjëtrajtshmerisë ditore është kd=2.0 ndërsa ai i jonjëtrajtshmerisë së orës kh=1,5. Në sasinë meritore për dimensionim kanë pasur ndikim edhe sasitë e ujërave të pashfrytëzuara, siç janë infiltrimi i ujit në kanal, si dhe pastrimi i gypsjellësit. Shuma e të gjitha këtyre ka qenë meritore për dimensionimin optimal të gypave.

Harxhimi i ujit:

Banorët 180 l/d

Afarizmi 5,0 l/m²/d

Çerdhet- Kopshtet dhe

Shkollat 8-10 l/nx./

Zgjedhja inxhinierike - Topografia ka kushtëzuar që drejtimi i shkarkimit të ujërave të zeza të jetë kolektori kryesor prej PESN 4 – Φ 800 mm. Bartja në lumë do të bëhet me gravitacion, mirëpo para se ujërat fekale të derdhen në lumë ato duhet të trajtohen në impiant pastrimi.

Topografia e terenit - Tereni nuk është shumë i përshtatshëm për ndërtimin e kanalizimit fekal, për shkak të disniveleve të shumta. Para ndërtimit të kanalizimit fekal, tereni duhet të studiohet dhe të përcaktohen kuotat e sakta të terenit, pastaj të analizohet se a është e nevojshme përdorimi i pompave për ngritjen e ujit në lartësi, në ndonjë pikë.

Traseja e rrjetit të kanalizimit fekal - Rrjeti i propozuar rrugor i zonës së studiuar është shfrytëzuar për trasimin e rrjetit në fjalë. Kanali do të kalojë kryesisht në trotuare të rrugës, në vendet ku është banim i dendur në të dy anët e saj. Si variante

optimale, në vendet ku banimi është i dendur në njërën anë ndërsa në anën tjetër kemi shfrytëzues të rrallë, duhet të shfrytëzohet ana e rrugës afër banimit.

Materiali që do të përdoret për kanalizimin fekal - Materiali do të jetë gyp i brinjëzuar PE SN4 dhe PE SN8, pasi që ky material në kohët e fundit është duke u përdorur shumë dhe ka treguar cilësi të mira. Është i lehtë për vendosje, lehtë mirëmbahet dhe ka cilësi të mira të qëndrueshmërisë. Thellësia e vendosjes së gypave do te jetë në bazë të rënies së terenit. Ato do të vendosen dhe do të mbulohen me shtresë rëre. Në distanca të caktuara do të vendosen pesetat. Pesetat do të vendosen edhe në çdo kryqëzim dhe në vendet e nevojshme ku bëhet shkarkimi i ujërave. Pusetat duhet të jenë të tipit standard nga rrathët e betonit, monolite ose nga plastika.

Rrjeti përbëhet prej gypave me këta diametra:

- PESN Ø100mm
- PESN Ø400mm
- PESN Ø500mm
- PESN Ø630mm
- PESN Ø800mm
- PESN Ø1000mm



Figure 10 Harta e qasjes në rrjetin e ujërave të zeza

RRJETI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Parashihet sistem i ndarë i kanalizimit, që do të thotë që ujërat e zeza dhe ujërat atmosferike do të kenë rrjete të posaçme të sistemit. Kjo zgjidhje është bërë për arsye se në të ardhmen është paraparërë trajtimi i ujërave të zeza në impiant. Me këtë sistem impianti do të jetë më efikas, më i lirë, më i vogël dhe do të ketë mirëmbajtje më të lirë. Me ndërtimin e dy sistemeve të kanalizimit, në fillim do të jetë investimi më i madh, por me kalimin e kohës balansi mes investimit dhe harxhimeve

për mirëmbajtje do të jetë në favor të mirëmbajtjes. Prandaj, është domosdoshmëri që në këtë zonë të ndërtohet sistemi i ndarë i kanalizimit.

Intensiteti i reshjeve

Bazë për llogaritjen e intensitetit të reshjeve janë marrë të dhënat meteorologjike të lumit Sitnica që i takojnë përiudhës 1957 – 1986 (matja e nivelit, rrjedhja). Të dhënat janë për reshjet mesatare mujore. Vargu për llogari është 29 vjeçar që është meritor për përllogaritje. Reshjet mesatare vjetore për këtë varg janë i=588 mm. Për llogaritjen e intensitetit janë marrë reshjet maksimale njëvjeçare me kohëzgjatje t=25 min. Në bazë të këtyre të dhënave është fituar prurje meritore maksimale q=120.00 l/s/ha.

Koeficientet e rrjedhjes Destinimi i ndryshueshëm i sipërfaqeve konsiston me koeficient të ndryshëm të rrjedhjes. Në bazë të normave në fuqi, në tabelën e mëposhtme janë dhënë koeficientet e rrjedhjes për llojet e ndërtimeve.

Lloji i ndërtimit Koeficienti - Kulmi 0,90; Trolli 0,35; Gjelbërimi 0,18; Parku 0,15; Parkingu 0,50; Sipërfaqe e lirë 0,25; Fushë sporti 0,85; Rrugë 0,85.



Figure 11 Rrjeti i kanalizimit atmosferik

Për dimensionet e gypave duhet të bëhet analizë paraprake e datajizuar dhe e studiuar dhe pastaj të konkludohet që gypat e parashikuar duhet apo nuk duhet të zëvendësohen me gypa me dimensione më të mëdha apo më të vogla. Kjo vlen për të tri rrjetet si të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe kanalizimit atmosferik

6.2.3 NGROHJA QENDRORE - RRJETI PRIMAR

PËRSHKRIMI TEKNIK:

TUBACIONET: Dimensionimi i tubacionit të ngrohjes do të bëhet në bazë të sasisë së nevojshme për çdo objekt, me parametra të ujit primar nga Termokosi 130/70 ^{o}C. Kalkulimet e bëra të përafërta për objktet sipas projektit të dhënë janë afërsisht 30 W/m3.

Te vendosja e tubave nën tokë, duhet patur parasysh që ti ikim ujërave nëntokësore, në mënyrë që mos i ngarkojmë punët ndërtimore dhe ngarkesat e furnizimit me ujë të ngrohtë.Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkuma e poliuretanit, e cila është e futur me presion, në mes të tubit të çelikut dhe shtresës mbrojtëse të plastikes në pjesën e jashtme. Këto tubacione duhet të kenë atestet e kualitetit të materialit dhe të jenë standardizuar, pra ti plotësojnë normat dhe standardet e bashkësisë evropiane.

Pozita e tubacioneve është minimum nën koten H = -1.00 m, çka edhe shtrirja nën rrugët nuk paraqitet ndonjë rrezik nga shembja e dheut dhe vibracionet e mundshme nga komunikacioni rrugor, sepse janë marrë parasysh ngarkesat e tokës, dhe tubacioneve përcjellëse përgjatë rrugës.I tërë instalimi duhet të kryhet kryesisht sipas dokumentacionit të projektit detal të punuar, kurse materiali i nevojshëm duhet të jetë i klasit të parë dhe komfort standardeve të BE-s dhe të posedoj certifikatat e kualitetit të materialeve.

Tubacionet qendrore duhet të vendosen në lokalitetet me dendësi më të madhe të ngarkesës termike, në mënyrë që shpenzimet e transportit të nxehtësisë, të jenë sa më të ulëta. Për shkak të vendosjes së tubacioneve në dhe duhet të merret parasysh pozita, niveli dhe kahjet e rrjetit:

- Rrjeti i kanalizimit atmosferik,
- Rrjeti i kanalizimit fekal;
- Rrjeti elektrik
- Rrjeti i ujësjellësit,
- Rrjeti i telefonisë fikse
- Mjetet e mundshme kabllovike etj.

Energjia e nevojshme për ngrohje

Duke pasur parasysh se llogaritja e nevojave për ngrohje qendrore për një kompleks të banesave, për një lagje apo qytet, është një problem mjaft i ndërlikuar, për të cilin duhet të dihen shumë parametra dhe të merren parasysh shumë të dhëna, në vijim do të japim një përshkrim shumë të shkurtër dhe të përafërt për një llogari aq serioze dhe gjithëpërfshirëse. Për caktimin e saktë të shpenzimeve të energjisë për ngrohje, duhet tu referohemi llogarive sipas DIN 4701 / 1E (08.95.),
Udhëzime për llogaritje të nxehtësisë së nevojshme dhe VDI 2067/2 (12.93),

Për përcaktimin e saktë të kapaciteteve për ngrohje dhe të sasisë së energjisë së nevojshme, duhet të trajtohen me saktësi edhe këta faktorë:

- Sipërfaqja e saktë e objekteve ekzistuese,
- Lloji i objekteve ekzistuese,
- Madhësia e objekteve ekzistuese,
- Mundësia e ngrohjes së objekteve ekzistuese,
- Planifikimi i kritereve termike për objektet e reja që duhet ndërtuar dhe,
- Lloji i objekteve të reja të cilat ndërtohen.

Projekti kryesorë i instalimeve të ngrohjes qendrore është punuar në bazë të shënimeve dhe vizatimeve të marra nga arkitektura dhe kërkesave të investitorit.

Kapaciteti i cili është kalkuluar nga llogaritjet, ku është marre 30 W/m³ duke e pas parasysh izolimin e 80% te objekteve dhe 20% te energjisë nga burime alternative, energjinë solare dhe energjinë gjeotermale kemi ardh me një kapacitet prej **Q=98 MW** për hapësirat e banueshme dhe afarizëm.

Tubacioni do të realizohet në atë mënyrë siç është dhënë në përshkrimin teknik dhe në dokumentacionin grafik.

Për punimin e tubacionit përdoren gypat e paraizoluar ISOPLUS apo ndonjë prodhues tjetër.

Vendet e salduara duhet të jenë të punuara mirë me trashësi të mjaftueshme të shtresës së saldimit kështu që diametri i gypit të mos ndërrojë.

6.2.4 RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE RRJETI TELEKOMINIKUES

Rregulloret që u është referuar projekti
Ky projekt ka për qëllim që në bazë te parashikimeve të prezentuara për numrin e banorëve dhe rritjen ekonomike të lagjes të projektoji ndërtimin e rrjetit të ri elektroenergjetik.
Projekti është përpiluar duke ju përmbajtur rekomandimeve të IEC-së për hartimin e planeve të sistemeve elektroenergjetike. Me poshtë janë të rënditura këto rekomandime;
Linjat furnizuese të trafo stacioneve 10/0.4Kv/Kv, janë paraparë të gjitha me kabllo nëntokësore, i gjithë kompleksi planifikohet të furnizohet me energji elektrike nga trafo stacioni PRISHTINA 7 dhe propozohet të realizohet në tri unaza energjitike me kabllo XHP 49A 3x(1x240mm2) të tensionit 20kV.
Në situacion janë dhënë lokacionet e trafo stacioneve 10/04kV të vendosura në trafo blinda apo edhe bodrume të banesave kolektive. Fuqia e tyre është e mjaftushme për furnizimin me energji elektrike planin.

1. Mbledhja e shënimeve për rrjetin ekzistues
2. Analiza e të dhenave të mbledhura

3. Analiza e ngarkesave aktuale dhe atyre të parashikuara
4. Planifikimi i lokacionit të TS-ve 10(20)/0.4kV dhe zonave që mbulojnë ato.

Për planifikim të zgjerimit të mëtutjeshem të SEE apo përmirsim të atij ekzistues janë marrë parasysh dy rekomandimet e mëposhtme:
1) Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemeve shpërndarëse të Kosovës deri në vitin 2015 që obligojnë që:
Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV

Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV në rrjetin distributiv 20kV

Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV Plani rregullues i hollësishëm për tërësinë urbane "B" të Lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025

Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kabllo ajrore apo nëntokësore.
Rekomandimet e IEC-s për projekte të reja në vendet urbane të cilat obligojnë që:

Kabllat për furnizim me energji elektrike dhe kabllat e telekomunikimit duhet të vendosen në të njëjtën trase dhe në të njëjtën kohë.
Sistemet El.En duhet të plotësojnë së paku kushtin "N-1" që do të thotë se duhet të kemi furnizim të rregullt me energji edhe në rast se bjen nga puna një vijë furnizuese.

Përshkrimi i propozimeve të projektit

Synim i këtij plani është furnizimi me energji elektrike i kësaj pjesë. Paraprakisht për këtë furnizim janë nevojitur të dhënat për numër të banorve, të dhënat për destinimin e hapsirave dhe objektet që parashihet të ndërtohen dhe lloin e atyre objekteve. Këto të dhëna janë marrë nga grupi i eksprtëve të planifikimit urban që janë duke kryer këtë plan.
Për llogaritje të energjisë elektrike të nevojshme në amvisni jemi bazuar në numrin e banorve që parashihet të vendoset në këtë pjesë, ndërsa për objektet tjera jobanuese (administratë, shëndetsi, arsim, afarizëm apo industri e lehtë) është marrë një mesatare e shpenzimit të energjisë elektrike në njësi të sipërfaqes së objekteve (w/m²). Më detalisht forma e llogaritjes është dhënë në kapitullin në vazhdim (pika 3) e këtij punimi.
Trasa e kabllave të të gjitha llojeve është vendosur përgjatë rrugëve të planifikuara nga planifikuesit e transportit rrugorë. Pozicioni i saj është dhënë në një vizatim të veqant ku janë dhënë prerjet tërthore të rrugëve. Aty shifet kanali i kabllave me kablla të vendosur në gypa dhe gypa rezervë për instalime të mëvonshme. Në projektet detale që do të punohen veq e veq për zona të caktuara duhet të parashihen edhe pusetat dhe kabllat gjegjëse që duhet të vendosen në kanale. Në këtë hapsirë të gjitha instalimet elektrike duhet të jenë nëntoksore të vendosura nëpër kanale gjegjëse.
Nëpër vizatime dhe në pjesë tjera të këtij plani është cekur se trafot duhet me qenë të parapara për punë edhe në tensionin 10kV edhe në ate 20kV, ndërsa të gjitha

kabllat duhet me qenë të tipit XHE-24kV. Plani rregullues i hollësishëm për tërësinë urbane “B” të Lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025
Janë edhe dy linja 35 kV që kalojnë nëpër hapsirën e projektit tonë. Meqense në të ardhmen këto linja pritet që të eleminohen ose të kalojnë në sistemin 20kV nuk janq marrë në shqyrtim në pjesën e planifikuar. Pra nëse ato nuk eleminohen por shëndrrohen në linja 20kV ato do të futen në sistemin kabllorë nëntoksorë njësoj si linjat 20kv të shpjeguara më lartë.

Janë gjithashtu edhe dy linja 110kV të cilat, mbrenda afatit që përfshinë ky plan, nuk parashihen të vendosen ose të futen në sistem kabllorë nëntoksorë. Për këtë arësye ekipi i planifikuaesve ka parapa një zonë të gjelbër me gjërsi 40m duke pasur aksin e këtyre linjave në qendër të zonës.
Në aspektin planit hapsinorë duhet pasur kujdes që të gjitha trafostacionet është parapa me qenë të ndërtuara në shtëpiza të betonit ose shëpiza të llamarinës. Për këtë arësye në vendet ku është parapa vendosja e tyre duhet të rezervohet një hapsirë minimale prej rreth 45m². Nëse trafostacioni nuk ndodhet në afërsi të rrugës, duhet të sigurohet një rrugë me gjerësi minimale 3.5m nga rruga deri te vendvendosja e TS-ve.
Meqense sipas standardeve të IEC-s sistemet elektroenergjetike së paku duhet ta plotsojnë kushtin ’’N-1’’ me këtë projekt është parapa që të gjitha TS-t të lidhen në disa unaza.
Unaza ka për qellim qe në rastë se bjen nga puna një linjë apo një TS furnizimi i pjesës së rrjetit pas pjesës në defekt të bëhet nga ana tjetër.
Nga aspekti i furnizimit me energji elektrike kjo lagje ndodhet në mes dy trafostacioneve të forta; Prishtinës II dhe Prishtinës 7. Prishtina II ka tre transformatorë 35/10kV me fuqi nga 8MVA seicili dhe Prishtina 7 ka dy transformatorë 110/10(20)kV me nga 63MVA.
Nëpër lagjen që jemi duke e planifikuar kalojnë dy linja 110kV. Në të ardhmen këto dy linja të kalojnë në linja kabllore nëntoksore. Në këtë projekt nuk është parapa trasa e tyre sepse ato nderlidhen edhe me zona tjera të qytetit. Si të tilla janë pjesë e projekteve zhvillimore urbane të Prishtinës. Përkohësisht është parapa një zonë siguruese përgjat aksit të tyre me gjërsi rreth 40m për secilën.
Në bazë të ngarkesës dhe shpërndarjes gjeografike të trafostacioneve janë parapa gjithsejt 6 unaza. Unazat 1 deri në 5 janë të furnizuara nga dy drejtime, pra nga TS PRII-35/10kV dhe nga TS PR7-110/10(20)kV. Unaza 6 për shkak të shtrirjes së saj gjeografike furnizohet me dy kablla XHE vetëm nga TS PRII-35/10kV. Plani rregullues i hollësishëm për tërësinë urbane “B” të Lagjes Prishtina e Re – Zona Lindje në Prishtinë 2017-2025
Për të arritur që furnizimi i tërë unazave të shkoj pa problem edhe gjatë havarive në ndonjërën prej TS-ve ose linjave të gjitha kabllat janë parapa të jenë të tipit XHP-A 1x240mm².

Kjo kabëll në kushte dimrore, kur edhe nevojat për energji elektrike rriten, mund të ngarkohet deri në 360A që në sistemin 20kV është 16 MVA ndërsa në ate 10kV është 8 MVA. Kjo do të thotë se lagja “Prishtina e Re .P Lindore” me këtë kabëll dhe me zgjedhjet e propozuara për TS dhe unazë praktikisht e siguron një furnizim të rregullt me energji elektrike sa i përket sigurisë së rrjetit. Për shkak të ngarkesës së madhe të unazës 3 për këtë qark janë parapa dy kablla paralele të të njëjtit tip.
Më poshtë është dhënë lista e trafostacioneve me të dhënat e nevojshme për fuqi dhe kablla furnizuese të propozuara.

Kerkesat për Energji Elektrike

Meqense në Kosovë për fat të keq nuk ka ndonjë studim zyrtarë të parametrave të shpenzimit të energjisë elektrike (fuqia mesatare e instaluar, fuqia e njëkohshme, shpicet e enregjisë elektrike të familjes mesatare, etj…) për llogaritje të tyre në amvisni në do të nisemi nga një familje mesatare kosovare me 6 antarë të familjes.
Në bazë të shënimeve që unë kam mbrri me i përcjellur, shpenzimet mesatare mujore të familjes 6 antareshe me standard mesatar sillen nga (900 deri 1200)kwh. Këto familje nuk e shfrytzojn energjinë elektrike për nxemje ose për klimë.
Meqense nuk kemi mundur të përcjellim shumë familje të tilla (pra janë rreth 20 familje) dhe me qellim që gabimet të kanë shenjë positive, në për llogaritje do të përvetsojmë vlerat maksimale.
Nga kjo do të nxjerrim shpenzimet mesatare ditore të en. elektrike për familje mesatare 6 antarëshe Kosovare.
Pra : **E**mm=1200kwh …… **E**mm - Energjia mesatare mujore
Emd=Emm/30=1200kwh/30=40kwh/ditë
Emd - Energjia mesatare ditore

Energjia mesatare ditore nuk do të shfrytzohet njëtrajtësisht brenda 24 oreve. Shpenzimet janë të përqendruara nga ora 8 e mengjezit deri në oren 22, pra 14 orë. Megjithatë edhe mbrenda kësaj kohe vlera e shpenzimit ndrron përafersisht në raport 3:1. Për të përafruar llogaritjet tona në do të themi se mbrenda 12 oreve do të kemi shpenzim përafersisht të njëtrajtshëm që do të thotë qe shpenzimi prej 40këh bëhet mbrenda 12 oreve përafersisht barabar në secilen orë.
Nga këto të dhëna shumë të përafruara do të llogarisim fuqinë e njëkohsme për një familje të cilen e kemi marrë si shembull të familjes mesatare
Pnj=Emd30tm=40kwh12h=3.33kW
Pnj - Fuqia e njëkohshme e shpenzuar për një familje 6 antareshe
Meqenëse familja që po e shqyrtojmë i ka 6 banorë, atëhere fuqia e njëkohshme për kokë të banorit është:

Pnj=Enj/n=3.33kW/6=0.56$kW/banor$ë

Pb - Fuqia e njëkohshme e shpenzuar për banorë

Për të përafruar llogaritjet për nevoja për energji elektrike të familjes Kosovare është e nevojshme të dihet koeficienti i njëkohshmerisë së shfrytzimit të paisjeve elektrike.

Ky koeficient në vendet e regjionit sillet nga 0,15 deri në 0,2. Për këtë llogaritje nevoitet lista e paisjeve elektrike me fuqitë përkatëse.

Nr.	Emri i paisjes elektrike	Fuqia e inst. (kë)
1	Shporeti elektrik	7.5
2	Bojleri i banjos	2.0
3	Bojleri i kuzhines	2.0
4	Rrobalarsja	2.5
5	Enalarsja	2.5
6	Hekuri për hekurosje	1.0
7	Fshisa	0.8
8	Frigoriferi	0.5
9	Frizi	0.3
10	Paisjet elektronike (TV, PC, Radio etj…)	0.5
11	Ndriqimi	0.6
Gjithsejt	20 k	

Pra fuqia e instaluar e paisjeve elektrike të një familje mesatare është Pins = 20kw
Nga kjo del se koeficienti i njëkohshmerisë është:

μ=Pnj/Pinst=3.33kë/20kë=0.1665

Duke u bazuar në këtë koeficient shofim se përkunder numrit të vogel të familjeve tek të cilat janë përcjellur shpenzimet e enrgjisë elektrike rrezultatet janë brenda kufijve ku sillet edhe regjioni andaj edhe mund ti shfrytzojmë si përafërsisht të sakta për llogaritjet e ardhshme.
Plani rregullativ i lagjes përpos objekteve të banimit ka edhe objekte tjera: Arsimore, tregtare, administrative, etj...,. Për llogaritje të nevojave për energji elektrike të këtyre objekteve do të shfrytzojmë tabela të gatshme më të dhëna të rekomanduara nga studime që bazohen në sipërfaqet e shfrytzueshme të këtyre objekteve.
Më poshtë po dhëmë tabelën e lartë përmendur e cila do të na nevoitet për llogaritje të energjisë elektrike në të gjitha objektet që nuk janë të dedikuara për banim.

Nr	Lloji i objektit	Fuqia njësi e rekomanduar ë/m²	Fuqia njësi e përvetsuar ë/m²
1	Objektet arsimore	10 – 25	20
2	Objektet shendetsore me nxemje	40 – 60	60
3	Qendrat sportive	10 – 50	30
4	Hotelet pa klimë	20 – 30	30
5	Hotelet me klimë	30 – 70	50
6	Objektet tregtare	25 – 60	25
7	Administrata	15 – 30	30
8	Prodhim (zeje, puntori)	50-100	

Meqense nga ekspertët e urbanistikës nuk është caktuar lloji i objekteve për këtë planë është përvetsuar koeficienti mesatar për të gjitha llojet e objekteve k=35ë/m² që është i përafërte, por i mjaftueshëm për planifikim.

Llogaritjet për nevoja të energjisë elektrike Bazë për llogaritje është marrë ndarja në destinime të ndryshme.

Përshkrimi i siperfaqeve dhe nr.banoreve në objekte banimi	Siperfaqet dhe nr i banorëve	Nr i kw per koke banori,dhe siperfaqe	Fuqia e nevojshme me banore	NR i Trafostacioneve
Nr i banoreve në objektet e banimit	31,000	0.56000	17360	20x1000KVA
Totali i hapsirave komunale m2	517,368	0.0350	18107.88	20x1000KVA
Banim i përzier me afarizëm m2	78,063	0.0350	2732.202291	3x1000KVA

PLANIFIKIMI I NDRIÇIMIT TË RRUGËVE

Në projektet e rrugëve duhet të projektohet edhe ndriçimi i rrugëve. Në këtë planë janë dhënë vetëm përcaktimet parimore në bazë të të cilave duhet të punohet projekti i ndriqimit të secilës rrugëve. Në një vizatim të veqant janë dhënë prerjet e secilit lloj të rrugës. Në atë prerje janë dhënë pozita e llampës ndaj rrugës, lloji i llampës, numri i llampave në një shtyllë, lartësia e llampës, forma e vendosjes së llampave dhe distance ndërmjet dy llampave të një krahu. Të gjithë këta parametra janë të përafërt. Vetëm pas llogaritjeve të sakta në projekte detale do të dihen saktësisht këta parametra.
Llogaritjet e këtyre parametrave duhet të bazohen në varshmëri nga lloi i rrugëve, numri i shiritave të rrugës, lloji i shiritave (për automjete, për këmbësorë, për biciklist, shiritat gjelbrues,..), nga dendësia e trafikut, etj… Ajo qka duhet respektuar është intenziteti i ndriqimit që duhet të sillet nga (20-30)lx dhe njëtrashmëria e ndriqimit që nuk mund të kaloj kufirin 1:3. Trupat ndriçues që të gjith duhet të jenë LED.
Kabllat e ndriçimit do të kalojnë nëpër të njëjtin kanal me kablla energjetike të rrjetit 0.4kv. Furnizimi për ndriqim të rrugëve do të mirret nëpër TS-t e parapara për furnizim të objekteve. Këto trafostacione duhet të kenë një kthinë të veqant për vendosjen e paisjeve për matje të energjisë dhe paisjeve për komandim të ndriqimit.

Planifikimi i sistemit të Telekomunikimit

Sot dhe për të ardhmen ashtu siq është kërkuar me rekomandimet e IEC-s sistemi i telekomunikimit për medium transmetimi duhet ti ketë fijet optike të cilat e kanë mundësinë e transmetimit të sinjalit shumfish më të madhe madje të pakrahasueshme me fijet e bakrit.
Për bartje të linjalit telekomunikues dhe shpërndarje të tij deri te banorët janë paraparë dy centrale telefonike periferike CP1 dhe CP2. Këto centrale do të lidhen me qendren postare të qytetit përmes kabllit optik 24 fijorë të tipit ‘Singel Mode’, pra secili central me nga një kabëll. Shpërndarja e mëtutjeshme bëhet me kabëll të njëjt por me 12 fije deri te kutitë fundore të kabllit optik.

Shpërndarja nga centralet periferike deri te kutitë fundore do të jetë yllore-serike. Kjo do të thotë se do të kemi disa dalje nga centrali dhe në secilën dalje nga disa kuti të

lidhura në seri njëra pas tjetres. Centrali CP1 do të ketë tri dalje ndërsa CP2 vetëm një dalje për këtë projekt, por mund të përdoren dalje tjera për pjesë tjera të asaj zonë. Një central periferik ekziston edhe në qendren spitalore dhe nga ai daljet vazhdojn drejt e nëpër spitale. Pra nuk është parapa ndryshim i gjendjes ekzistuese. Në rast ndërtimeve të reja centrali ka kapacitete të mjaftueshme për zgjerim.
Kutitë fundore që janë të vendosura nëpër lagje kanë mbrojtje mekanike IP65 dhe vendosen në bazamente betoni. Në këto tabela do të vendosen paisjet për shëndrrim të sinjalit nga ai optik në sinjal elektrik apo nga optik në optik gjegjesisht nga sinjali optik në single mode në ate multi mode.
Nga këto kuti deri te objektet gjegjëse sinjali vazhdon nëpër kablla optike multi ose kablla të NET-it varsisht nga nevoja dhe madhësia e objektit. Të gjitha këto pastaj do të jenë pjesë e projekteve të veqanta për raste veq e veq.
Këto kablla do të shkojnë nëpër të njëjten trasë me kabllat energjetike, por duhet të vendosen në gypa të ndryshëm, pra jo në të njëjtin gyp me kablla energjetike.
Pjesë e këtij plani është edhe një hartë në të cilën është dhënë trasa e kabllës optike dhe vendet e centraleve e të tabelave shpërndarëse të sinjalit telekomunikues në distance të njëjt ndaj saj dhe gjatë tërë gjatësisë së saj.
fig.1 Pamja e kanalit kabllovik Shirit i zinkuar Fe/Zn 25/4mm² Rëra Gyp i brinjezuar F125 Mbrojtje e plastikes Shiriti i verejtjeve Dhe i ngjeshur 1. Kabëll energjetike 0.4kV 2. Kabëll energjetike XHP 20kV 3. Kabëll STP cat6 4. Kabëll optik
Udhëzime teknike për projektuesit dhe kryesit e punve

Meqenëse ky projekt nuk është projekt zbatues por do të jetë projekt udherrefyes për projektet zbatuese e shoh të arsyeshme qe ti theksoj disa nga rregullat teknike dhe disa nga kerkesat e ketij projekti për projekte zbatuese.
Të gjitha trafostacionet e reja janë parapa të vendosen në shtëpiza betony ose të tipit blindë të cilat në brëndësi duhet të kenë hapsirë për vendosje nga 400kVA deri në 1250kVA.
Vendi ku do të vendosen TS-t duhet të ketë hapsirë të nevojshme për qasjen e makinerisë për ngarkim-shkarkim dhe vendosje të trafostacioneve
Hapsira ku do të vendoset Trafostacioni duhet të jetë gjithashtu e mjaftueshme për të realizuar ndërtimin e përtokzimit mbrojtës dhe të punës së trafostacionit.
Ndërtimi i trasave të reja kabllore duhet bërë kryesisht përgjat rrugëve në kanalin e ndërtuar.

Gjatë 10 viteve të ardhshme sa zgjatë ky plan trasat e kabllave duhet të ndërtohen parallel me ndërtimin e rrugëve i cili është parapa në këtë plan. Ky ndërtim i trasave duhet të bëhet pavarsisht se a kërkohet në at moment edhe vendosja e kabllave. Në këto raste vendosen vetëm gypat e brinjëzuar, ndrëtohen pusetat ndërsa kabllat vendosen atëhere kur paraqitet nevoja.

Gjatë vendosjes së kabllave në gypa, kabllat 10(20)kV, ato 0.4kV, kabllat e tensionit të ulët dhe kabllat optike vendosen në gypa të ndryshem e kursesi në të njëjtin gyp.

Nuk lejohet vendosja paralele në të njëjtin kanal, nën kanal ose mbi kanal, të kanaleve të instalimeve të ujit, nxemjes, kanalizimit fekal, gazit etj…

Vendosja paralele e trasave të kabllave dhe trasave të instalimeve tjera duhet t'i rrespsktoj distancat teknike.

Lejohet kryqzimi i trasave të kabllave dhe instalimeve tjera por distance minimale e tyre duhet të jetë më e madhe se 0.3m dhe kendi i kryqezimit 90°.

Me këtë plan është parapa që ndriqimi i rrugëve dhe shesheve të jetë i vendosur në shtylla metalike me bazamente të betonit.

Lartësia e shtyllave dhe distance në mes tyre duhet të llogaritet në bazë të sasisë se ndriqimit që synohet të ketë në vendet gjegjese.

Te rrugët të cilat në mes kanë shirit të gjelbër, llampat duhet të vendosen në hapsirën e gjelbër dhe do të jenë dykrahëshe ndërsa në rrugët tjera vendosen në pjesët ansore.

Në rrugët ku ndiçimi do të bëhet nga pjesët anësore trasa e kabllave të ndriçimit duhet të jetë në të njëjten trasë me kabllat tjera.

Shiriti përtokzues i trases së kabllave duhet të sherbej edhe për përtokzimin e shtyllave tëndriçimit.

6.2.5 INSTALIMET MAKINERIKE

SISTEMI I RRJETIT PËR FURNIZIM ME ENERGJI TERMIKE NË LARGËSI TË NGROHJES QËNDRORE PËR PLANIN

Projekti kryesorë i instalimit të rrjetit për furnizim me energji termike në largësi,të ngrohjes, për planin, rrjeti i furnizimit me energji termike në largësi është punuar, në bazë të shënimeve dhe planeve si dhe në bazë të kërkesave specifike për ndërtesat në veqanti.

Sistemi i ngrohjes është paraparë me ujë të tejnxehur me nënstacione termike me kapacitete adekuate të kalkuluar për ndërtesat afariste banesore ndërtesat shkollore si dhe shtepitë e banimit.

Rrjeti për furnizim me energji termike është paraparë të ndërtohet me tuba të paraizoluar termikisht dhe hidralikisht.

Në vendet e kyqjes, degëzimeve të sistemit të rrjetit gypor për shpërndarje të veqanta të parashihen pusetat e betonit me dimensione adekuate.

Në fillim të çdo kyqje në rrjetin shpërndarës të vendosen valvulet dalëse dhe kthyese të ujit të tejnxehur në sistemin shpërndarës për vazhdimin e sistemit të rrjetit, të parashihen gypat e paraizoluar me dimensione adekuate.

Në puseta parashihen edhe valvola automatike për largimin e ajrit nga sistemi i rrjetit gyporë dhe mbushje zbrazjes të sistemit.

Projekti është përpiluar në tërësi në harmonin me normat dhe standardet në fuqi të Rrepublikës të Kosoveës dhe normave Evropiane, për sistem të instalimeve të energjisë termike në largësi.

TUBACIONET

Dimensionimi i tubacioneve të furnizimit me energji termike në largësi për ndërtesat e banimit dhe afariste, me parametra të ujit të tejnxehurë të marura nga "Termokosi"130/700C. Kalkulimet e bëra të përafërta me ndërtesat sipas projektit të dhënë afërsisht 30W/m3. Gjatë instalimeve të tubave në tokë duhet pasur kujdes nga ujrat nëntoksor. Tubacionet e paraizoluara duhet të jenë të punuara nga shkuma e poliuretanit. Këto tubacione duhet të kenë atestet dhe çertifikatat e kualitetit të materialit.

Shtrirja e tubacioneve të jetë minimum nën shtresën e tokes h=1.5m.

I tërë sistemi i instalimit të rrjetit duhet të punohet sipas dokumentacionit të projektit detal, ndërsa materialet të jenë të klasës së parë dhe komfort standardeve të BE-së dhe Kosovës të pajisura me çertifikata dhe ateste të kualitetit të materialeve.

Tubacionet qendrore të vendosen në lokalitetet me dëndesi më të madhe të ngarkesës termike, në mënyre që shpenzimet e transportit të nxehtësisë të jenë sa më të ulëta. I kemi marë parasysh pozitat, nivelet dhe pjerrtësitë e terenit. Si dhe në projekt shihet se dimenzionimi i gypave rajonal për ketë zone dhe për shkak të pjerrtësisë së Regjionit te ketij vendbanimi ne gjatë projektimit na u është kërkuar që rrjeti i tubacioneve të ndahet në tre degë kryesore të furnizimit, në ketë vendbanim degët kryesore do të kenë tubacione me diamter nominal nga DN100 deri tek DN250 që duhet furnizuar vendbanimi po ashtu dy degët tjera të vendbanimit parashihen të furnizohet me DN100 deri tek DN300. Furnizimi i të gjithë objekteve mbulohët me këta tuba të ngorhjes që vie nga termokosi deri tek nënsatcionet termike që me pas nga nënstacionet termike çdo ndertesë object shkollor apo edhe shtëpi banimi do të kyqen me rrjet lokol të dimenzionuar me diametër minimal nga DN65 e deri tek DN100 ku këta tuba janë të paraizoluar dhe të kenë të kryer A-testin që ju kerkohet sipas standardeve dhe të jetë e pranueshme për projektin në fjalë

6.2.6 ENERGJIA E NEVOJSHME PËR NGROHJE

Duke pasur parasysh se llogaritja e nevojave për furnizim me energji termike në largësi për një kompleks të banesave ose ndërtesë afariste, për një lagje apo qytet, është një llogaritje mjaft e ndërlikuar, për të cilen duhet të dihen shumë parametra dhe të merren parasysh shumë të dhëna, në vijim do të japim një përshkrim shumë të shkurtër dhe të përafërt për metodën e kalkulimit.

Për caktimin e saktë të shpenzimeve të energjisë për ngrohje në ndërtesë afariste dhe ndërtesat e banimit kemi përdorur standardin Evropiane EN 12831, për sistemin e furnizimit me energji termike në largësi kemi përdorur llogari sipas DIN.

- Per ndërtesat e banimit, me etazhitet deri në 7 kate, është 120W/m2

7.0 Ndërmarrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në mjedis dhe atë në ajër, tokë, ujë, në ruajtjen e peizazhit, si dhe në ruajtjen e shëndetit të njeriut, gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" dhe gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve banuese duhet të merren masat që do të përshkruhen në vijim:

Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" duhet të merren këto masa:

- Gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet manipuluese të spërkaten me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazërave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i aromës së keqe që lirohet nga hapësirat e kuzhinave duhet të bëhet ventilimi i hapësirave të kuzhinave për pastrimin e ajrit, gjithashtu aroma e pakëndshme do të zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të vendosura në objekt.
- Për të siguruar ndotje minimale të lagjes me CO2 dhe zvogëlimin e zhurmës nga automjetet brenda saj, është planifikuar qasja e kontrolluar e komunikacionit si dhe planifikimi i rrugëve qorre (të cilat kryesisht shfrytëzohen vetëm nga banorët e asaj rruge jo edhe nga banorët e gjithë lagjes).
- Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
- Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive banuese;
- Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;

- Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim dhe drunj të lartë dekorativ si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" duhet të merren këto masa:

- Dheu i deponuar duhet të shfrytëzohet për rrafshimin, planifikimin e terrenit të degraduar i cili duhet të mbillet me barë dhe drunj, pjesa tjetër e dheut duhet të përdoret për mbushjen e terrenit për rregullimin e rrugës dhe parkingut të automjeteve, pjesa tjetër e dheut nëse mbetet pa u shfrytëzuar duhet të dërgohet ne deponinë regjionale
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen në deponinë regjionale.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave ngarkuese dhe transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që mos të ketë derdhje eventuale të derivateve dhe vajrave gjatë punës së tyre.
- Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë,
- Në lokacionin ku do të ndërtohet kompleksi i objekteve banesore me infrastrukturën përcjellëse nuk do të bëhet furnizimi me derivate dhe ndërrimi i vajrave të makinave ngarkuese dhe transportuese .
- Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit gjatë ndërtimit të kompleksit te objekteve banesore për shkak te avarive në makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet,
- Vajrat duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj t`u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim,
- Kontejnerët duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave Nr. 04/L-060,
- Pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponinë regjionale.
- Duhet të bëhet betonimi/asfaltimi dhe izolimi i sipërfaqeve të parkingut të automjeteve si dhe hapësirave punuese në të cilat bëhet manipulimi me lëndë djegëse (derivate te naftës), hapësirave ku vendoset gjeneratori i rrymës, me qëllim që të pengohet ndotja e tokës nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet e parkuara në parkingun e këtij kompleksi.
- Nga hapësirat në të cilat krijohen mbeturinat e ndryshme mbledhja e tyre duhet të bëhet çdo ditë.

Masat për mbrojtjen e ujit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” duhet të merren këto masa:

- Duhet të bëhet pengimi i mundësisë për derdhjen e derivateve dhe vajrave nga makinat ngarkuese dhe transportuese,
- Duhet të pengohet larja e pajimeve të punës në afërsi të ujërrjedhave dhe në to.
- Duhet të bëhet rregullimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të ndotur gjatë larjes së parkingut të automjeteve, rrugës së asfaltuar përreth objekteve banesore, hapësirës së gjeneratorit të rrymës dhe përmes sistemit gypor të ndërtuar të dërgohen për trajtim në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur me derivate dhe vajra të cilat kanë rrjedhë nga automjetet të parkuara në parkingun e objekteve banesore
- Ujërat pas trajtimit në seperatorin e vajrave duhet të derdhën në gropën septike.
- Seperatori duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe marrjen e mostrave të ujërave të trajtuara .

- Ujërat të përdorura në kuzhinë dhe lavatriqet për larjen e mbulesave, rrobeve të ndryshme, duhet të derdhen në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotura me yndyra dhe vajra e detergjente të ndryshme, ujërat pas trajtimit në seperator të derdhën ne gropën septike.
- Ujërat e zeza (fekale) duhet të derdhën për trajtim në gropën septike e pastaj pas trajtimit të derdhën ne pusin filtrues.
- Gropat septike duhet të ndërtohen nga beton armeja me tre bazena kalues të mbushur me gurë të thyer dhe zhavor, si filtra natyror – biologjik.
- Puseta trajtuese e ujërave të ndotur duhet të ndërtohet në atë mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe marrjen e mostrave të ujërave të trajtuara .
- Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet e kulmeve dhe sipërfaqet tjera të grumbullohen dhe të përdoren për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbruara.

Në skemën në vijim është paraqitur një model i ndërtimit të gropës septike me puesetat kontrolluese dhe pusin filtrues.



Masat për mbrojtjen e botës bimore

Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në boten bimore që kanë qenë evidente gjatë fazës së zhvillimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” dhe që

mund të jenë evidente gjatë zhvillimit të aktiviteteve banuese në kompleksin e objekteve banesore duhet ndërmarrë këto masa:

- Gjatë ndërtimit të kompleksit të objekteve banesore me infrastrukturë përcjellëse, sipërfaqet e lira dhe të gjitha hapësirat përreth të cilat do të degradohen gjatë fazës së ndërtimit duhet të mbjellën me barë, lule të ndryshme aromatike dhe drunj të ndryshëm dekorativ, duke ju përshtatur ambientit rrethues.
- Për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara duhet inkuadruar punëtorë të rregullt profesional për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të lira dhe të gjitha hapësirave përreth objekteve banesore.

Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet e mundshme duhet ndërmarr këto masa;

- Evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera.
- Siguria konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe mjedisit të punës.
- Instalimet elektrike dhe stabilimentet elektrike duhet të montohen dhe vendosën sipas udhëzimeve teknike.
- Në disa vende posaçërisht në koridoret e objekteve duhet të instalohen eurohidrantet me pajimet përcjellëse dhe S aparatet plotësuese.
- Duhet rregullisht të bëhet kontrollimi i seperatorit të vajit, pas mbushjes duhet berë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit të mbeturinave për trajtimin e materieve të rrezikshme.
- Të hartohet rregullorja ku do të definohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.

Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zjarri

Për hir të mbrojtjes nga zjarri objektet duhet të realizohen sipas rregullave, normativave dhe standardeve përkatëse:

- Objektet duhet të realizohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga zjarri (Fleta zyrtare Ligji nr. 02/L-41)

- Objektet duhet të kenë rrjetin e hidrantëve përkatës e cila sipas rrjedhjes dhe shtypjes së ujit në rrjet, duhet të planifikohet dhe të projektohet sipas rregullores për normat teknike për rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm të hidrantëve për shuarjen e zjarrit (Ligji nr. 02/L-41)
- Objekteve duhet t'iu sigurohet qasje e përshtatshme për automjetet e zjarrfikësve, duke iu përshtatur rregullores për normat teknike për rrugët furnizuese. (Ligji nr. 02/L-41)
- Objektet duhet të realizohen në përputhshmëri me vendimet për normativat teknike për projektimin e objekteve banesore dhe të apartamenteve (Ligji nr. 02/L-41), Rregulloren për normativat teknike për instalime elektrike të tensionit të ulët (Ligji nr. 02/L-41), Rregulloren për normativat teknike për mbrojtjen e objekteve nga të reshurat atmosferike (Ligji nr. 02/L-41).

Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore

Për mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare tërmetet, objektet duhet të realizohen dhe të kategorizohen sipas rregullores për normat teknike për ndërtimin e objekteve në zonat sizmike (Ligji Nr,02/L-68).

Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ndërmerren gjatë planifikimit dhe rregullimit të hapësirës dhe vendbanimeve, gjatë ndërtimit të objekteve me qëllim që të pengohet, respektivisht të zvogëlohet ndikimi negativ i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si dhe të mundësohen mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma.

Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim të banimit të lartë, furnizimin e qytetarëve, të transportit publik, si dhe deponimin, prodhimin, përdorimin e materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate të sigurimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Ndërmarrja e masave për mbrojtje civile të njerëzve dhe të pasurisë

Në lidhje me mbrojtjen civile, duhet të punohet elaborat i veçantë, shtesë për masat mbrojtëse nga fatkeqësitë natyrore dhe kushtet për planet hapësinore me interes të mbrojtjes, e cila është pjesë përbërëse e planit.

Masat mbrojtëse janë:

a) masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike,
b) evakuimi,
c) pranimi dhe furnizimi i qytetarëve të rrezikuar,

d) mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike,
e) strehimi,
f) mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës

Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zhurma

Masat e planifikuara që duhet të ndërmerren për mbrojtjen nga zhurma duhet të bazohen në standarde të zhvilluara në vend dhe standarde të ngjashme në bashkësinë evropiane (*Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council*, etj.) duke ndërmarrë masa primare (duke reduktuar zhurmën në burimin e saj) dhe masa sekondare (duke i mbrojtur hapësirat me masa zë izoluese). Këto masa konsistojnë në:

- reduktimin maksimal të komunikacionit të panevojshëm në lagje (është planifikuar terminali i cili do të reduktojë hyrjen e një numri të konsiderueshëm të automjeteve);
- planifikimin e regjimit të serviseve për mirëmbajtje (largimi i mbeturinave, pastrimi i rrugëve, mirëmbajtja;
- aplikimin e standardeve të fizikës ndërtimore të zhvilluara në vend dhe në BE (izolimet akustike të mureve, dyerve dhe dritareve, etj.);
- masat preventive (parandaluese) për zhvillimin e veprimtarive të zhurmshme (vendosja e veprimtarive të frekuentueshme dhe të zhurmshme në përiferi të lagjes).

Duke iu referuar ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr.02/-102, investitori ka për të marrë të gjitha masat që zhurmat të jenë sa më të vogla *gjatë kryerjes së* aktiviteteve që kërkon të zhvillojë përmes :

- përzgjedhjes dhe përdorimit të pajisjeve që lëshojnë zhurmë të niveleve të ulëta,
- përzgjedhjen e vendit, që instalimi dhe funksionimi i mjeteve e pajisjeve që lëshojnë zhurmë, të garantojnë nivelin kufi në të gjitha mjediset, të cilat ndikohen prej saj *,*
- masat parandaluese e zbutëse të zhurmës në pikën e lëshimit, përgjatë rrugëve të përhapjes dhe në mjediset që ndikohen prej saj.

Pajisjet që do punojnë të cekura më siper duhet të jenë në gjendje teknike të mirë , të mos perdoren në oraret e levizjeve pik, të jenë shumë larg zones së banuar dhe ndikimi në mjedis është i ulët.

Table 2 Kujitë e lejuar të zhurmave gjatë ndërtimit

Kategoria e vlerësimit dhe periudha e referuar	Kategoria A vlera e lejuar	Kategoria B vlera e lejuar	Kategoria C, vlera e lejuar
(LAeq)	dB(A)	dB(A)	dB(A)
Gjate natës ora 23:00-07:00	45	50	55
Mbrëmje dhe fundjavë	55	60	65
19:00-23:00 ditë jave			
13:00-23:00 Shtunë			
07:00-23:00 Diel			
Gjatë ditës	65	70	75
07:00-19:00 ditë të javës			
07:00-13:00 Shtunë			

Në Kodin Europian thuhet se vlerat e kategorisë A do të përdoren kur nivelet e zhurmave të mjedisit (rrumbullakosur në më të afërt 5 dB) janë më pak se këto vlera.

Vlerat e kategorisë B do të përdoren kur nivelet e zhurmës në mjedis (me një tolerancë 5 dB) janë të njëjta me vlerat e kategorisë A.

Kategoria vlerat e pragut C do të përdoren kur nivelet e zhurmës në mjedis (me një tolerancë 5 dB) janë më të larta sesa vlerat e kategorisë A.

Ku nivelet e zhurmës në mjedis tejkalonjnë vlerat e pragut të listuara në tabelën e mësipërme atëherë mund të themi që kemi nje ndikim të zhurmës nëse niveli total i zhurmës LAeq rritet më shume se 3 dB për shkak të aktivitetit të ndërtimit.

Lloji objektit	Ditën dB LAeq (06:00-22:00)	Naten dB LAeq (22:00-06:00)
Spitale, shkolla, manastire	57	47
Zona rezidenciale	59	49
Zonat kryesore, zonat rurale,zonat miks	64	54
Zonat tregtare	69	59

Shkalla e krahasimit të zhurmës aktuale me ate të pritshme gjatë aktiviteteve punuese per ndërtimin e rrugës :

Ndryshimi i nivelit të zhurmës dB(A)	Përgjigja subjektive	Shkalla e ndikimit
0 - 0.9	E papërffillshme	Asnjë ndikim (parëndësishme)
1.0 -2.9	Pak e përfillshme	E lehtë
3.0- 4.9	E dallueshme	E mesme
5.0 - 9.9	Nga dyfishim ose më të lartë	E konsiderueshme
10.0 ose me shumë	Me shumë se dyfishim deri në shumë të lartë	Ndikime të ndryshme

Për të kategorizuar nivelet e zhurmës në mjedis këto zhurma duhet të maten në tre pika të ndryshme dhe të dhënat duhet të rrumbullakosen me një vlerë të afërt me 5 dB.

Të dhënat bazë të paraqitura në Tabelat e dhëna janë rrumbullakosur në përpu thje me rrethanat dhe janë paraqitur më poshtë në tabelat perkatëse, së bashku me kategorinë rezultante të vlerësimit të zhurmës të ndërtimit.

Për sa i përket orarit të punës gjatë fazave të ndërtimit është e kuptueshme se ndërhyrjet do të ndodhin zakonisht në orarin 07: 00-18: 00. Në këtë këndvështrim periudha e natës nuk do të merret në konsideratë

Table 3 Nivelet e zhurmës të përafruara pranë qendrave të banimit

Periudha	Niveli i zhurmës në mjedis i rrumbullakosur më 5 dB	Vlerësimi i kategorisë-prag të zhurmës nga ndërtimi
Ditën07:00-19:00)	50 dB(A)	Kategoria A – 65 dB(A) ditën
Mbrëmje 19:00-23:00	50 dB(A)	Kategoria A – 55 dB(A) mbrëmje
Natën (23:00-07:00)	50 dB(A)	Kategoria C – 55 dB(A) natën

Table 4 Nivelet e zhurmës të përafruara larg qendres së banimit

Periudha	Niveli i zhurmës në njedis i rrumbullakosur më 5 dB	Vlerësimi i kategorisë-prag të zhurmës nga ndërtimi
Ditën(07:00-19:00)	55 dB(A)	Kategoria A – 65 dB(A) ditën
Mbrëmje(19:00-23:00)	50 dB(A)	Kategoria A – 55 dB(A) mbrëmje
Natën (23:00-07:00)	45 dB(A)	Kategoria C – 55 dB(A) natën

Ka shumë masa që mund të ndërmerren në zonën e punimeve apo në parkun e automjeteve të cilat mund të minimizojnë zhurmat si:

- ✓ Fikja e mjeteve të panevojshme
- ✓ Duke përdorur izolues prej gome(mund të përdoren dhe goma të përdoruara)
- ✓ Minimizimin e rënieve nga lartësitë të materialeve;
- ✓ Duke i ndezur makinerite graudaulisht (njera pas tjetrës) jo të gjitha njëkohe

- ✓ Mirëmbajtja e pajisjeve. Për shembull, zhurmat mund të reduktohen nga shtrëngimi i pjesëve të lirshme si edhe duke i puthitur ose fiksuar me material elastik (të tilla si gome) midis sipërfaqeve në kontakt.
- ✓ Zhurma nga pajisjet e ndërtimit mund të reduktohen me modifikimin ose me aplikimin e metodave që reduktojnë nivelin e zhurmave.
- ✓ Megjithatë, modifikimet duhet të kryhet në konsultim me prodhuesit e pajisjeve për të siguruar se siguria për këtë modifikim nuk dëmton pajisjen. Masa të tilla përfshijnë:

- Për zhurma të vazhdueshme, të tilla si ajo e shkaktuar nga puna e motorëve me naftë, një zgjidhje për reduktim mund të jetë vendosja e një sistemi silenciator ose duke i përshtatur një mburojë akustike dhe duke e vendosur mbi kapakun e motorrit .
- Zhurma të shkaktuara midis pjesëve të ndëyshme të makinerive të cilat kriojjnë një rezonancë mund të minimizohen duke modeluar fillmisht pajisjen duke i shtuar një shtresë izoluese ose duke ulur efektin nxitues të motorrit.

Në vendet ku nuk është e mundur reduktuktimi i zhurmës mund të merret në konsideratë dhe distanca midis burmit të zhurmës dhe pritësit të saj. Për të patur një ulje maksimale të zhurmës këto faqe mbrojtës duhet të vendosen, sa më afër burimit të jetë e mundur. Psh:

- Grupimi i ndërtësave në kantier dhe atyre ndihmëse mund të jëtë një pengesë e mirë pë zhurmën
- Zonat të cilat janë gërmuar nën nivelin e tokës mund të përdoren për të vendosur pajsije statike si gjeneratorë, kompresorë dhe pompat.
- Vendet e ngritura mbi nivelin e zonës së punimeve të peiazhit apo të ndërtuara mund të shërbejnë për pozicionimin në to të pasjsijeve të zhurmshme .

Për të parandaluar përqendrimin e papranueshëm të substancave të dëmshme në sheshndërtim dhe zonat fqinje, makineritë e ndërtimit nuk duhet të operojnë me kohë të plotë dhe duhet të sigurohet pozicionimi i tyre i sigurt në sheshndërtim.

I gjithë kontingjenti i makinerive duhet të jetë subjekt i inspektimeve të rregullta teknike

Nërmarrja e masat për trajtimin e mbeturinave

Gjate periudhës së ndertimit të këtij Projekti do të ketë dy burime mbeturinash:

- Materiali i gërmuar për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë

- Material i tepërt që do të rezultojë nga punimet e prishjes apo sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonen e shërbimeve dhe pranë trasesë.

Një pjesë e mbeturinave të ngurta të prodhuara gjatë punimeve tokësore mund të vije edhe nga amballazhet e e materialeve të ndryshme të ndertimit (çimento, dru, plastike, kartona, xham, materiale izoluese, etj.). Këto lloj mbeturinash mund të klasifikohen si inerte. Vetëm vajrat e kulluara mund të klasifikohen si të “rrezikshme”. Punëtorëve të ndertimit do t’u kërkohet të mbledhin më vehte llojet e mbeturinave. Të gjitha materialet e larguara nga sheshi i ndërtimit do të menaxhohen sipas ligjit për mbeturina të Kosovës nr.04/L-060 (2012).

Materialet e rrezikshme që do të përdoren detyrimisht gjatë ndertimit, do të ruhen në zonat e parashikuara me fund të dyfishtë. Me këto masa, nuk ka pse të ndodhin ndikime negative të rendesishme gjatë fazes së ndertimit.

Në mënyrë që të parandalohet ndikimi i ndotësave gjatë punimeve të germimit, do të jetë e nevojshme të largohet material i gërmuar që supozohet të dalë nga gërmimet dhe të depozitohet i sigurtë si dhe materiale të tjera që do të rezultojnë gjatë punimeve të ndertimit . Keto materiale hedhurinë do të vendosen në zona të autorizuara nga pushteti vendor. Firma kontraktuese do të konsiderohet pergjegjëse për ndotjen që do të rezultojë në zonat e përmendura.

Zgjedhja e vendit të grumbullimit të mbeturinave i përket jo vetëm firmës projektuese por për këtë duhet diskutuar me firmën sipërmarrese dhe pushtetin vendor.

Vendosja sa me optimale e vendit të depozitimit të mbeturinave, ka për qellim të minimizojë rrezikun e ndotjes se dheut perqark dhe të ujit nëntokesor për shkak të derdhjeve aksidentale të prodhimeve të naftes, dhe duhet të konsiderohet gjithashtu një zgjidhje shumë e mirë për të izoluar dheun e ndotur dhe ujërat nëntokesore nga mjedisi mbi to. Kështu që ndërtimi i këtij kompleksi dhe sistemimi i mjediseve të shërbimit, jo vetëm që nuk do të ndikojë negativisht në procedurat e përdorimit të tokës, por do të ketë ndikim pozitiv për sa i përket zonës së ndotur aktualisht nga

materialet hedhurinë apo në pamje aspask e këndshme në afërsi të qendres së qytetit duke ndikuar për momentin në menyrë aspak të kënaqshme.

Në tabelën në vijim do paraqesim mënyren e menaxhimit të mbeturinave nga personi i licencuar për këtë qëllim.

Table 5 Praktika e menaxhimit të mbetjeve në tërësi

Nr	Lloji i mbetjes	Riciklim/Riperdorim	Djegie	Groposje	Depozitim
1	Mbeturina ndërtimi				
2	Mbetje drusore				
3	Mbetje plastike				
4	Enë boshe				
5	Copa të ngurta betoni				
6	Mbeturina leckash				
7	Mbeturina letre, kartoni				
8	Mbetje tubash plastike				

8.0 PLANI I MENAXHIMIT TE MJEDISIT

Qëllimi i Planit për Menxhimin e Mjedisit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet në rastin tonë të Rivedimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje"

Objektivi i përgjithshëm është që të minimizohet ndikimi i mbetjeve që prodhohen gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetevenëpërmjet masave të mëposhtme:

- të garantohet që të gjitha mbetjet mbahen, etiketohen dhe asgjësohen si duhet, në përputhje me rregulloret në fuqi,
- të minimizohet sasia e mbetjeve që prodhohen
- të rritet në maksimum sasia e mbetjeve që përdoren për riciklim – përfshirë veçimin e mbetjeve të riciklueshme në burim

- ❖ të garantohet që çdo mbetje e rrezikshme (p.sh. vajra të etj) janë magazinuar në mënyrë të sigurtë dhe janë transferuar në ambientet e përshtatshme
- ❖ të shmangen ndikimet e pluhurit nga trajtimi i mbetjeve të renovimit
- ❖ të garantohet që mbetjet asgjësohen në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve

Qëllimi i gjerë i PMM është:

- ➢ Të ofrojë një mekanizëm për të siguruar se masat e propozuara për zbutjen e ndikimeve negative mjedisore janë marrë në konsideratë ose zbatuar
- ➢ Të sigurojë që standardet e praktikave të mira të ndërtimit janë aplikuar
- ➢ Të ofrojë një kornizë për zbutjen e ndikimeve që mund të jenë të paparashikuara ose i paidentifikuar që mund të ndodhin apo rastisin gjatë proçesit të zhvillimit të aktiviteteve.
- ➢ Të ofrojë një kornizë për monitorimin e pajtueshmërisë për të treguar se si performanca mjedisore në këtë projekt është duke u përmbushur.

PMM do të zhvillohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit. Është përgjegjësi e kontraktorit për të siguruar që PMM është zbatuar.

Planet e Menaxhimit mjedisor, identifikojne legjislacionin qe duhet respektuar gjatë zbatimit të projektit, analizojnë karakteristikat mjedisore të zonës, duke përshkruar mjediset sociale dhe ato natyrore.

Kontraktori do të sigurojë, në masën e mundshme, që të gjitha komponentët mjedisore të menaxhohen në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe angazhimet e tjera mjedisore sipas rastit. Kontraktori do të paraqesë në vijim:

- ❖ Menaxhimin e mjedisit, sigurinë në punë dhe shëndetin gjatë kryerjes së operacioneve.
- ❖ Komunikim të hapur dhe bashkëpunim me subjektet e përfshira në punimet e ndërtimit, duke përfshirë punonjësit, grupet e interesit në lidhje me menaxhimin e mjedisit, sigurisë dhe shëndetit
- ❖ Zbatim efektiv të politikave dhe planeve të mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe shëndetit;
- ❖ Rishikim i rregullt i këtyre politikave dhe planeve nëse do të nevojitet
- ❖ Direktiva të qarta për stafin që do të menaxhojë planin e mjedisit, sigurisë dhe shëndetit.
- ❖ Alokimi i burimeve për implementimin dhe mbarëmbajtjen e planit mjedisor, të sigurisë dhe të shëndetit si edhe të aktiviteteve që mund të zhvillohen për këto çështje;
- ❖ Caktimi i përgjegjësisë dhe përgjegjshmëria për zbatimin e planit mjedisor, të sigurisë dhe shëndetsor;
- ❖ Komunikime të vazhdueshme të lidhura më çështjet mjedisore me autoritetin kontraktual
- ❖ Mbështetja dhe pjesëmarrja për të ruajtur një mjedis të sigurt;

Projekti do të përputhet me legjislacionin përkatës udhëzimet dhe miratimet e Qeverisë së Kosovës.

8.1 Vlerësimi i efekteve në mënyrë përmbledhëse

Efekti përfundimtar i një aktiviteti që mund të ndikojë në cilësinë e mjedisit mund të përkufizohet si:

"Ndikimet që rezultojnë nga ndryshimet në rritje të shkaktuara nga e kaluara, veprimet aktuale dhe ato të parashikuara në të ardhmen që do të shoqërojnë një projekt të caktuar"

Matrica përmbledhëse e ndikimeve është një procedurë sistematike që shërben për identifikimin, vlerësimin dhe rëndësinë e efekteve nga ndërhyrjet e parashiku ara. Qëllimi i saj në nivel projekti është marrja në konsideratë e efekteve në rritje të cilat mund ti shkaktojë projekti i cili është fokusi i këtij Raporti Mjedisor së bashku me ndikime nga aktivitete të tjera.

Vlerësimi i efekteve përbledhëse është i nevojshëm në nivel projektesh në VSM-së, që përcaktohet nga Direktiva Evropiane të Komunitetit "vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin" (85/337 / EEC) si amenduar nga Direktiva e Këshillit 97 / 11 / EC.

8.1.1 Metodologjia e vlerësimit

Ka metodologji të shumta për vlerësimin e efekteve përmbledhëse përfshirë aplikimin e modeleve, matricat dhe analiza e pragut. Metodologjia e adoptuar në këtë vlerësim është përqëndruar në identifikimin dhe vlerësimin e receptorëve kyçë të ndjeshëm të identifikuara përmes procesit të VSM -së.

Vlerësimi i efekteve indirekte dhe përmbledhëse duhet të jetë një proces i hapur dhe rezultatet e procesit të vlerësimit duhet të itegrohen në hartimin e projektit dhe aplikimin e masave lehtësuese.

Metodologjia e miratuar përfshin tre faza:

1. Përcaktimi i parametrave të vlerësimit, identifikimin e receptorëve kyçë të ndjeshme dhe përmbledhjen e ndikimeve të mundshme mbi receptorët e ndjeshmërisë
2. Identifikimi i natyrës dhe madhësisë së ndikimit;
3. Rekomandimet për masat zbutëse.

Faza e parë e vlerësimit është identifikimi i parametrave të vlerësimit dhe përcaktimi i të dhënave bazë të mjedisit ku një projekt do të aplikohet.

Të dhënat mjedisore bazë të zonës së studimit sigurojnë kontekstin për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të një projekti. Ky vlerësim ka shfrytëzuar të dhënat bazë të siguruara nga literatura, konsultim me ekspertë të tjerë si dhe humultimi në terren i ndërmarrë gjatë përgatitjes së këtij Raporti.

Fokusi i këtij vlerësimi është identifikimi i receptorëve kyçë të ndjeshëm në kuadër të mjedisit pritës të cilët mund të ndikohen nga projekti. Receptorët janë identifikuar fillimisht nga ekspertët e mjedisit dhe përmes konsultimeve janë përgjedhur receptorët kyç si më poshtë:

- Ndikimi në çështjet social-ekonomike
- Çështjet e peisazhit
- Karakteri lokal i peisazhit
- Habitatet e mbrojtura
- Speciet e mbrojtura
- Kryqëzimet rrugore
- Parashikimi i transportit publik
- Kapaciteti i nevojshëm i rrugës dhe parashikimi
- Rreziku i përmbytjeve
- Cilësia e ujërave sipërfaqësorë të larguar
- Gjendja e ujërave nënokësore dhe rreziku nga ndotja
- Ndikimi i zhurmës
- Trashëgimia kulturore dhe burimet arkeologjike
- Toka dhe agrikultura

Faza e dytë e vlerësimit vlerëson natyrën dhe shkallën e ndikimeve të mundshme të identifikuara në fazën e parë.

Kjo fazë përqendrohet në mënyrë të veçantë në identifikimin e tipit të ndikimit të cilat mund të rrisin rëndësinë e përgjithshme të një ndikimi në një receptor të ndjeshëm kur konsiderohen së bashku.

Masat zbutëse në fazen e tretë të përfshirë në hartimin e projektit tregon se për shumicën e efekteve potencialisht të rëndësishme të parashikuara, efektet e mbetura janë të papërfillshme dhe gjithashtu identifikon efektet e Zhvillimit të Propozuar mbi receptorët e ndjeshëm të përshkruar më lart.

Parimet e minimizimit të mbetjeve

Sistemet e menaxhimit të inventarit do të azhurnohen për të përcaktuar konsumin e produkteve, për të siguruar të dhëna të dokumentuara për çdo fazë të procesit zinxhir të mbetjeve dhe për të identifikuar humbjet e mundshme dhe konsumin e tepërt.

Do të ruhet një inventar për të gjitha mbetjet që janë prodhuar dhe asgjësuar (lloji dhe volumi), në bazë të inventarit të rishikimit periodik.

Ndarja e mbetjeve të ngurta sipas klasifikimit të përcaktuar

Mbetjet që prodhohen gjatë fazës së ndërtimit kanë mundësi që të klasifikohen në katër kategori për tu asgjësuar:

- inerte (dhe, mbetje ndërtimi, materiale ndërtimi të papërdorura, etj.),
- konsumatore,
- me vaj dhe të rrezikshme dhe të lëngshme.
- Konteinerët/koshat metalikë do të kombinohen me llojet e mbetjeve (karton, plastikë, copa metalesh, me vaj, të rrezikshme nëse ka, etj.), me qëllim që të mundësohet ndarja/veçimi.

Mbeturinat do të ndahen nga punonjësit e kampit dhe punonjësit që do të trajtojnë mbetjet do të trajnohen. Nëpërmjet “procedurave” do të instruktohen punonjësit për trajtimin e mbetjeve në sheshin e ndërtimit dhe në kampe. Kompanitë që ofrojnë shërbime do të kalojnë përmes një procesi kualifikimi dhe do të kontrollohen gjatë periudhës që ofrojnë shërbim.

Depot e mbetjeve të ngurta

Në sheshin e renovimit do të krijohet një hapësirë për ruajtjen e mbetjeve ditore, e përbërë nga konteinerë/kosha metalikë. Në fund të ditës së punës mbeturinat në koshat metalikë do të transportohen në zonën e kampit dhe do të futen në depo.

Depoja do të jetë në kamp dhe e mbuluar pjesërisht me çati. Koshat metalikë për mbetjet me vaj ose mbetje të tjera të rrezikshme do të jenë të papërshkueshëm nga uji.

Ripërdorimi i mbetjeve/mundësitë e riciklimit

Mbetjet do të ndahen sipas rregulloreve lokale dhe materialeve ricikluese që përpunohen në Kosovë. Materialet ricikluese do të grumbullohen rregullisht nga kompanitë lokale, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).

Transferimi i mbetjeve

Trasferimi i mbetjeve do të kryhet nga kompani të çertifikuara; automjetet do të kenë të gjitha pajisjet, duke marrë parasysh llojin e mbetjeve që do të transportohen. Nuk është parashikuar eksporti i mbetjeve.

Asgjësimi përfundimtar i mbetjeve

Vetëm kompanitë e çertifikuara nga autoritetet përkatëse (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) do të përdoren për asgjësimin e mbetjeve; është siguruar një listë e kompanive të çertifikuara për menaxhimin e mbetjeve nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e cila konfirmon se do të jetë e mundur që të menaxhohen dhe asgjësohen të gjitha mbetjet e mundshme të ndërtimit dhe funksionimit në ambientet brenda Kosovës.

Mbetjet inerte, të cilat nuk paraqesin rrezik për ndotje, do të asgjësohen në një zonë të kontrolluar për asgjësimin.

Mbetjet të tjera do të transportohen në një zonë të caktuar nga Komuna për asgjësimin e mbetjeve.

Mbetjet me vaj dhe ato të rrezikshme do të asgjësohen nga firma kontraktore të specializuara në hapësira që janë pajisur dhe aprovuar për mbetje të tilla.

Mbetjet e lëngshme do të grumbullohen nëpërmjet një sistemi të veçantë.

Specifikat e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme

Me qëllim që të sigurohet mbrojtje për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, grumbullimi, transportimi dhe magazinimi i mbetjeve të rrezikshme do të përfshijë masa për të siguruar të dhëna të dokumentuar për çdo fazë të procesit zinxhir të mbetjeve që nga zona ku prodhohen (kryesisht në sheshin e renovimit) deri në zonën përfundimtare ku do të asgjësohen.

Transporti i mbetjeve të rrezikshme duhet të kryhet vetëm me automjete që:

1. kanë pajisjet e përshtatshme për llojin dhe sasinë e mbetjeve të rrezikshme që duhet të transportohen
2. janë të sigurta për tu përdorur në rrugë dhe
3. janë rregjistruar më parë për këtë qëllim tek autoritetet përkatëse.

Procesi i regjistrimit të mbetjeve

Të gjitha mbetjet do të regjistrohen pas çdo fazë të këtij plani të menaxhimit: ndarjes/veçimit, magazinimit, transferimit dhe pranimit në zonën e asgjësimit.

Kontraktori do të krijojë mundësi që të sigurojë të dhëna të dokumentuara për çdo fazë të procesit zinxhir, sidomos për mbetjet e rrezikshme.

Do të rritet në maksimum menaxhimi i mbetjeve në një proces të vazhdueshëm dhe ky plan do të rishikohet në mënyrë periodike gjatë të gjithë fazës së së zhvillimit të aktiviteteve.

Përfundimisht, plani do të përfshijë dispozita për trajnimin e të gjithë punonjësve se si ta përdorin PMM(Planin e Menaxhimit të Mjedisit) që do të përfshijë edhe procedura në lidhje me komunikimin me palët e interesuara dhe mundësi për përmirësimin e kushteve të komunitetit.

8.2 Plani i manaxhimit socio- ekonomik

Qëllimi kryesor i vlerësimit social – ekonomik (VSE) është identifikimi i ndikimeve si edhe gjetja e rrugëve për zbutjen e tyre.

Të tre faktorët kryesorë që përcaktojnë ndikimet në situatën social-ekonomike të një zhvillimi të propozuar gjatë VSM janë:

→ Niveli deri në çfarë stadi do të kryhet studimi i VSM-së
→ Natyra dhe shkalla e zhvillimit të propozuar;
→ Konteksti socio-ekonomik i zhvillimit të propozuar.

Praktika ndërkombëtare cilëson 6 etapa për një process të saktë të analizës social-ekonomike:

1. Studimi - Një analizë paraprake që identifikon prioritetet, merr informacionin e kërkuar dhe i integron në hartimin e VSM-së. Studimi paraprak dhe efektiv ngushton fokusin e VSM në çështjet me rëndësi më të madhe.
2. Profilizimi i kushteve bazë - Fokusohet në mbledhjen e informacionit në lidhje me mjedisin social-ekonomik në kontekstin e zhvillimit të propozuar. Kjo mund të përfshijë përcaktimin e treguesve të matshëm të komponentëve me vlerë social- ekonomikë.
3. Ndikim i parashikuar - Bazohet në analizën e informacionit të mbledhur nga skanimi i profileve bazë dhe përvojat e ndërkombëtare për të parashikuar

ndikimet e mundshme social-ekonomike. Identifikimi i raportit midis ndikimeve negative dhe pozitive të një zhvillimi të propozuar është pjesë e kësaj analize.

4. Identifikimi i rrugëve të zbutjes së ndikimit - Ndikimet negative të parashikuara kërkojnë zbutjen. Zbutjen përfshijnë strategjitë, planet dhe programet për të reduktuar, për të shmangur ose për të menaxhuar sa më mirë ndikimet e mundshme.
5. Vlerësim i rëndësisë së ndikimit - Përfshin përcaktimin nëse një zhvillim i propozuar ka premisa të shkaktojë ndikime të rëndësishme negative mbi komponentët socio-ekonomike me vlerë. Nëse masat e përshtatshme zbutëse nuk mund të identifikohen, zhvillim i propozuar nuk mund të miratohet.
6. Aplikimi i zbutjes dhe monitorimi i masavëe zbutëse - Rruga më e mirë për zbutjen e ndikimeve social-ekonomike kërkon programe të mira të monitorimit (e njohur edhe si follow-up) për të siguruar zbutja e ndikimeve është duke funksionuar në mënyrë efektive, dhe kur është e nevojshme, masat zbutëse mund të përshtaten ashtu siç kërkohet.

Masat e rekomanduara në aspektin social - ekonomik gjatë ndërtimit :

- Prioritet për punësimin banorët e zonës me qëllim uljen e papunësisë dhe shtimit të të ardhurave
- Kontraktim me kompanitë e zonës të fushës së ndërtimit për mundësi bashkëpunimi
- Bashkëpunim me zyrën rajonale të punës për lehtësinë në gjetjen e karhut të përshatshëm të punës
- Punësim të banorëve vendas me qëllim uljen e kostos së transportit apo akomodimit
- Prioritet përdorimi i produkteve të zonës për ushqim, gjë e cila mund të shërbeje edhe si një marketim i mirë i zonës dhe të shtojë të ardhurat për banorët e saj.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe trainim i punëtorëve dhe stafit të ndërmarrjes mbi sigurinë në punë.

- Mbajtja në gatishmëri e një këndi të ndihmës së shpejtë dhe mjeteve përkatëse për këtë qëllim.
- Mbajtja e detyruar e kaskës dhe mjeteve tjera të duhura, sipas vendit dhe proceseve të punës
- Numrat e kontaktit të urgjencës duhen publikuar në vende të dukshme në territorin e punës.
- Sinjalizues të pershtatshem për lajmërimin e rreziqeve duhen vendosur në vendet ku ekzistojnë rreziqet për aksidente. Keto territore duhen rrethuar edhe me pengesa lehtësisht të dallueshme.
- Punonjësit do të punësohen konform konditave të ligjeve të Kosovës dhe kontraktori duhet te respektojë kerkesat për kushte optimale higjeno- sanitare të specifikuara nga legjislacioni.
- Punëdhënësi duhet te garantoje sigurimet shëndetsore

Për mbarevajtjen e funksionimit normal të këtij aktiviteti në menyrë që puna të ecë në përputhje me legjistacionin në fuqi dhe në shërbim bashkëkohor, si e vetmja menyrë ekzistente, del e domosdoshme sigurimi teknik i punonjësve dhe specialistëve sipas rregulloreve në fuqi si dhe sigurimi shëndetesor dhe shoqëror i tyre. Pa realizimin e këtyre detyrave funksionimi i këtij projekti nuk mund të kuptohet. Për këtë arsye rekomandojmë që instruktimi teknik të bëhet sipas rregulloreve në fuqi.

Duke u kujdesur për minimizimin e efekteve negative dhe rritjen e efekteve pozitive, investitori do të zhvillojë aktivitetin e ndërtimit të këtij Projekti duke përmiresuar kushtet e punës dhe konkretisht :

- Për mbrojtjen e vendeve të punës dhe mjedisit nga pluhurat që krijohen gjatë punës janë marrë të gjitha masat për minimizimin e tyre.
- Për ujërat e ndotura dhe me mbetje në sheshet dhe rruget lidhëse të sherbimit do të realizohet kullimi i ujërave sipërfaqesore në kanalet e hapura për këtë qellim dhe shkarkohen në kanalin e caktuar të rrugës ose në ate anësor sipas lejes që do të merret për këtë qëllim. Ndërsa ujërat e zeza nepermjet kanalizimeve shkojnë ne kolektorin kryesor të shkarkimeve.
- Për eleminimin e rreziqeve gjatë furnizimit me energji elektrike të gjithave pajisjeve që punojnë nën tension i'u është bërë tokëzimi

Masat e rekomanduara në aspektin ekologjik

Llojet e gjitarëve të pranishëm dhe vlera ekologjike e tyre përcatohen ne Direktivat Europiane të Habitateve dhe Shpendëve 92/43 EEC dhe 79/409 EEC

Për të vlerësuar madhësinë e ndikimit të skemës janë përcaktuar kushtet analitike që shërbejnë si standarde mbi shkallën e ndikimeve, nga “pa ndikim” deri në “ndryshim të madh”. Këto kritere marrin parasysh humbjet e drejtpërdrejta të habitateve dhe karakteristikave ekologjike që ndodhin nga marrja e tokës për shfrytëzim dhe ndikimet e perceptuara të tërthorta si ndotja dhe fragmentimi i habitateve.

8.3 PLANI I MENAXHIMIT TË TRAFIKUT

Do të hartohet Plani i Menaxhimit të Trafikut (PMT) për të menaxhuar trafikun që gjenerohet gjatë fazës së kryerjes së punimeve për të minimizuar çrregullimet në trafik dhe vonesat e përdoruesve të rrugës dhe për të ofruar një siguri të vazhdueshme për përdoruesit e rrugës, përfshirë këmbësorët dhe çiklistët. Të gjitha ndikimet në lidhje me trafikun që janë përshkruar më parë mund të zbuten në mënyrë shumë efektive duke zbatuar praktikat më të mira standarte në lidhje me kontrollet mjedisore dhe praktikat e menaxhimit gjatë ndërtimit. Këto masa do të paraqiten të detajuara në PMT, i cili do të përshkruajë në detaje masat që do të zbatojë kontraktori gjatë fazës së ndërtimit të projektit.

Çështjet kryesore që do të trajtohen nga PMT në lidhje me masat lehtësuese përfshijnë:

- → E drejta për të hyrë në zonat e ku zhvillohen punimet
- → Përcaktimi i itinerarit të trafikut të mjeteve
- → Parandalimin e vonesave të përdoruesve të rrugës
- → Kontrollin dhe menaxhimin e përkohshëm të trafikut
- → Reduktimin e mundësisë për aksidente në trafik dhe përmirësimi i sigurisë për përdoruesit e rrugës dhe për të tjerët
- → Parandalimi i dëmtimit të sheshit dhe rrugeve levizëse të brendhsme dhe të jashtme

→ Vendet e parkimit.

Kontraktori duhet të azhurnojë rregullisht Planin e tij për Menaxhimin e Trafikut, ndërkohë që harton metodën e ndërtimit dhe identifikon në detaje kërkesat për lëvizjen e automjeteve.

Një PMT është i rëndësishëm për të garantuar sigurinë e personelit të ndërtimit dhe të punonjesve të sheshit ku do kryhen punimet. Synimi është që PMT të jetë një dokument “i gjallë” dhe parimet e tij të menaxhimit të trafikut do të përbëjnë bazën për masat e detajuara që do të merren në vijim ndërmjet kontraktorit dhe autoriteteve që menaxhojnë trafikun

PMT do të përfshijë kërkesat minimale të mëposhtme:

→ Nivelet e zhvillimit në lidhje me mjetet e ndërtimit që do të përdorin rrjetin rrugor.
→ Masat në zonë për të hyrë në zonë e punimeve dhe brenda zonës të punimeve.
→ Identifikimin e elementëve kryesorë të ndjeshëm përgjatë rrugëve të propozuara që të çojnë në zonë.
→ Identifikimin, caktimin e kufijve dhe ndërtimin e të gjitha rrugëve që të çojnë në sheshin e punimeve.
→ Masat për të ofruar siguri të vazhdueshme për përdoruesit e rrugës, përfshirë këmbësorët dhe çiklistët.
→ Kërkesat e trajnimit për shoferët e automjeteve të projektit në lidhje me sigurinë në rrugë dhe mjedisin.
→ Kalendari i aktiviteteve të Projektit.
→ Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e PMT.
→ Kufizimet e shpejtësisë dhe metodat e zbatimit të tyre.
→ Mjetet për të informuar komunitetin mbi rreziqet e trafikut.
→ Pajisjet e automjeteve.
→ Mirëmbajtja e automjeteve dhe vendet për furnizimin me karburant.
→ Inspektimi, kontrolli dhe raportimi.
→ Aftësitë e drejtuesve të automjeteve.

⇒ Të caktojë mjetet e rënda të ndërtimit që të lëvizin në rrugë të përshtatshme për në dhe nga zona ku kryhen punime.

⇒ Të identifikojë personat e ngarkuar për kryerjen dhe menaxhimin e procedurave

9. 0. PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT

Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve. Në ligjin e "Vlerësimit Strategjik Mjedisor", kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE për VSM-n. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPH-ja nëpërmjet AKMM Agjencisë Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit, e cila zbaton Monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Me qëllim që projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" të zbatohen me efektivitet dhe te realizohen objektivat dhe synimet qe janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruam edhe më sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa me racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do ti referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbatuese të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje". Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndermarrje kerkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilet duhet të bashkërendojnë aktivitet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjensise Kosovare të Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbështetur në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Prishtinës ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje".

Komuna e Prishtinës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerëzore dhe financiare të gjithë këte veprimtari. Megjithate ajo, duke angazhuar Drejtorinë e Planifikimit të Mjedisit dhe struktura të tjera në vartesi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndertimeve, ecurine e gjelbërimit, zgjerimit të parqeve dhe siperfaqeve te gjelbra, ecurinë e nderimit te rrugeve të reja perfshirë ato për qarkullimin me bicikleta dhe dhe te tjere indikatore që janë paraqitur në programin e monitorimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”.
Rezultatet e monitorimit, komuna e Prishtinës sipas ligjit për VSM-n, duhet ti publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushen VSM, VNM për monitorimin dhe rezultatet ti percillen komunës së Perishtinës dhe MMPH-së gjegjsisht Agjensise Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit.

Programi i monitorimit do të zvogëlojë rrezikun mjedisor që mund të rezultojë nga zhvillimi i aktiviteteve punuese.

Detyrat e monitorimit të mjedisit përcaktohen si më poshtë:

- Kontrollimi i plotësisë dhe cilësisë së detyrave inxhinierike të projektit
- Përcaktimi i nivelit të ndikimit në mjedis
- Kontrolli i përputhjes së parametrave fillestare të projektit me situatën aktuale
- Hartimi i propozimeve për të ofruar "siguri ekologjike" aty ku mospërputhja ndodh në mes të rezultateve të vëzhguara dhe ndikimeve të parashikuara.

Kontraktuesi do të zhvillojë masa që kanë për qëllim parandalimin ose pastrimin në lidhje me çdo aktivitet ndotës që nuk është paraparë në projekt. Gjatë periudhës së zhvillimit te aktiviteteve punuese Kontraktuesi ose organizatat e rekrutuara nga Kontraktuesi do të jenë përgjegjës për monitorimin.

Nëse është e nevojshme, do të përfshihen ekspertë të pavarur.

Monitorimi do të përfshijë:

- Kontrollimin e plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të projektimit të rregulloreve të miratuara në fazat e hershme të projektimit duke përfshirë masat që synojnë të përjashtojnë ose minimizojnë ndikimet, kompensimin, objektet për

mbrojtjen e mjedisit dhe aktivitetet

- Përfshirja e masave, në projekt duke u shpjeguar punëtorëve të Kontraktuesit rregulloret për mbrojtjen e mjedisit dhe zgjidhje të poblemeve së bashku me trajnimin e punonjësve nëse është e nevojshme
- Mbikëqyrja e kompensimit dhe pagesat e tyre, të parashikuara në projekt.
- Mbikëqyrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së kryerjes së punimeve
- Monitorimi i respektimit të rregulloreve, dokumenteve standarde, kushteve teknike dhe kërkesave të projektit nga Kontraktuesit
- Investitori është i obliguar që të bëj monitorimin e përhershëm të ndikimeve negative në mjedis e posaçërisht monitorimin e ujërave të cilat derdhën nga objektet banesore.
- Monitorimi i ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate, për të vërtetuar nivelin e pastërtisë së ujërave që shkarkohen nga objektet banesore.
- Duhet të merren mostrat e ujit para shkarkimit të ujërave dhe pas shkarkimit të ujërave nga objektet banesore.
- Të bëhet kontrollimi i përhershëm i seperatorëve të vajit dhe yndyrave si dhe i gropës septike, dhe zbrazja e tyre të bahet me kohë.
- Kontejnerët e mbeturinave të zbrazën rregullisht.
- Të respektohen të gjitha rregullat teknike dhe kërkesat lidhur me sigurinë ndaj zjarrit, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Table 6 Idikatorët e programit të monitorimit të mjedisit

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtes së Mjedisit	Synimi
Shendeti banoreve	Promovimi per krijimin e nje Lagje të qendrueshme dhe të shëndetshme	1. Cilesai e ujit te pijshem konfrom standardit 2. Dendesia e popullsisë konform normave të lagjeve më të zhvilluara ndërkombëtare
Biodiversiteti	Identifikimi dhe krijimi i habitetve te reja, dhe korridoreve te	1. Krijimi i mjedisve te gjelbra në Lagje 2. Mbjellja e drunjve dekorativ, pemeve pergjatë dhe brenda

	gjelberta	sipërfaqes kufizuese të Lagjes 3. Krijimi i korridoreve të gjelbera dhe tampon zonave
Ajri	Permiresimi i cilësisë së ajrit	1. Ulja e niveli të ndotjes së ajrit për: NO_2; LNP; PM10; PM2.5; O_3. 2. Rruge të asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelt të zhurmave në zonat e banimit në Lagje 4. Aplikimi në banesa i materialeve termizolues dhe mbrojtie akustike
Faktorët klimatikë	Kursimi i energjisë dhe paksimi i emisioneve të gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat 2. Promovimi i paneleve diellor për gjenerim energjie në ndertesat residenciale dhe sociale
Uji	Cilesia e ujërave sip.në përputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktives kuadre për ujin te BE	1.Shmangia e shkarkimeve të ujrave të ndotura ne recipent 2. Sigurimi i hudhjeve të mbeturinave në recipent. me qëllim ruajtien e niveleve minimal të ndotjes
Mbetjet	a)Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe manaxhimi qëndrueshem i tyre b) Shndërrimi i pikave të nxehta mjedisore në siperfaqe të gjelbra/parqe ose zona residenciale	a.1. Pakësimi në burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa konteniere për ndarjen në burim të mbetjeve urbane b.1. Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbërta

Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intesnsitetit të trafikut nëpermjet promovimit të transportit publik, qarkullimi me bicikleta ku mundet me ndodhë	1.Ndërtimi i rrjetit rrugor për trafikun publik 2. Ndërtimi i korsive per bicikleta 3. Ndertimi i rrugeve me hapsira të përshtatshme trotuaresh (përfshire korsite e bicikletave). 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugeve lokale
Trashegimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtia e vlerave te kulturore, perfshire ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirembajtia dhe ruajtja e objekteve te trashegimise kulturore
Peizazhi,pyjet dhe toka	1.Ndërtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror në hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Ripërdorimi i tokave të ndotura 4.Mirëmbajtje dhe zhvillim i hapësirave gjelbëruese	1. Shtimi i hapsirave te reja dhe numurit te pemeve e shkurreve. 2. Hartimi i një plani të manaxhimit mjedisor të këtyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave të ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe venia ne eficiense per zona te gjelbera/parqe 4.Gjelbërimi i hapësirave të Lagjes, ndërtimi i parqeve etj

10.0 Masat rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit (jetëgjatësisë) të Projektit

Duke pasur parasysh llojin e veprimtarisë, pozitën dhe kushtet e lokacionit ku do të zhvillohet projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” dhe në raste të rrënimit të

ndonjë objekt banimi, duhet të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i sipërfaqeve të degraduara.

Në rast (edhe pse nuk do të ndodhë) se do të largohen (rrënohen) objektet banesore me infrastrukturën përcjellëse nevojitet të përgatitet raporti VNM-së përmes të cilit qartë definohet ndikimi në mjedis, përshkruhen masat e nevojshme që duhet të ndërmirrën gjatë largimit (rrënimit) të kompleksit të objekteve banesore me infrastrukturën përcjellëse.

11.0 Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor

Synimi 1. Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në recipient si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza

Problem në vete në tërë territorin e Kosovës përveç ndotjes nga trupat e ngurtë që hidhen në shtretërit e lumenjve është edhe shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak e sidomos edhe i objekteve komerciale.

Ndotja e ujerave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore është pasojë e të gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqësore. Ujërat e zeza urbane paraqesin problem të veçantë si pasoje e mungesës së trajtimit të tyre.

Pjesa më e madhe e qytetit, kombinon sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza dhe mbledhjes së ujit të bardha që shkarkohen drejtpërdrejtë në ujin sipërfaqësor.

Ndotja e ujit nga aktivitetet si p.sh. pastrimi i automjeteve dhe servisimi, mbetjet bujqësorë, pesticidet e ruajtura keq apo të braktisura dhe kimikate të tjera, shkarkimi i ujërave të zeza në trupat ujor pa trajtim paraprak ndikojnë në cilësinë e dobët të ujit.

Presione të tjera përfshijnë ndërtimet e pakontrolluara, ndotja dhe eutrofikimi që vjen nga ujërat e zeza të pa trajtuara që shkarkohen në lumenj dhe nga rrjedhja e plehrave kimike dhe pesticideve nga toka bujqësore në drejtim të lumenjve, rrëshqitje dhe gërryerje të tokës, praktikat e gjuetisë në dëm të mjedisit etj.

Masat e parapara në këtë strategji:

- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në tërë zonën e banimit .
- Ndërtimi i sistemeve të gropave septike
- Përcaktimi i lokacionit varësisht se cili opsion është i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Ndarja e kanalizimit fekal nga ai i shirave
- Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet
- Identifikimi i lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.

Te gjitha implikimet buxhetore janë paraparë në Infrastrukturë. Këto rekomandime janë konformë rregullave mjedisore .

Synimi 2. Ruajtja e cilësisë së tokës – Ndërtimet e pa kontrolluara, mbetjet e amvisërisë, mbetjet ndërtimore, mbetjet industriale, përdorimi jo i drejtë i plehrave kimike dhe pesticideve, mënyra e përdorimit të tokave, shkarkimi i ujërave të zeza, fatkeqësitë natyrore siç janë vërshimet etj. ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e tokës.

Duke marr parasysh një varg problemesh që shkaktohen nga faktori njeri duhet marr masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet eksperteve të fushave përkatëse.

Masat parandaluese;

1. Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë
2. Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme
3. Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve
4. Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave

Synimi 3. Mjedis i pastër dhe atraktiv

- Organizimin e një sistemi funksional dhe mjaft efikas për menaxhimin e mbeturinave.
- Angazhimi i kompanive profesionale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- Funksionalizimi i inspektoratit të mjedisit dhe ndërmarrja e masave të rrepta ndaj veprimeve ilegale mjedisore.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me donatorët privat për të gjetur mundësinë e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve dhe gropave septike.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatoret tjerë për hartimin e planeve menaxhuese të pyjeve, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura.

Kriteret strategjike

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër te hartimit te projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash te bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, te cilat shkurtimisht mund të përmblidhen në dhjete pika si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesi i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër te hartimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme

- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës.
- Krijimi i rrugëve brenda lagjës– aksesi I mire në rrugë është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit.
- Rehabilitimi i tokës së degraduar
- Krijimi I hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ.
- Ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime.

Në kuadër te hartimit të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme

- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës.
- Krijimi i rrugëve brenda lagjës– aksesi I mire në rrugë është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit.
- Rehabilitimi i tokës së degraduar
- Krijimi I hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ.
- Ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime.

Objektiva Strategjike

Objektivat strategjike të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" janë në përputhje me parimet e lartpërmendura të planifikimit hapësinor të qëndrueshëm.

Objektivat strategjike të pranuara gjerësisht përfshijnë:

- Lagjia "Prishtina e Re – Zona Lindje – Lagje me vendbanime atraktive dhe që përballojnë nevojat për banim;
- Lagjia "Prishtina e Re – Zona Lindje – Lagje e shëndetshëm
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe tjera të gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike në dhe për rreth vendbanimeve;
- Përmirësime dhe zgjerimi i rrugëve përfshire edhe koristë për biçikleta dhe këmbësoret;
- Përmirësim transportit publik (përmirësim i shërbimit te autobusëve)
- Përfshirja dhe integrimi në planifikim i situatës faktike të ndërtimeve dhe tipologjisë se përdorimit të tokës.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Lagje (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike te planit.

Ndër të tjera, projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane "B" të lagjës "Prishtina e Re – Zona Lindje" përpiqet të zbatoje disa parime dhe modele zhvillimi të pranuara gjerësisht, si psh. qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevoje të udhëtojë për të siguruar shërbimet veç në në raste emergjente.

Projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” parashikon zhvillimin e Lagjës si një e tërë me territor të bashkuar me vendbanimet. Në këtë faze, do jepen kufijtë, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e parashikuara për tërë lagjën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijoje me planet rregulluese urbane që detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Plani do përpiqet të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës në mënyrë adekuate pa dallime të pronarëve gjatë destinimeve në zona ndërtimi, gjelbërim etj.

Projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” parasheh një zhvillim me miqësor me mjedisin, duke synuar pyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve dhe shume mundësi të rritjes se sipërfaqeve të gjelbra brenda vendbanimeve.. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktikë i këtyre synimeve për pyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisore të Lagjes.

Një tjetër aspekt mjedisor i Planit është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisore, ndërrmarje që krijon mundësi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe argëtim.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin të projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje” mund të përmblidhen si më poshtë:
1. Krijimi i një lagje të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
4. Kursimi i energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;
5. Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës Kuadër për Ujin të BE-së;
6. Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;
historike
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror nga erozioni dhe vërshimet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend te tokave te reja.

Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në Lagje:
1. Pyllëzimi dhe gjelbrimi i zonave të parapara me Planin e ndërtimit
2. Krijimi i parqeve për rreth vendbanimeve;
3. Krijimi i korridoreve ekologjike sipas Planit të ndërtimit të Lagjes;
4. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve etj;

7. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
8. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive banuese;
10. Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
11. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Veprime operacionale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:
1. Përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i rrugëve të reja sipas mundësisë;
2. Krijim i rrjetit të plote rrugor në Lagje me përmbajtje edhe për biçiklistët dhe këmbësoret;
3. Përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë se autobusëve;
4. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve te plota dhe shiritave/korsive për biçikletat sipas standardeve evropiane të rrugëve;

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Projektin për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, është bërë si rezultat i punës në terren, konsultimeve me stafin e Kompanisë projektuese dhe konsultimin e literaturës profesionale, që për momentin vlerësohet se ofron të dhëna për vlerësimin e gjendjes mjedisore dhe rekomandimin për një mjedis të shëndosh.

Ndikimet në mjedis pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport të VSM-së, mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm dhe niveli i ndikimeve do të jetë dukshëm nën vlerat e përcaktuara me legjislacionin mjedisor valid.

Peizazhi ku do të realizohet projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, është një gjurmë që nuk është në ndonjë mbrojtje të veçantë. Efektet mbi peizazhin e pjesës ku do të ndërtohet Lagjia është një zonë rurale dhe ku ndikimet do të jenë të *moderuara.*

Konsiderohet se efektet e mundshme në gjeologjinë dhe hidrogjeologjinë e zonës do të ndodhin përgjithësisht në një shkallë lokale. Nuk do të ketë efekte në burimet e vlefshme minerale.

Disa habitate shumë të rëndësishme do të humbin ose fragmentohen. Një numër masash lehtesuese dhe kompensuese janë rekomanduar në fazat e ndërtimit dhe shfrytëzimit për të trajtuar këto ndikime.

Rezultatet e monitorimit të ajrit tregojnë se përqendrimet e NO2 janë nën vlerën e përcaktuar si kufi të KE. Bazuar në këtë informacion, nuk propozohet të ndërmerret ndonjë monitorim të mëtejshëm gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të rrugës.

Megjithatë, do të pranohet që sasia e pluhurit në receptorët mund të rritet gjatë fazës së ndërtimit. Për të minimizuar ndikimet e pluhurit, masat zbutëse të përmendura me sipër do të përfshihen në procedurat e ndërtimit dhe do të zbatohen sipas rastit. Ndikimi do të jetë *i përkohshëm i kthyeshëm*

Përfundimet kryesore socio-ekonomike të raportit janë përmbledhur si më poshtë:

- Ndërtimi i Lagjes “Prishtina e Re – Zona Lindje”do të ndihmojë në zhvillmin ekonomik të zonës.
- Ekziston një potencial i lartë i punësimit dhe mundësi të mira për nën/kontraktorët lokalë.

Marrja e masave parandaluese do të bëjë që ndikimi i mbetjeve të gjeneruara do jetë shumë i vogël dhe mund të cilësohet si *i parëndësishëm.*

Si përfundim mendojmë që ky Projekt duhet të realizohet sepse ndërtimi i tij do të jetë një mundësi shumë e mirë për zhvillmin e zonës, promovimin e saj si edhe për rritjen e cilësisë së mjedisit.

Ky ndërtim duhet të shoqërohet më aplikimin e të gjitha masave lehtësuese të përmendura në këtë studim si edhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

•Të zbatohen me rigorozitet Planet e Manaxhimit Mjedisor dhe Monitorimit të projektit, gjatë ndërtimit dhe gjatë funksionimit të Lagjes, në mënyre që të zbuten në maksimum ndikimet edhe pse të ulëta negative të përshkruara në kapitujt përkatës.

•Vëmendje dhe kujdes të madh në fazën e ndërtimit dhe të funkisonimit sidomos në zonat me ndjeshmëri të lartë

Këto masa do të vendosen dhe përshtaten sipas rezultateve të një programi të duhur monitorimi dhe do të diskutohet me autoritetet kompetente para fillimit të punimeve.

Rekomandime :

- Gjatë procesit të ndërtimit në zbatim të projektit të hartuar nga specialistë të fushave përkatëse të mos preket apo përdoret sipërfaqe jashtë sheshit të ndertimit nga ajo e planifikuar.
- Të bëhet kujdes i veçantë gjatë ndërtimit për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit me grumbullim në një vend të caktuar dhe evakuimin brenda ditës në vendin e caktar më parë nga njesia vendore .
- Të bëhet kujdes i veçantë në mënyrë që të mos ndotet sipërfaqja e tokës nga hedhja e përzierjeve të ndryshme me ujin, e rërave, gëlqeres apo çimentos etj.
- Të zbatohen rregullat teknike dhe masat e sigurimit teknik në punë gjatë ndërtimit në mënyrë që të evitohet në maksimum ndonjë aksident i mundshëm .
- Të zbatohen rregullat e mbrojtjes ndaj zjarrit
- Të përdoret personel i kualifikuar dhe i instruktuar.
- Të mos zihet as përkohesisht rruga apo sheshi jashtë planifikimit më par
- Të zbatohet në çdo fazë legjistacioni në fuqi si gjatë ndertimit ashtu edhe gjatë funksionimit të këtij Projekti

- Në çdo rast avarie të mundshme të njoftohen menjëherë strukturat përkatëse për marrjen e masave në mënyrë urgjente.

Projekti për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje”, përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuara gjerësisht dhe përfshinë:

- Lagja“Prishtina e Re – Zona Lindje”– Lagje me vendbanime atraktive dhe që përballojnë nevojat për banim;
- Lagja“Prishtina e Re – Zona Lindje”– Lagje e shëndetshëm
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe krijimin e korridoreve ekologjike në dhe përreth vendbanimeve;
- Përmirësimi dhe zgjerimi i rrugëve përfshirë edhe korsitë për biçikleta dhe këmbësorë;
- Përmirësim i transportit publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve)
- Zgjerim i vendbanimeve në drejtimin e tokës më pak kualitative bujqësore

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbërta, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbërta.

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbërta:

1. Gjelbërimi i zonave të parapara me Planin e ndërtimit
2. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe përreth vendbanimeve
3. Krijimi i korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të Projektit për Rivedimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërsinë Urbane “B” të lagjës “Prishtina e Re – Zona Lindje
4. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve nëLagje etj;
5. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbërta;
6. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive private;
7. Gjelbërimi me drunj dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
8. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

A N E K S

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Faza	Ceshtje	Masat Lehtesuese	Pergjegjesia Institucionale		
			Instalimi	Mbikëqyrja	Komente(p.sh. ndikimet sekondare)
Ndertimi	a)Gurë, rërë dhe zhavorr, pluhur	a)Kamionë të mbuluar ose ngarkesë e lagësht, veçanërisht në pjesët ku receptorët kritikë (zonat e banimit dhe shkolla në 3 + 485) janë të vendosura	Operatori i kamionëve	Operatori i kamionëve	a) -d) të specifikohen në ofertë dokumentet-Specifikimet Teknike për realizimin e punimeve
	b)Pluhur asfalti, avullimi	b)Të gjithë kamionët duhet të mbulohen	Operatori i kamionëve	Operatori i kamionëve	
	c)Pluhuri prej guri	c)Kamionë të mbuluar ose ngarkesë e lagësht	Operatori i kamionëve	Operatori i kamionëve	
	d)Pluhur prej rëre dhe zhavorri	d)Kamionë të mbuluar ose ngarkesë e lagësht	Operatori i kamionëve	Operatori i kamionëve	
	Zhurma e menaxhimit të trafikut, shkarkimi i automjeteve, mbingarkesa rrugore	Ngarkesa e materialit në orët e pikut të trafikut (mundësisht 9-14h); përdorin rrugët alternative për të minimizuar ngarkesat e mëdha te trafikikut Duhet të sigurohet që shenja adekuate për të punuar në frontet të dëmtojnë shanset e "kthimit të gabuar" duke shkaktuar edhe më shumë ngjeshje	Menaxheri i transportit, Operatori i kamionëve	Menaxheri i transportit, Operatori i kamionëve	

	Rastet e gjetjeve arkeologjike	Në rast të gjetjeve Kontraktuesi është i detyruar të ndërpresë punon menjëherë dhe informon institutin për mbrojtja e monumenteve kulturore	Kontraktori	Kontraktori mbikqyrës	
Zonë ndërtimi					
Ndertimi	Shqetësimet nga zhurma tek popullata njerëzore dhe kafshët	Kufizoni aktivitetet në orët e punës gjatë ditës (jo ndërmjet orës 20 deri në orën 7 ose siç është rënë dakord me publikun dhe autoritetet); pajisje që funksionojnë me zhurma.	Kontraktori i ndërtimit	Kontraktori i ndërtimit	

			Pergjegjesia Institucionale		
Faza	**Ceshtje**	**Masat Lehtesuese**	**Instalimi**	**Mbikëqyrja**	**Komente(p.sh. ndikimet sekondare)**
Ndertimi	Punëtorë	Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të mbajtur prodhimin e zhurmës në nivelin më të ulët të mundshëm gjatë kryerjes së punëve të tij në afërsi të shkollës Kontraktuesi duhet të ngre barriera të përkohshme në rast se ai ka nevojë për të zvogëluar nivelin e zhurmës gjatë ndërtimit. Masat zbutëse duhet të zbatohen nëse nivelet janë më të larta se ato të parashikuara ligjërisht. Pajisjet e zhurmshme do të vendosen sa më shumë që të jetë e mundur nga receptorët rezidencialë ose të tjerë të ndjeshëm.			

	Pluhuri	Vend ndertimet për ujë dhe vendet e organizuara të magazinimit të materialeve si të përshtatshme, shpejtësi të kufizuar të automjeteve, veçanërisht në seksionet ku janë vendosur receptorët kritikë (zonat rezidenciale dhe shkolla) Zbatimi i një plani për menaxhimin e pluhurit: masa për të shmangur / minimizuar shkarkimet e pluhurit, duke përfshirë përdorimin e groposjes; spërkatjen e shesheve të ndërtimit,; mbulimi i automjeteve që mbajnë materiale pluhur; larja / spërkatja e automjeteve;	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Vibrimet(dridhjet)	Kufizoni aktivitetet në orët e punës në orët e ditës (jo ndërmjet orës 20.00 deri në orën 7:00 ose siç është rënë dakord me publikun dhe autoritetet) nëse çdo dëm material që është provuar të jetë shkaktuar në shtëpitë, ndërtesat dhe infrastrukturën tjetër (duke përfshirë rrugët e aksesit)kompensohen dhe i nënshtrohen riparimit në kohën e duhur. Pajisjet e ndërtimit do të vendosen sa më larg të jetë e mundur nga receptorët e ndjeshëm ndaj dridhjeve	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
Faza	**Ceshtje**	**Masat Lehtesuese**	**Pergjegjesia Institucionale**		
			Instalimi	**Mbikëqyrja**	**Komente(p.sh. ndikimet sekondare)**
Ndertimi	Çrregullim trafiku gjatë aktivitetit të ndërtimit	Plani i menaxhimit të trafikut me masa për të përcjellë trafikun që shihet lehtësisht ose është i lehtë për t'u ndjekur; përfshirë ndihmën e policisë së trafikut nëse është e nevojshme Plani i Menaxhimit të Trafikut të Ndërtimit do të vendosë kufijtë e shpejtësisë për automjetet e ndërtimit dhe të organizohet për të shmangur sa më shumë zona të populluara. Banorët vendas do të mbahen të informuar për punët e planifikuara	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	

	Siguria e automjeteve dhe e këmbësorëve kur nuk ka aktivitet ndërtim	Ndriçimi i duhur dhe shenjat e përcaktuara mirë të sigurisë dhe masat mbrojtëse	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Qasje e reduktuar në aktivitetet në rrugë	Ofrojnë qasje alternative në aktivitetet në rrugë në çdo kohë	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Ndotja e ujit dhe tokës nga ruajtja, menaxhimi dhe përdorimi i paautorizuar i materialeve	Organizojnë dhe mbulojnë zonat e ruajtjes së materialeve; izolojnë betonin, asfaltin dhe punimet të tjera nga rrjedha ujore duke përdorur shufra të mbyllura ose mbulime; izolojnë zonat larëse nga kamionët qe bartin beton, asfalt dhe pajisje të tjera nga uji duke zgjedhur zonat për larje që nuk janë të ujëlëshuese direkt në përrua Operon vendin e ndërtimit në një mënyrë për të zvogëluar rrezikun e gjenerimit të sedimenteve dhe ujërave të ndotura që mund të ndotin tokën lokale ose marrjen e trupave të ujit (duke marrë parasysh situatat si p.sh. përfshirja e rrjedhës së ujit të stuhisë, ujërat e zeza të gjeneruara nga objektet në vend siç është objekti i larjes së rrotave)	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
Faza	**Ceshtje**	**Masat Lehtesuese**	**Pergjegjesia Institucionale**		
			Instalimi	**Mbikëqyrja**	**Komente(p.sh. ndikimet sekondare)**

	Ndotja e ujit dhe tokës nga ruajtja, menaxhimi dhe përdorimi i paautorizuar i materialeve	Plani i Menaxhimit të Tokës do të përgatitet për largimin e kontrolluar të dheut të tepërt, magazinimin dhe ripërdorimin. Parandalimi i sedimenteve që rrjedhin në ujërat sipërfaqësore dhe kanalet e kullimit përmes masave të kontrollit të lokalizuara (p.sh.gardhet e sedimenteve, digat e kontrollit, barrierat e mulch(bimëve), pellgjet e sedimenteve), konturimi për të optimizuar këndin e pjerrësisë dhe pjerrësinë, Parandalimin e erozionit të erës përmes rrethimit, mbulimit etj.	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Ndotja e ujit dhe e tokës nga hedhja e pakontrolluar e materialeve të mbeturinave.	Hidhni materialin e mbeturinave në vendin e mbrojtur nga shplarja, duhet të shënohet në planin e zonës se ndertimit; nëse jo në vend, pastaj në deponinë e autorizuar / depo	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Ndotja e ujit dhe e tokës nga hedhja e pakontrolluar e materialeve të mbeturinave.	Ruajtja e mbeturinave sipas praktikave më të mira ndërkombëtare (Udhëzuesi i Përgjithshëm i IFC EHS). Aplikoni shtesë masat për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme (të tilla si përdorimi i kontrollit sekondar, kufizimi i qasjes,sigurimi i PPE, etj) si të nevojshme për të parandaluar dëmtimin e stafit ndërtimor, mjedisit dhe publikut. Përdorni dhe etiketimi i kontejnerëve të grumbullimit të mbeturinave dhe zonave të magazinimit për lloje të ndryshme të mbeturinave (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme).	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Ndotja potenciale e tokës dhe ujit për shkak të mirëmbajtjes jo të mirë të pajisjeve dhe karburantit	Aplikoni praktikën më të mirë inxhinierike në depo të sigurt për trajtimin e lubrifikanteve, karburantit dhe tretësit; sigurojnë ngarkimin e duhur të karburantit dhe mirëmbajtjene pajisjeve; të mbledhë të gjitha mbeturinat dhe të vendosë në deponitë e lejuara për deponimin e mbeturinave të mbetjeve	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
Faza	**Ceshtje**	**Masat Lehtesuese**	**Pergjegjesia Institucionale**		

			Instalimi	**Mbikëqyrja**	**Komente**
	Ndotja e ujit dhe e tokës nga hedhja e pakontrolluar e materialeve të mbeturinave	Transporti i mbeturinave në automjetet e shënuara të projektuara për llojin e mbeturinave për të minimizuar rrezikun e lëshimit të materialeve (materialeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) dhe mbeturina të vjetra. Trajnimi i shoferëve në trajtimin dhe asgjësimin e ngarkesës së tyre dhe dokumentacionin e transportit që përshkruan natyrën e mbeturinave dhe shkallën e rrezikut të tij.			
	Siguria e punëtorëve	Ju sigurojnë punëtorëve udhëzime sigurie dhe pajisje mbrojtëse; organizim i sigurt i trafikut anashkalues	Kontraktori i ndertimit	Kontraktori i ndertimit	
	Pejzazhi	Ndërmarrja e masave për ri-vegjetacionit progresiv me kulture bimore dhe specie endemike vendore si dhe monitorimin efektiv të tyre. Kur pejzazhi fillestare nuk është i suksesshëm, do të bëhet zëvendsimi plantacioneve me kujde			
Operimi	MIRËMBAJTJA				
	Çrregullimi nga zhurma ndaj njerëzve, popullatës dhe punëtorëve	Kufizoni aktivitetet në orët e punës të orarit të punës (jo ndërmjet orës 20 deri në orën 7 ose siç është rënë dakord me publikun); pajisje që veprojnë me zhurmë	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	
	Vibrimet(dridhjet)	kufizoni aktivitetet në orët e punës gjatë ditës (jo ndërmjet orës 20 deri në orën 7 ose siç është rënë dakord me publikun dhe autoritetet)	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	

			Pergjegjesia Institucionale		
			Instalimi	**Mbikëqyrja**	**Komente(p.sh. ndikimet sekondare)**
	a)Sigurimi i punëtorëve	U sigurojnë punëtorëve udhëzime sigurie dhe pajisje mbrojtëse; Kjo me të vërtetë mund të zgjerohet pasi që është mjaft e kufizuar	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	a) -c) të specifikohen në dokumentet e kontratës së mirëmbajtjes- Specifikimet teknike për realizimin e mirëmbajtjes
	b)Rritja e shpejtësisë së automjetit	Instaloni shenja të komunikacionit për kufirin e shpejtësisë	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	
	c)Ajri i mundshëm, ujë dhe pluhuri i ndotjes së tokës, lirimi i gazrave, lëndëve djegëse dhe derdhjet e lubrifikanteve	Aplikoni praktikën më të mirë inxhinierike në ruajtjen dhe trajtimin e sigurt të lubrifikantëve, lëndës djegëse dhe tretës magazinimit; sigurojnë ngarkimin e duhur të karburantit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve; të mbledhë të gjitha mbeturinat dhe të disponojë në përputhje me Ligji për menaxhimin e mbeturinave; organizojnë dhe mbulojnë zonat e ruajtjes së materialeve; izoloni asfaltin nga rrjedha e ujit duke përdorur kornië të mbyllur; përzgjedhja e hapësirave për larje që nuk janë të lira, kullues direkt ose indirekt në rrjedhën ujore (lumi Sitnica); hidhni materialin e mbeturinave në vendin e mbrojtur nga larja	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	

	Erozioni, rënja e gurëve, kushtet e rrezikshme(hazardet)	Instaloni shenjat paralajmëruese (rrëketë, rrëshqitjet e dheut, kushtet me lagështi ose të rrëshqitshme, kurba e rrezikshme,kalim per këmbësorë ose kafshëi, shkolla, automjetet që lëvizin ngadalë,), shënuesit reflektues për të treguar kthesat ose pasqyre konvekse për të parë trafikun që po afrohet në kthesa qorre; vendosni paralajmërimet në pikat e konsideruara si të nevojshme nga praktikat e mira inxhinierike, ose siç është rënë dakord me shkrim me publikun dhe autoritetet	Kontraktori i mirëmbajtjes	Kontraktori i mirëmbajtjes	